

Lialona


Gjetja e Shtegut Tuaj
Drejt Mbështetjes të
Vetja, f. 32, 40–43

Tempulli dhe Historia Familjare:
Një Ftesë nga Presidenti dhe
Motra Nelson, f. 14

Të Pagëzuar Rishtazi? Ju Mund të
Shërbeni në Tempull Tani, f. 20

Tre Hapa për Zgjidhjen e Konfliktit
në Martesë, f. 22





Këtu tregohen kuaj dhe qerre duke kaluar pranë Tempullit të Solt-Lejikut, rreth vitit 1891. Uiliford Udraf (1807–1898) qe Presidenti i Kishës kur u përkushtua Tempulli i Solt-Lejikut më 1893-n. Ai na mësoi: "Ne jemi përgjegjës për... ndërtimin e tempujve ndaj Më të Lartit, ku mund të hyjmë dhe të marrim pjesë në ordinancat për shpëtimin e të vdekurve tanë" (Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff [Mësimet e Presidentëve të Kishës: Uiliford Udraf] [2004], f. 94).

Fotografi me mirësinë e Bibliotekës së Historisë së Kishës



4

MESAZHET

- 4 Mesazhi i Presidencës së Parë: Bërja Dishepuj të Vërtetë**
Nga Presidenti Henri B. Ajring
- 7 Mesazhi i Vizitave Mësimore: Përqafimi me Dashuri i Atyre që Largohen nga Udhë**



NË KAPAK
Fotografi nga Leslie Nilsson.


ARTIKUJT KRYESORË

- 14 Hapini Qiejt nëpërmjet Punës së Tempullit dhe Historisë Familjare**
Nga Presidenti Rasëll M. Nelson dhe Uendi W. Nelson
- 20 Dijini Këto Përpara se të Shkoni: Pagëzimet në Tempull**
Nga Hedhër J. Xhonson
Si një anëtar i ri, ti mund ta frekuentosh tempullin menjëherë me një rekomandim tempulli me përdorim të kufizuar. Këtu janë disa përgjigje të pyetjeve që mund të kesh përpara se të shkosh [në tempull].
- 22 Zgjidhja e Konfliktit në Martesën Tuaj**
Nga S. Brent Sharman
- 28 Gjetja e Ndhmës pas Vdekjes së Nensit**
Nga Derën Uillkoks
Si mund të zëvendësohet pikëllimi im dërrmues me paqen?

- 32 "Le të Jemi të Mbështetur te Vetja dhe të Pavarur"**
Çfarë është nisma e Kishës për mbështetjen te vetja dhe si mund t'ju ndihmojë ajo?

RUBRIKAT

- 8 Ne Flasim për Krishtin: Nuk Është Tepër Vonë për një Mundësi të Dytë**
Nga Amber Xhensen
- 10 Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit: Një Elefant në Klasë**
Nga Xhesika Grifit dhe Riçard M. Romni
- 38 Portrete Besimi: Ilir Dodaj**
- 40 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme**
- 80 Kur Prapë të Takohemi: Ndhim Dikë Sot**
Nga Presidenti Tomas S. Monson



44

44 Pesë Mësime për Të Rinjtë në Moshë Madhore nga Apostujt e Rinj

Nga Methju C. Gadfri

Çfarë mund të mësojmë sot nga përvojat e disa prej Apostujve të parë të Rivendosjes?



Shihni nëse mund ta gjeni Liahonën e fshehur në këtë botim. Ndihmë: Nganjëherë kënaqësia maskohet si shërbim!

50 Një Karakter si i Krishtit

Nga Plaku Dejvid A. Bednar

Jezusi, i cili vuajti më shumë nga të gjithë, ka dhembshurinë më të madhe për të gjithë ne që vuajmë shumë më pak.

54 Si Mundet një Mesazh nga Konferenca ta Ndryshojë Jetën Tuaj

Nga Hadli Grigs

58 Qëndroni të Palëkundur

Nga Lindsej Hiller

Bashkëmoshatarët e mi po më bënë tryzni që të pija, por më pas një nga djemtë tha diçka që ma ndryshoi jetën.

60 Thyeje Modelin "Adoleshent Tipik"

Nga Sharlot Larkabal

A doni t'i rrëzoni stereotipet? Tani është koha të ngriheni dhe të veproni!

62 Afishe: Ngrihuni në Besim

63 Përgjigje nga Udhëheqës të Kishës: Si ta Dini Vetë

Nga Presidenti Henri B. Ajring

64 Pyetje dhe Përgjigje

Përpos lutjes dhe studimit të shkrimeve të shenjta, cila është mënyra më e mirë për ta forcuar dëshminë time?

58



66

66 Nga Parisi në Saporo

Nga Emi Xhejn Leviti

Si fëmijët në Francë ashtu dhe në Japoni kishin diçka që e prisnin me padurim: një tempull të ri.

68 Përgjigje nga një Apostull: Si mund të më ndihmojë Fryma e Shenjtë?

Nga Plaku Robert D. Hejls

69 Faqja Jonë

70 Udhëtimi i Xhejnit

Nga Xhesika Larsen

Si do të shkonte në Navu familja e Xhejnit pa barkë?

72 Sara dhe Rezonanca Magnetike

Nga Xhulien Doman

Sara kishte frikë të bënte kontrollin me RM [rezonancë magnetike]. Çfarë mund të bënte ajo për t'u ndier më mirë?

74 Figura të Historisë së Kishës: Një Profet i Ri

75 Duke Ndhimuar, Laps pas Lapsi

Nga Kaleb H.

Kalebi dëshironte t'i ndihmonte refugjatët – dhe fëmijë të tjerë po ashtu!

76 Historitë e Jezusit: Jezusi e Vizitoi Jozef Smithin

Nga Kim Ueb Raid

79 Faqe për Ngjyrosje: Shabati Është Ditë e Shenjtë

**TETOR 2017 VËLLIMI 19 NR. 3
LIAHONA 14450 101**

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidenca e Parë: Tomas S. Monson,
Henri B. Ajring, Diter F. Uhtdorf

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: Rasëll M. Nelson,
Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Robert D. Hejls,
Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk,
D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen, Ronald A. Rasband,
Geri E. Stivenson, Dejll G. Renland

Kryeredaktor: Joseph W. Sitati

Ndihmësredaktorë: Randall K. Bennett, Carol F. McConkie

Këshilltarë: Brian K. Ashton, Bonnie H. Cordon, LeGrand R. Curtis Jr., Sharon Eubank, Christoffel Golden, Douglas D. Holmes, Erich W. Kopischke, Larry R. Lawrence

Drejtor Administrimi: Richard I. Heaton

Drejtor i Revistave të Kishës: Allan R. Loyborg

Administrues i Punëve: Garff Cannon

Redaktor Administrimi: Adam C. Olson

Ndihmësredaktor Administrimi: Ryan Carr

Ndihmëse e Botimit: Cremilda Amaral

Grupi i Shkrimit dhe i Redaktimit: Maryssa Dennis, David Dickson, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, Lori Fuller, Garrett H. Garff, LaRene Porter Gaunt, Jon Ryan Jensen, Charlotte Larcabal, Michael R. Morris, Eric B. Murdock, Sally Johnson Odekirk, Joshua J. Perkey, Jan Pinborough, Richard M. Romney, Mindy Anne Selu, Marissa Widdison

Drejtor Administrimi i Artit: J. Scott Knudsen

Drejtor Arti: Tadd R. Peterson

Grupi i Dizajnimit: Jeanette Andrews, Fay P. Andrus, C. Kimball Bott, Thomas Child, David Green, Colleen Hinckley, Eric P. Johnsen, Susan Lofgren, Scott M. Mooy, Mark W. Robison, Rachel Smith, Brad Teare, K. Nicole Walkenhorst

Bashkërenduese për Pronësi të Intelektuale:

Collette Nebeker Aune

Administrimi i Prodhimit: Jane Ann Peters

Grupi i Prodhimit: Ira Glen Adair, Connie Bowthorpe Bridge, Julie Burdett, Thomas G. Cronin, Bryan W. Gygi, Ginny J. Nilson, Derek Richardson

Përgatitja për Shtyp: Joshua Dennis, Ammon Harris

Drejtor i Prodhimit: Steven T. Lewis

Drejtor i Shpërndarjes: Troy K. Vellinga

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Sparti Kashari

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, shkoni në store.lds.org ose kontaktoni me qendrën tuaj vendore të Kishës për shpërndarjen ose me udhëheqësin e lagjes apo degës

Paraqitini dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org; nëpërmjet postës elektronike liahona@ldschurch.org; ose nëpërmjet postës në *Liahona*, Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fihxisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kambodhisht, kinezisht, kiribatisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, sllovenisht, spanjisht, suahilisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamsisht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2017 nga Intellectual Reserve, Inc. I rezervohen të gjitha të drejtat. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.


Informacion për të drejtën e autorit: Përveç nëse sugjerohet ndryshe, individët mund të kopjojnë material nga *Liahona* për përdorimin e tyre vetjak, jo për tregti (përfshirë për thirrjet në Kishë). Kjo e drejtë mund të anulohet në çdo kohë. Lënda figurative nuk lejohet të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të adresohen tek Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., FL 13, Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada:

October 2017 Vol. 19 No. 3. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published four times a year (April, May, October and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address must be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone or at store.lds.org. (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send all UAA to CFS (see DMM 507.1.5.2). NONPOSTAL AND MILITARY FACILITIES: Send address changes to Distribution Services, Church Magazines, P.O. Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368, USA.

MË SHUMË GJENDEN NË INTERNET



IKONAT NGA GETTY IMAGES

TEMAT NË KËTË BOTIM

Numrat përfaqësojnë faqen e parë të artikullit.

Anëtarë të rinj, 20

Besimi, 28, 32, 62

Dashuria, 7

Dëshmia, 63, 64

Dishepullimi, 4

Dita e Shabatit, 79

Fjala e Urtësisë, 58

Fryma e Shenjtë, 68, 72

Historia e Kishës, 44, 70, 74, 76

Historia familjare, 14

Jezu Krishti, 28, 50, 76

Konferenca e përgjithshme, 54

Lutja, 63, 64

Martesa, 22

Mbështetja te vetja, 32, 40, 41, 42, 43

Mbledhjet e këshillit të mësuesve, 10

Natyra hyjnore, 60

Ngushëllimi, 28, 72

Paqja, 28

Pendimi, 8

Perëndia, Ati, 4, 7, 8, 14, 38, 63, 76

Pikëllimi, 28

Puna në tempull, 14, 20, 66

Punësimi, 32, 41, 43

Refugjatët, 75

Studimi i shkrimeve të shenjta, 64

Shërbimi, 38, 75, 80

Tempujt, 66, 69

Trysnia e bashkëmohatarëve, 58

Vdekja, 28, 38



**Nga Presidenti
Henri B. Ajring,**
Këshilltar i Parë në
Presidencën e Parë

BËRJA DISHEPUJ TË VËRTETË

Në çdo mbledhje sakramenti, ne kemi privilegjin t'i premtojmë Atit Qiellor se ne do ta kujtojmë gjithmonë Shpëtimtarin dhe do t'i zbatojmë urdhërimet e Tij që të mund të kemi Shpirtin e Tij me ne (shih Moroni 4:3; 5:2; DeB 20:77, 79). Të kujtuarit e Shpëtimtarit do të na ndodhë përherë natyrshëm teksa e marrim mbi vete emrin e Tij. Ne e bëjmë atë në shumë mënyra, por veçanërisht kur u shërbejmë të tjerëve në emrin e Tij, i lexojmë fjalët e Tij të shenjta dhe lutemi që të dimë atë që Ai do të donte që ne të bënim.

Ajo për mua ndodhi kur kreuva pagëzimin e një të riu. E dija se isha thirrur nga shërbëtorët e shuguruar të Shpëtimtarit si misionar për të dhënë mësim ungjillin e Tij dhe për të dëshmuar për Të dhe për Kishën e Tij të vërtetë. Unë dhe shoku im misionar i kishim premtuar të riut se ai do të pastrohej nëpërmjet fuqisë së Shlyerjes së Jezu Krishtit, ndërsa pendohej me besim te Shpëtimtari dhe pagëzohej nga një prej shërbëtorëve të Tij të autorizuar.

Teksa e ngrita të riun nga ujërat e vaskës së pagëzimit, ai më pëshpëriti në vesh: "Unë jam i pastër, unë jam i pastër". Në atë çast m'u kujtua pagëzimi i Shpëtimtarit nga Gjon Pagëzori në lumin Jordan. Për më tepër, m'u kujtua se po bëja punën shpëtuese të një Shpëtimtari të ringjallur dhe të gjallë – i ndihmuar nga Fryma e Shenjtë, ashtu si Gjoni.

Për mua dhe për secilin prej nesh, të kujtuarit e Shpëtimtarit mund të jetë më shumë sesa të mbështeturit te një kujtesë e njohurisë dhe përvojave tona me Të. Ne, çdo ditë, mund të bëjmë zgjedhje që na afrojnë më shumë me Të, pikërisht tani.

Zgjedhja më e thjeshtë mund të jetë të lexuarit e shkri-meve të shenjta. Duke e bërë atë, ne mund të fitojmë ndjenjat e të qenit afër Tij. Për mua, afërsia vjen më së shpeshti kur lexoj nga Libri i Mormonit. Minutat e para tek lexoj nga kapitujt e 2 Nefit, unë dëgjoj në mendjen time zërat e Nefit dhe Lehit që e përshkruajnë Shpëtimtarin sikur ta njihnin Atë personalisht. Një ndjenjë afërsie rrjedh.

Vende të tjera në shkrimin e shenjtë mund t'ju tërheqin ju në mënyrë të veçantë drejt Tij. Por kurdo dhe kudo që e lexoni fjalën e Perëndisë, me qëllim të përlulur e të sinqertë për ta kujtuar Shpëtimtarin, ju do të shtoni dëshirën tuaj për ta marrë mbi vete emrin e Tij në jetën tuaj të përditshme.

Ajo dëshirë do ta ndryshojë mënyrën si shërbeni në Kishën e Zotit. Ju do t'i luteni Atit Qiellor për ndihmë në lartësimin qoftë edhe të një thirrjeje që ju duket e parëndësishme. Ndihma që do të kërkoni, është aftësia për ta harruar veten dhe për t'u përqendruar më shumë tek ajo që dëshiron Shpëtimtari për ata të cilët jeni thirrur t'u shërbeni.



Unë e kam ndier dorën e Tij dhe afërsinë e Tij në shërbimin tim me fëmijët tanë kur lutesha për të ditur se si t'i ndihmoja të gjenin paqen që vetëm ungjilli e sjell. Në çaste të tilla, unë shqetësohesha pak rreth të dukurit prind i suksesshëm, por shqetësohesha fort për suksesin dhe mirëqenien e fëmijëve të mi.

Dëshira për t'u dhënë atyre, të cilëve u shërbejmë, atë që Shpëtimtari do t'u jepte atyre, çon në lutje që janë një *përgjërim* drejtuar Atit Qiellor, me të vërtetë në emrin e Jezu Krishtit. Kur lutemi në atë mënyrë – në emrin e Shpëtimtarit, me besim në Të – Ati përgjigjet. Ai dërgon Frymën e Shenjtë për të na udhërrëfyer, ngushëlluar dhe për të na dhënë zemër. Ngaqë Shpirti përherë jep dëshmi për Shpëtimtarin (shih 3 Nefi 11:32, 36; 28:11; Ethëri 12:41), aftësia jonë për ta dashur Zotin me gjithë zemrën, mendjen dhe forcën tonë, rritet (shih

Marku 12:30; Lluka 10:27; DeB 59:5).

Bekimet e të kujtuarit të përditshëm dhe aktiv do të vijnë në mënyrë të ngadaltë e të qëndrueshme ndërsa i shërbejmë Atij, ushqehemi me bollëk me fjalën e Tij dhe lutemi me besim

në emrin e Tij. Dhe një i kujtuar i tillë do të na formojë për t'u bërë dishepuj të vërtetë të Zotit Jezu Krisht në mbretërinë e Tij në këtë tokë – dhe më vonë me Atin e Tij në botën e lavdishme që do të vijë. ■

MËSIMDHËNIA NGA KY MESAZH

Presidenti Ajring na këshillon që ta kujtojmë përherë Shpëtimtarin duke bërë zgjedhje të përditshme që të afrohem me shumë me Të. Me ata të cilëve u jepni mësim, ju mund të lexoni lutjet e sakramentit, të cilat përvijojnë besëlidhjen për ta kujtuar gjithmonë Atë (shih Moroni 4:3; 5:2; DeB 20:77,

79). Merrni parasysh t'i ftoni ata, të cilëve u jepni mësim, që të shkruajnë një listë me gjëra që mund t'i bëjnë çdo ditë për ta kujtuar Shpëtimtarin. Ju mund të merrni parasysh gjithashtu që t'i ftoni ata t'i lutën Atit Qiellor për suksesin dhe mirëqenien e njëri-tjetrit. Merrni parasysh të luteni për ta në të njëjtën mënyrë.




Ta kujtojmë Zotin çdo ditë

Miqtë, punët e shtëpisë, detyrat e shtëpisë, televizori – ka kaç shumë gjëra që kërkojnë vëmendjen tonë. Por çdo javë, ne i premtojmë Atit Qiellor “se gjithmonë e kujtoj[m]ë [Birin e Tij, Jezu Krishtin]” (DeB 20:79).

Presidenti Ajring thotë se ne “çdo ditë, mund të bëjmë zgjedhje” që na ndihmojnë ta kujtojmë Shpëtimtarin. Merreni parasysh ta bëni synim këtë muaj që ta kujtoni Shpëtimtarin më shumë çdo ditë. Ju mund të bëni një kalendar dhe të zotoheni të bëni një gjë një ditë për ta ndërtuar marrëdhënien


tuaj me të. Presidenti Ajring rendit gjëra si leximin e shkrimeve të shenjta, lutjen me besim dhe shërbimin ndaj Shpëtimtarit e të tjerëve. Është edhe mbajtja e ditarit, pjesëmarrja në mbledhjet e Kishës, dëgjimi i konferencës së përgjithshme, shkuarja në tempull, këndimi i himneve – lista vazhdon! Teksa e kujtojmë Shpëtimtarin çdo ditë, Presidenti Ajring premtos se “bekimet . . . do të vijnë në mënyrë të ngadaltë e të qëndrueshme. . . [dhe] do të na formojë për t’u bërë dishepuj të vërtetë të Zotit Jezu Krisht.”



FËMIJËT

Shumë Dashuri

Kur i lexojmë shkrimet e shenjta ose lutemi, ne mund të ndiejmë se sa shumë na duan Ati Qiellor dhe Jezu Krishti. Ngjyros një zemër sa herë që lutesh ose i lexon shkrimet e tua të shenjta. Çfarë tjetër mund të bësh për t’u ndier më pranë me Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin?



Përqafimi me Dashuri i Atyre që Largohen nga Udhë

Studiojeni këtë material me lutje dhe kërkoni frymëzim për të ditur se çfarë të tregoni. Si do t'i përgatitë kuptueshmëria e qëllimit të Shoqatës së Ndhmës bijat e Perëndisë për bekimet e jetës së përjetshme?

“Realiteti është që nuk ka familje të përsosura . . .”, tha Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë. “Çfarëdo problemesh që po i has familja juaj, çfarëdo që duhet të bëni për t'i zgjidhur ato, fillimi dhe fundi i zgjidhjes është dashuria hyjnore, dashuria e pastër e Krishtit.”¹

Për ata që nuk po marrin pjesë plotësisht në ungjill, Linda K. Barton, Presidente e mëparshme e Përgjithshme e Shoqatës së Ndhmës, tha: “Ati Qiellor i do të gjithë fëmijët e Tij. . . . Nuk ka rëndësi se ku janë ata – brenda apo jashtë udhës – Ai i do ata sërish në shtëpi.”²

“Sado të pabindur që mund të jenë [fëmijët tuaj], . . . kur u flisni atyre ose bisedoni me ta, mos e bëni atë me zemërim, mos e bëni atë me ashpërsi, me një frymë ndëshkuese”, dha mësim Presidenti Jozef F. Smith (1838–1918). “Flituni atyre me mirësi.”³



Besim
Familje
Ndhmë

Plaku Brent H. Nilson, i Të Shtatëdhjetëve, e përsëriti udhëzimin e Shpëtimtarit për ata që kanë dhjetë dhrahmi dhe e humbasin njëri: “Kërkoj[eni] derisa ta gje[ni]. Kur njeriu i humbur është biri juaj ose bija juaj, vëllai juaj ose motra juaj, . . . pas gjithçkaje që mund të bëjmë, ne e duam atë njeri me të gjithë zemrën tonë. . . .”

Marrshim ju dhe unë zbuluesën për të ditur se si t'u afrohemi më mirë njerëzve në jetën tonë që janë humbur, dhe, kur është e domosdoshme, të kemi durimin dhe dashurinë e Atit tonë në Qiell dhe të Birit të Tij, Jezu Krishtit, kur duam, vështrojmë dhe presim për plangprishësin.”⁴

Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, tha: “Jam lutur me besim

që dikush që e doja, do të kërkonte dhe do ta ndiente fuqinë e Shlyerjes. Jam lutur me besim që engjëj njerëzorë do t'u vinin në ndihmë dhe ata erdhën.

Perëndia ka krijuar një mënyrë për ta shpëtuar secilin prej fëmijëve të Tij.”⁵

Shkrime të Shenjta dhe Informacion i Mëtejshëm

Mateu 18:12; Alma 31:35;
3 Nefi 13:32; DeB 121:41–42
reliefsociety.lds.org

SHËNIME

1. Diter F. Uhtdorf, “Në Lavdërim të Atyre që Shpëtojnë”, *Liahona*, maj 2016, f. 79, 80.
2. Linda K. Burton, në Sarah Jane Weaver, “Sister Burton, Sister Wixom Visit Church’s Pacific Area”, *Church News*, 2 prill 2013, lds.org/church/news.
3. *Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 254.
4. Brent H. Nilson, “Pritja për Plangprishësin”, *Liahona*, maj 2015, f. 103.
5. Henri B. Ajring, “Nipërve e Mbesave të Mia”, *Liahona*, nëntor 2013, f. 71.



Merreni
Parasysh Këtë

Si mund të vazhdojmë t'u tregojmë dashuri hyjnore atyre që nuk dëshirojnë t'i jetojnë parimet e ungjillit?

NUK ËSHTË TEPËR VONË PËR NJË MUNDËSI TË DYTË

Nga Amber Xhensen

Babai i njëjës prej studenteve të mia që po haste vështirësi, i tha së bijës: "Nuk është tepër vonë që t'ia dalësh mbanë". Zoti na jep të njëjtin mesazh.

Sandra ishte një studente në klasën time të anglishtes së thelluar. Disa javë pasi kishte filluar viti, ajo nuk kishte bërë asnjë detyrë shtëpie apo projekt. Ajo thjesht shihte ëndrra me sy hapur në bankën e saj. Ajo nxirrte justifikime për arsyet përse nuk i kishite përfunduar detyrat e saj, dhe nuk tregonte as qëndrimin dhe as përpjekjen e nevojshme për t'ia dalë mbanë në një kurs kaq kërkues.

Këshilluesja e saj dhe unë vendosëm që të planifikonim një mbledhje me Sandrën, babain e saj dhe disa nga mësuesit e tjerë të saj, për të përcaktuar se çfarë drejtimi duhej të merrte: A duhej t'i ndërpriste kurset e thelluara dhe në vend të tyre të zgjidhte kurse standarde? Më thelbësorja ishte pyetja e pashprehur që rëndonte në mendjen e të gjithëve ne: A mund të gjenim një mënyrë për ta ndihmuar Sandrën që t'ia dilte mbanë?

Duke besuar se Sandrës i ishin dhënë shumë mundësi për t'ia dalë mbanë, por në vend të kësaj ajo kishte zgjedhur të dështonte, shkova në mbledhje duke u ndier shumë e shkurajuar. Me vete shpresoja që ajo do të vendoste të mos e vazhdonte më klasën time, në mënyrë që të mos

shqetësohesha më për të. Ndieja se kisha bërë gjithçka që mundesha dhe se tashmë ishte tepër vonë.

Në mbledhje, gjuha trupore e Sandrës zbuloi që edhe ajo dyshonte në aftësinë e saj për t'ia dalë mbanë. Ndërsa numëroja dështimin e saj në lëndën e anglishtes, ajo ia nguli sytë tryezës. Kur mësuesi i saj i historisë pohoi se Sandra po mbeste edhe në klasën e tij, trupi i saj u zhyt edhe më thellë në karrige dhe mund të shihja lot që i rridhnin faqeve.

Duke shprehur dhembshuri, i shpjegova asaj dhe të atit se, nëse Sandra dëshironte t'ia dilte mbanë në këto kurse sfiduese, asaj do t'i duhej të ndryshonte sjelljen që e kishte zhytur kaq thellë në këtë gropë, dhe se kjo do të ishte shumë e vështirë.

Një Mesazh nga i Ati

Këshilluesja më pas iu kthye babait të Sandrës, një burrë me pak arsim, i cili nuk dukej rehat në mjedisin e shkollës. Këshilluesja e pyeti nëse kishte ndonjë pyetje për mësuesit. Ai tha se nuk kishte dhe na falënderoi për atë që kishim bërë për Sandrën. Por më pas ai tha se kishte për t'i thënë diçka së bijës.

Më ngriu zemra. Kisha qenë pjesë e disa prej mbledhjeve prindër-mësues ku prindërit i kishin kritikuar gojarisht fëmijët e tyre përpara mësuesve dhe këshilltarëve, i kishin qortuar për përtacinë e tyre, mungesën e vëmendjes dhe të motivimit. Mblodha veten për ta dëgjuar sërish.

Ajo që dëgjova në vend të saj, më çuditi. Babai i përlulur i Sandrës iu kthye të bijës së tij të përplotur 16-vjeçare, e cila ishte e dërrmuar nga turpi dhe keqardhja, dhe i tha asaj: "Nuk është tepër vonë. Nuk është tepër vonë që t'ia dalësh mbanë. Me të vërtetë nuk është tepër vonë."

U largova nga ajo mbledhje mirënjohëse për reagimin e tij plot dashuri, por e merakosur që ai nuk ia kishte idenë se çfarë do t'i duhej së bijës që ta kalonte klasën në këtë pikë. Dukej e pamundur. Më vonë erdhi lajmi se ajo kishte vendosur ta linte klasën e historisë, por jo klasën time të anglishtes.

Më vonë atë ditë ndërsa u gjuhëzova në lutje, duke marrë në shqyrtim të metat e mia dhe duke i kërkuar falje Atit Qiellor, kuptova se sa shumë kisha mësuar nga babai i Sandrës. Pasiguritë dhe ndjenjat e papërshtatshmërisë, në kohë të caktuara në jetën



time, më kishin bërë ta pyetja veten nëse isha e denjë apo nëse e meritoja një mundësi të dytë. Në ato çaste, Zoti, ashtu si babai i Sandrës, zgjodhi të mos më qortonte, por përkundrazi, të më qetësonte: “Nuk është tepër vonë, bija ime. Nuk është tepër vonë.”

Mesazhi i Ungjillit

Sa shpesh e kemi besuar mesazhin e kundërshtarit se shpresa ka humbur? Por profetët na thonë të kundërtën. Isaia shpall: “Le të kthehet tek Zoti që të ketë dhembshuri për të, tek Perëndia ynë që fal bujarisht” (Isaia 55:7). Mormoni shton dëshminë e tij: “Kurdoherë që pendoheshin dhe kërkonin ndjesë me dëshirë të sinqertë, ata faleshin” (Moroni 6:8).

Gëzimi i ungjillit është që nuk është kurrë tepër vonë. Sepse, sa herë që kërkojmë falje, shëlbimi i Zotit do të na lejojë të fillojmë nga e para.

Sandra, me nxitjen për t’ia filluar sërish, bëri ndryshime të ngadalta, por domethënëse. Shndërrimi nuk qe i lehtë – kërkoi përpjekje të përditshme që t’i mposhtte zakonet e saj të këqija – por ajo i pa shpërblimet e përpjekjeve të saj teksa nota e saj u përmirësua gradualisht.

Nga një këndvështrim i ungjillit, nota jonë përfundimtare nuk do të ndikohet nga sa gjatë ngurruam apo se sa thellë e zhytëm veten në gropë. Përkundrazi, Zoti do ta gjykojë jetën tonë bazuar se në çfarë drejtimi po shkojmë, se si jemi penduar dhe se

sa shumë jemi mbështetur në Shlyerjen e Zotit.

Në gjykimin tim të kufizuar, unë e kisha vënë në dyshim aftësinë e Sandrës për t’i mposhtur gabimet e të shkuarës së saj. Në dallim, Ati ynë i përsosur nuk e humbet kurrë shpresën tek aftësia e fëmijëve të Tij për ta arritur shpëtimin me anë të përsosjes në Krisht. Nuk ka rëndësi se sa larg kemi dalë nga udha; Ai gjithmonë do ta kërkojë individin. Zoti na lutet që të mos endemi më si të huaj në mëkat, por përkundrazi, ta kërkojmë Atë me shpresë dhe t’i gëzojmë bekimet e Shlyerjes së Tij të pafund. Me të vërtetë, nuk është kurrë tepër vonë. ■

Autorja jeton në Virxhinia, SHBA.

NJË ELEFANT NË KLASË

Mbledhjet e këshillit të mësuesve nuk po ndryshojnë vetëm mënyrën se si japim mësim; ato po ndryshojnë mënyrën se si mësojmë.

**Nga Xhesika Grifit dhe
Riçard M. Romni**

Revistat e Kishës

Misuaki Sitole po përballet me një sfidë. Si president i Shkollës të së Dielës në lagje, ai ka një përgjegjësi të dhënë nga Perëndia që të ndihmojë për ta përmirësuar të mësuarin dhe mësimdhënien e ungjillit në lagje.¹

Por anëtarët e lagjes së tij në Johaneshburg të Afrikës Jugore, kanë, në disa raste, formim kulturor dhe pritshmëri shumë të ndryshme. Disa janë të mirarsimuar; të tjerë nuk janë. Shumë njerëzve u është mësuar se detyra e një studenti është që të dëgjojë, jo të flasë. Të tjerë kanë një sfidë të vështirë kulturore për të kuptuar se *që të dyja* [palët], si burrat dhe gratë, duhet të përfshihen në mësimdhënie në kishë e në shtëpi.

“Ne gjithashtu kemi njerëz që flasin gjuhë të ndryshme”, thotë Vëllai Sitole. “Por Shpirti dëshiron ta nxitë secilin më vete.”

Kur mbledhjet e këshillit të mësuesve dhe *Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit* u paraqitën vitin e kaluar, lagje dhe degë kudo në Kishë filluan që t'i mbanin mbledhjet e këshillit të mësuesve për të diskutuar, për të mësuar dhe për të praktikuar se çfarë do të thotë të japësh mësim sipas mënyrës së Shpëtimtarit.

Kjo ishte koha kur Vëllai Sitole filloi të kuptojë se si mund ta bekonin lagjen e tij mbledhjet e këshillit të mësuesve. Sfidat kulturore mund të trajtoheshin, pjesëmarrja në klasë mund të shtohet dhe këndvështrimet e ndryshme të anëtarëve mund të bëheshin bekime.

Ashtu si shumë të tjerë anembanë botës, Vëllai Sitole kuptoi se Zoti nuk po i përdor mbledhjet e këshillit të mësuesve vetëm për të ndryshuar mënyrën se si japim mësim; Ai po i përdor ato për të ndryshuar gjithashtu mënyrën se si mësojmë.

Një Elefant nga një Këndvështrim i Veçantë


Një nga zbulimet më interesante për Vëllain Sitole ishte që, kur mësuesit i fuqizojnë studentët të marrin pjesë në vetë të mësuarin e tyre, të gjithë përfitojnë nga këndvështrimi i zgjeruar që japin pikëpamjet e ndryshme.

Ajo kuptueshmëri i erdhi Vëllait Sitole gjatë një mbledhjeje të këshillit të mësuesve, kur një anëtar i lagjes tregoi shëmbëlltyrën e burrave të verbër dhe elefantit, [i parë] vetëm

Litar



Mur



Freskore



nga një këndvështrim. Shëmbëlltyra tregon se si secili prej gjashtë burrave të verbër e përshkruan një elefant në mënyrë të ndryshme (një këmbë është si një shtyllë, bishti është si një litar, noçka është një ulluk uji e kështu me radhë), ngaqë secili po prek një pjesë të ndryshme.²

“Por mendoni sikur elefanti të përfaqësojë mësimdhënien e ungjillit”, thotë Vëllai Sitole. “Atëherë, na nevojitet që ta aftësojmë çdo anëtar të klasës të tregojë këndvështrimin e tij, në mënyrë që së bashku të arrijmë te një kuptueshmëri e përbashkët e mënyrës se si na bekon ungjilli të gjithëve ne.”

Kjo është arsyeja përse mësuesit në lagjen e Vëllait Sitole ulen gjithnjë rreth një tryeze gjatë mbledhjes së këshillit të mësuesve – për të

lehtësuar diskutimin. “Ajo më kujton se gjithsecili ka të njëjtën forcë fjale”, thotë ai.

Sipas Nevojave të Tyre

Në Tokio të Japonisë, Natsuko Soejima dyshonte se mund të jepte mësim mirë. “Kur u thirra të isha mësuese e të rinjve në Shkollën e së Dieles”, thotë ajo, “i thashë peshkopit se do të më hynte frika. Por ai tha se thirrja ishte nga Perëndia, kështu që e pranova.”

Si një grup, klasa e trembte atë për shkak të sfidave individuale që paraqitnin ata. Dy nga të rinjtë kishin probleme me dëgjimin. Disa anëtarë të klasës që ishin shpërngulur në Japoni nga vende të tjera, flitnin vetëm anglisht. Ajo ia kishte frikën edhe ndryshimit në moshë midis asaj dhe anëtarëve të klasës së saj.

Më pas, në një mbledhje të këshillit të mësuesve, motra Soejima mori një përgjigje. “Ne folëm që ta duam çdo anëtar të klasës, t’i mësojmë emrat e tyre, të lutemi për ta një e nga një dhe të japim mësim – të udhëhequr nga Shpirti – sipas nevojave të tyre”, shpjegon ajo, “kështu që, kjo është ajo që fillova të bëj.” Ajo bëri edhe diçka tjetër që e kishte mësuar në këshill: “Përdorja gjuhë që përçon te dashurinë time”.

Rezultati? “Zemra ime ndryshoi. Fillova të ndieja dhembshuri për studentët e mi. Shqetësohesha për ata që mungonin, dhe lutesha për ta gjithashtu. Sapo mbaronte një mësim, unë fillova të përgatitesha për tjetrin, që të kisha kohë të mendoja për mundësitë e mësimdhënies. Po fluturoja nga gëzimi.”

Shtyllë



Markuç



Shtizë



Përgjigje të Veçanta

Brad Uilsoni, një president i Shkollës të së Dielës në Minesota të SHBA-së, sigurohet që mësuesit në mbledhjen e këshillit të mësuesve nuk largohen derisa të kenë diskutuar se si do të ndryshojnë për shkak të asaj që kanë mësuar.

“Ne ndjekim përmbledhjen e dhënë te *Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit*”, thotë Vëllai Uilson. “Ne diskutojmë për përvojat e mësuesve, më pas diskutojmë për një prej temave të sugjeruara. Si një ndërmjetës, unë bëj pyetje dhe përmbledh mendimet. Më pas ne vëmë në praktikë zbatimin. Ndahemi në grupe të vogla dhe diskutojmë: ‘Çfarë do të bëj ndryshe për shkak të mbledhjes sonë sot?’”

Ron Gudsoni, një instruktor i kuorumit të dhjakëve në të njëjtën lagje, thotë se i bën përshtypje kur shikon mënyrën se si Vëllai Uilson e “trajnon” këshillin. “Ne flasim rreth mënyrës se si do të jepte mësim Shpëtimtari”, thotë ai. “Më pas, teksa e ndieni Shpirtin, ju mendoni: ‘Kjo është diçka që duhet ta provoj në orën time’. Të menduarit rreth Shpëtimtarit, e ndryshon qasjen tuaj. Ajo ka të bëjë pak me atë që ‘Duhet të përgatit një mësim’, dhe më shumë me atë se ‘Çfarë u nevojitet këtyre dhjakëve dhe si mund të ndihmoj që t’ua jap atë atyre?’”

Ai kujton se shkroi në ditarin e tij: “Mora pjesë në mbledhjen e këshillit të mësuesve sot dhe ja ku janë gjërat që duhet të bëj”. Në fakt, ditari i tij

është plot me shënime të tilla. Tani ai përgatitet paraprakisht: “Filloni herët dhe ju [do të] merrni mbresa gjatë gjithë javës”. Ai i pyet dhjakët se çfarë po ndodh në jetën e tyre: “Jam më i efektshëm për t’i ndihmuar ata kur i njoh më mirë”. Dhe ai po i fton dhjakët që të ndihmojnë në mësimdhënie: “Kur e bëjnë atë, ata mësojnë më mirë gjithashtu”³.

Vazhdova të Këndoja

“Në këshillin tonë, ne biseduam rreth mënyrës se si muzika mund ta ftojë Shpirtin”, thotë Xhoslin Herringtoni, një mësuese e Fillores në të njëjtën lagje të Minesotës. “Më vonë, po jepja mësim te [klasa] Rrezet e Diellit. Mendova: ‘Do të këndoja ndërkohë që ata ngjyrosin



MË SHUMË INFORMACION

Për të mësuar më shumë rreth mbledhjeve të këshillit të mësuesve dhe *Mësimdhëni[s] sipas Mënyrës së Shpëtimtarit*, vizitoni teaching.lds.org.

dhe do të dalë mirë'. Fillova të këndoja dhe të gjithë ata ndaluan e më dëgjuan. Kështu që vazhdova të këndoja. Kjo e sollti vërtet Shpirtin dhe, kur mbarova, ata ishin nderues, duke pritur që të flisja. Ne kishim biseduar edhe rreth saj [në këshill], që ta jepnim dëshminë tonë kur të na jepej mundësia. Kështu që dëshmovava me fjalë që ata mund t'i kuptonin."

Motra Herrington thotë se ajo e vlerëson që mësueset e Fillores përfshihen në mbledhjet e këshillit. "Ne bisedojmë rreth mësimdhënies tek të rriturit", thotë ajo "por atëherë Vëllai Uilson do të thotë: 'Po rreth mësimdhënies tek të rinjtë? Po rreth mësimdhënies të fëmijët?' Ai na sjell në mend gjithë gamën e moshave të ndryshme që kemi."

Nga Këshilli në Këshill

Adam Martini, një president lagjeje i Shkollës të së Dielës në Kalgari, në Alberta të Kanadasë, thotë se ai i vlerëson sugjerimet nga këshilli i lagjes. "Presidentja e Shoqatës së Ndihmës ose presidenti i kuorumit të pleqve do të thotë: 'Do të donim që mësuesit të përqendroheshin te kjo [gjë]', kështu që ne diskutojmë rreth asaj në [mbledhjen] e këshillit të mësuesve", thotë ai.

Kur filluan së pari mbledhjet e këshillit të mësuesve, mësuesit nuk ishin të sigurt se çfarë të prisnin, prandaj ai u bëri shumë ftesa vetjake dhe paraqiti materiale trajnuese që gjenden në teaching.lds.org. "Tani çdo gjë rrjedh në mënyrë të natyrshme", thotë ai. "Ata e dinë se ai është një vend për të diskutuar mbi atë që po ndodh."

Një mbledhje e fundit u përqendrua te ndjekja e Shpirtit. "Ne biseduam rreth të përgatimit mirë, por të mos shqetësoheshim që të jepnim mësim gjithçka", thotë ai. "Një motër tha se

NDRYSHIMET PËR MBLEDHJET E SË DIELËS NË VITIN 2018

Duke filluar nga janari, priten ndryshime për mbledhjet e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndihmës. Këto ndryshime bazohen mbi atë që anëtarët kanë mësuar në mbledhjet e këshillit të mësuesve. Një shpjegim i ndryshimeve, përfshirë materialet e reja mësimore, do të jepen – duke filluar nga muaji tjetër – në botimet e konferencës të revistave, në programin për celular Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit] dhe në LDS.org.

ajo përherë kishte menduar se duhej të fliste rreth çdo gjëje që ishte në planin e saj mësimor. Ju mund ta shikonit që ajo filloi ta kuptojë këtë, kur ne folëm rreth të ndjekurit të frymëzimit ndërsa udhëheqim një diskutim."

Gjetja e Zgjidhjeve së Bashku

Çdo situatë mësimdhënieje përfshin mundësitë e sfidat e veta dhe bekimet e mundshme të saj. Kjo është arsyeja përse këshillat janë të efektshme, nga që ato i lejojnë mësuesit, me ndihmë nga Shpirti, të kërkojnë dhe gjejnë përgjigje për sfidat e tyre të veçanta.

Xhefri Rid, një president i Shkollës të së Dielës në kunj, në Arizona të SHBA-së, thotë se mbledhja e këshillit të mësuesve funksionon më mirë kur mësuesit e kuptojnë se qëllimi i tyre është që të këshillojnë: "Atëherë ata shohin se mund ta ndihmojnë njëri-tjetrin."

Kunji, thotë ai, po përqendrohet që t'i ndihmojë mësuesit ta ndryshojnë mënyrën e të menduarit nga "A po e bëj mirë?" në "Si po merret mesazhi?"

Mariza Konova, një mësuese e Fillores në kunj, thotë se në përgjigje të një mbrese që ndjeu në këshillin

e mësuesve, ajo tani i nxit anëtarët e klasës së saj Guximtarët 8 që të luten për njëri-tjetrin. Ajo ishte e efektshme, por mund të mos funksionojë në të njëjtën mënyrë për një klasë të rritur. "Të lutesh për çdo anëtar në një klasë të madhe të Doktrinës së Ungjillit mund të jetë dërrmuese", thotë ajo. "Fatmirësisht, ata mësues thonë: 'Si mendoni se mund ta përshtatim atë për klasën tonë?' Dhe ne gjejmë zgjidhje së bashku."

Ajo që çmoj rreth mbledhjeve të këshillit të mësuesve", thotë ajo, "është se ato na japin kohë që të reflektojmë rreth mënyrës si po e arrijmë [atë] dhe rreth asaj që po arrijmë. Është e dobishme të marrësh mbështetje dhe përshtypje, kur mendon se të gjithë po punojnë drejt të njëjtit qëllim. Më pëlqejnë gjithashtu këndvështrimet e ndryshme që njerëz të shumtë parashtrajnë në tryezë. Kjo më ndihmon të marr parasysh gjëra që sigurisht nuk do t'i kisha menduar vetë."

Ndërsa marrim pjesë dhe shprehemi në mbledhjet e këshillit të mësuesve, kuptueshmëria jonë për elefantin, të quajtur "mësimdhënia e ungjillit", fillon të bëhet më e qartë. Ashtu si Vëllai Sitole në Afrikë, shumë anëtarë anëmbanë Kishës po zbulojnë se, ndërsa aftësia jonë për të dhënë mësim në mënyrën e Shpëtimtarit përmirësohet, ajo ndryshon jo vetëm mënyrën se si japim mësim, por edhe mënyrën se si mësojmë. ■

SHËNIME

1. Shih *Handbook 2: Administering the Church [Manuali 2: Administrimi i Kishës]* (2010), 12.2.2.
2. Shëmbëlltyra është përfshirë në bisedën e Dieter F. Uchtdorfit: "Ç'është e Vërteta?" (takim shpirtëror i Sistemit Arsimit të Kishës për të rinjtë në moshë madhore, 13 janar 2013), broadcasts.lds.org; dhe Dieter F. Uchtdorf, "What Is the Truth?" *Friend*, mars 2017, f. 2.
3. Për më shumë sugjerime, shih Brian K. Ashton, "Helping Youth Teach", *Liahona*, gusht 2016, f. 24–25.



"Shumë [shpirtra] po presin me ankth që miqtë e tyre, të cilët janë ende gjallë, të administrojnë për ta në tempujt", tha stërgjyshi im i vdekur kur iu shfaq gjyshit tim, A. C. Nelsonit.



Hapini Qiejt

NËPËRMJET PUNËS SË TEMPULLIT DHE HISTORISË FAMILJARE



**Nga Presidenti
Rasëll M. Nelson,**

President i
Kuorunit të
Dymbëdhjetë
Apostujve
Dhe nga Uendi W.
Nelson

Gjatë paraqitjes së tyre në konferencën RootsTech 2017, Presidenti Rasëll M. Nelson dhe bashkëshortja e tij, Uendi, i ftuan shenjtoret e ditëve të mëvonshme që të merrnin parasysh me lutje se çfarë lloj sakrifice mund të bëjnë me qëllim që të kryejnë më shumë punë në tempull dhe punë për historinë familjare.

Presidenti Nelson: Kur gjyshi im, A. C. Nelsoni, ishte një bashkëshort e baba i ri në moshë, vetëm 27-vjeçar, babai i tij vdiq. Rreth tre muaj më vonë, babai i tij i vdekur, stërgjyshi im, erdhi ta vizitonte atë. Data e asaj vizite ishte nata e 6 prillit 1891. Gjyshit Nelson i la kaq shumë mbresë vizita e atit të tij sa e shkroi përvojën në ditarin e tij për familjen dhe miqtë e tij.

“Isha në shtrat kur Babai hyri në dhomë”, shkroi gjyshi Nelson. “Ai erdhi dhe u ul në anë të shtratit. Ai tha: ‘Pra, biri im, ngaqë pata disa minuta të lira, mora leje që të vija e të të shihja për pak minuta. Ndihem mirë, biri im, dhe kam pasur shumë për të bërë që kur vdiqa.’”

Kur gjyshi Nelson e pyeti se çfarë ishte duke bërë, babai i tij u përgjigj se ai kishte qenë i zënë me mësimdhënien e ungjillit të Jezu Krishtit në botën e shpirtrave.

“Nuk mund ta përfytyrosh, biri im, se sa shumë shpirtra ka në botën e shpirtrave, të cilët nuk e kanë pranuar ende ungjillin”, tha ai. “Por shumë po e pranojnë atë dhe po përmbushet një punë e madhërishtme. Shumë po presin me ankth që miqtë e tyre, të cilët janë ende gjallë, të administrojnë për ta në tempujt.”

Gjyshi Nelson i tha të atit: “Kemi synim që të shkojmë në tempull dhe të vlosemi me ty, Baba, sapo të mundemi”.



A. C. Nelson, gjyshi i
Presidentit Rasëll M. Nelson.

Stërgjyshi im u përgjigj: “Ajo, biri im, është pjesërisht arsyeja përse erdha të të shoh. Ne do të bëhemi prapë një familje dhe do të jetojmë gjatë gjithë përjetësisë.”

Më pas gjyshi Nelson pyeti: “Baba, a është i vërtetë ungjilli siç jepet mësim nga kjo Kishë?”

Babai i tij tregoi me gisht drejt një fotografie të Presidencës së Parë, të varur në murin e dhomës së gjumit.

“Biri im, sa ç’është e sigurt që e sheh atë fotografi, është e sigurt që ungjilli është i vërtetë. Ungjilli i Jezu Krishtit ka brenda vetes fuqinë për ta shpëtuar çdo burrë e grua që do t’i bindet atij, dhe në asnjë mënyrë tjetër nuk mund të fitojnë ata ndonjëherë shpëtim në mbretërinë e Perëndisë. Biri im, gjithmonë mbahu fort tek ungjilli. Ji i përlur, ji plot lutje, ji i nënshtruar ndaj priftërisë, ji i vërtetë, ji besnik ndaj besëlidhjeve që ke bërë me Perëndinë. Kurrë mos bëj diçka që nuk do ta kënaqte Perëndinë. O, çfarë bekimi është ungjilli. Biri im, ji djalë i mirë.”

Motra Nelson: Më pëlqejnë shumë të gjitha ato J-të. “Ji i përlur, ji plot lutje, ji i nënshtruar ndaj priftërisë, ji i vërtetë, ji besnik ndaj besëlidhjeve që ke bërë me Perëndinë. . . . Ji djalë i mirë.” Gjashtë J-të që t’u sollën nga stërgjyshi yt i larguar nga kjo jetë. Ai sigurisht ngjan

shumë si Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) me gjashtë J-të e tij.¹

Presidenti Nelson: Ai ngjan, apo jo? Është kaq e çmuar për mua që gjyshi im do ta linte atë anal për ne. Mësuam se fëmijët e babait të tij më pas u vulosën me të. Kështu që u përmbush arsyeja për vizitën e tij.

Shpirti i Elijas

Presidenti Nelson: Një emër me rëndësi të madhe në shkrimet e shenjta shpjegon arsyen përse familja është kaq e rëndësishme. Ai emër është Elija. EL-I-JA në hebraishte fjalë për fjalë do të thotë “Jehova është Perëndia im”². Mendoni për këtë! Të përfshirë brenda emrave të Elijas janë termat hebraishte si për Atin ashtu edhe për Birin.

Motra Nelson: Elija ishte profeti i fundit që mbajti fuqinë vulosëse të Priftërisë Melkizedeke përpara kohës së Jezu Krishtit. Misioni i Elijas ishte që të kthente zemrat e fëmijëve tek etërit dhe zemrat e etërve te fëmijët, kështu që ata të mund të vuloseshin, ose përndryshe “e tërë toka do të *shkaktërrohej plotësisht* në ardhjen e tij” (Joseph Smith – Historia 1:39; theksimi i shtuar). Këto janë fjalë mjaft të fuqishme.

Presidenti Nelson: Më pëlqen të mendoj rreth shpirtit të Elijas si “një shfaqje e Frymës së Shenjtë që jep dëshmi për natyrën hyjnore të familjes”³. Sipas Udhëzuesit për Shkrimet e Shenjta, “Fuqia e Elias është fuqia vulosëse e priftërisë me anë të së cilës gjërat që lidhen ose zgjidhen në tokë, lidhen ose zgjidhen në qiell” (“Elija”).

Motra Nelson: Kështu që, kur themi se shpirti i Elijas po vepron mbi njerëzit për t’i nxitur



të kërkojnë të afërmit e tyre të vdekur, ne në të vërtetë po themi se Fryma e Shenjtë po na nxit të bëjmë ato gjëra që do t'i lejojnë familjet të vulo-sen përjetësisht.

Presidenti Nelson: Është e mrekullueshme të kthehen zemrat e fëmijëve tek etërit e tyre duke treguar ngjarje të rëndësishme të historisë familjare në mënyra që janë të përdorshme dhe mbresëlënëse. Ndoshta të pasurit e dokumenteve, ngjarjeve, fotografive dhe relikteve të historisë familjare gjithmonë përpara syve tanë mund t'i forcojë dëshmitë tona (shih Mosia 1:5). Kur i vendosim ato në muret tona, tavolinat tona, kompjuterët tanë, iPad-et tona dhe madje celularët tanë, ndoshta ne do të nxitemi të bëjmë zgjedhje më të mira dhe t'u afrohem më pranë Zotit dhe familjeve tona.


Megjithatë, nëse e lemë në atë nivel, në të vërtetë nuk kemi bërë sa duhet. Si anëtarë të Kishës, interesimi ynë në punën për historinë familjare është nxitur nga udhëzimi prej Zotit që paraardhësit tanë nuk mund të bëhen të përsosur pa ne dhe që ne nuk mund të bëhemi të përsosur pa ta (shih DeB 128:15). Kjo do të thotë që ne duhet të lidhemi së bashku nëpërmjet ordinancave të shenjta vulosëse të tempullit. Ne duhet të jemi hallka të forta në zinxhirin nga paraardhësit tanë deri te pasardhësit tanë. Nëse koleksionet tona të ngjarjeve dhe fotografive do të bëheshin ndonjëherë një synim përfundimtar në vetvete – nëse e dimë se cilët janë paraardhësit tanë dhe dimë gjëra të mrekullueshme rreth tyre, por i lëmë të braktisur në anën tjetër, pa ordinancat e tyre – një shmangie e tillë nuk do të jetë ndonjë ndihmë

për paraardhësit tanë, të cilët mbeten të kufizuar në burgun e shpirtrave.

Motra Nelson: Ruajtja e historive të paraardhësve është e rëndësishme, por kurrë nuk duhet të bëhet në kurriz të plotësisht të punës për ordinancat e paraardhësve tanë. Na nevojitet të gjejmë kohë për informacionin që i kualifikon paraardhësit tanë për ordinancat.

Presidenti Nelson: Dhe kjo do të thotë të sakrifikojmë kohën që normalisht e harxhojmë për veprimtari të tjera. Na nevojitet të harxhojmë më shumë kohë në tempull dhe në bërjen e kërimit të historisë familjare, gjë e cila përfshin indeksimin.

Motra Nelson: Sakrifica me të vërtetë sjell të qiellit bekime.⁴ Jam bekuar të gjej shumë paraardhës për të cilët kam besim se ishin gati të bënin besëlidhje me Perëndinë dhe t'i merrnin ordinancat e tyre thelbësore. Me kalimin e kohës, kuptova se, në qoftë se po punoja për një projekt të mundimshëm dhe nuk kisha kohë, energji dhe ide, në



qoftë se do të bëja një sakrifikim të kohës duke gjetur informacionin kualifikues për ordianca për disa paraardhës ose duke shkuar në tempull që të isha mëkëmbëse për ta, qiejt hapeshin dhe energjia e idetë fillonin të rridhnin. Në njëfarë mënyre kisha kohë të mjaftueshme për ta përmbushur afatin tim. Ajo ishte tërësisht e pamundur, por do të ndodhte çdo herë. Puna në tempull dhe për historinë familjare më sjell një gëzim që me të vërtetë nuk është i kësaj bote.

Puna për Historinë Familjare dhe Puna Misionare


Presidenti Nelson: Nëse do të isha misionar sot, dy miqtë e mi më të mirë në lagjen ose degën ku po shërbeja, do të ishin udhëheqësi i misionit të lagjes dhe këshilluesi/ja i/e lagjes për tempullin dhe historinë familjare.

Njerëzit kanë një dëshirë të lindur brenda vetes për të ditur diçka rreth paraardhësve të tyre. Ajo bëhet një mundësi e natyrshme për misionarët tanë. Kur misionarët mësojnë që t'i duan njerëzit të cilëve u japin mësim, ata natyrisht do të pyesin rreth familjeve të tyre. “A jetojnë prindërit tuaj? A jetojnë gjyshërit dhe gjyshet tuaja? A i njihni dy gjyshërit dhe dy gjyshet tuaja?” Bashkëbisedimet rrjedhin me lehtësi kur ata që afrohen për të folur me misionarët, ftohen që të flasin rreth njerëzve që i duan.

Në atë pikë mund të jetë e natyrshme për misionarët, përfshirë anëtarët misionarë, që të pyesin: “A njihni ndonjë prej stërgjyshërve apo stërgjysheve tuaja? A i dini emrat e tyre?” Ka mundësi që kërkuesit nuk do t'i dinë emrat e që të katër stërgjyshërve dhe që të katra stërgjysheve të tyre.

Atëherë misionarët mund të bëjnë këtë sugjerim: “Kam një mik në kishën tonë që mund t'ju ndihmojë. Nëse do të mund t'i gjenim emrat e disave apo ndoshta edhe të të gjithë stërgjyshërve e stërgjysheve tuaja, a do t'ia vlenin nja dy orë nga koha juaj për të gjetur se cilët janë stërgjyshërit dhe stërgjyshtet tuaja?” Ai mik në kishë, sigurisht, është këshilluesi i lagjes për tempullin dhe historinë familjare.

Motra Nelson: Mendoj se mund të jetë ngushëlluese për misionarët të dinë se nuk janë kurrë të vetëm kur po gjejnë dhe po u japin mësim atyre që janë pranues ndaj të vërtetave të ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit. Presidenti Xhorxh Q. Kenon (1827–1901), i cili shërbeu si këshilltar i katër Presidentëve të Kishës, dha mësim se në këto ditë të mëvonshme, ata që po bashkohen me Kishën, po



bashkohen pikërisht ngaqë paraardhësit e tyre kanë qenë duke u lutur që një nga pasardhësit e tyre të bashkohet me Kishën me qëllim që ata, paraardhësit, të mund t'i marrin ordiancat e tyre thelbësore nëpërmjet mëkëmbësit.⁵

Ekzaltimi: Një Çështje Familjare

Presidenti Nelson: Ekzaltimi është një çështje familjare. Vetëm nëpërmjet ordiancave shpëtuese të ungjillit të Jezu Krishtit mund të ekzaltohen familjet. Përfundimi më i lartë për të cilin përpiqemi fort, është që ne të bëhemi të lumtur si familje – ta kemi marrë dhurimin [indaumentin], të jemi vulosur dhe të jemi të përgatitur për jetën e përjetshme në praninë e Perëndisë.

Motra Nelson: Çdo klasë e Kishës që e frekuentojmë, çdo herë që shërbejmë, çdo besëlidhje që bëjmë me Perëndinë, çdo ordiancë priftërie që e marrim, gjithçka që bëjmë në Kishë, na udhëheq drejt tempullit të shenjtë, shtëpisë së Zotit. Ka kaq shumë fuqi në dispozicion për një çift dhe për fëmijët e tyre nëpërmjet ordiancës vulosëse kur ata i mbajnë besëlidhjet e tyre.

Presidenti Nelson: Çdo ditë ne zgjedhim se ku dëshirojmë të jetojmë përjetësisht, nëpërmjet mënyrës se si mendojmë, ndiejmë, flasim dhe veprojmë. Ati ynë Qiektor ka shpallur se vepra e Tij dhe lavdia e Tij është të bëjë të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e fëmijëve të Tij (shih Moisiu 1:39). Por Ai *dëshiron* që ne të zgjedhim të kthehemi tek Ai. Ai nuk do të na detyrojë në asnjë mënyrë. Saktësia me të cilën i mbajmë besëlidhjet tona, i tregon Atij



se sa shumë dëshirojmë të kthehemi për të jetuar me Të. Çdo ditë na sjell më pranë ose na çon më larg nga mundësia jonë e lavdishme e jetës së përvetshme. Neve secilit na duhet t'i mbajmë besëlidhjet tona, të pendohemi çdo ditë dhe të kërkojmë të jemi më shumë si Shpëtimtari ynë. Atëherë dhe vetëm atëherë familjet mund të jenë së bashku përgjithmonë.

Motra Nelson: Është dëshmia ime që, sado mahnitëse të jetë jeta juaj pikërisht tani, ose sado shkrajuese dhe zemërlënduese të mund të jetë ajo, përfshirja juaj në punën në tempull dhe për historinë familjare do ta bëjë atë më të mirë. Çfarë ju nevojitet në jetën tuaj pikërisht tani? Më shumë dashuri? Më shumë gëzim? Më shumë vetëkontroll? Më shumë paqe? Më shumë çaste domethënëse? Më shumë nga ajo ndjesi se ju po sillni ndryshim? Më shumë argëtim? Më shumë përgjigje për pyetjet tuaja për të gjetur vetveten? Më shumë lidhje të përzemërta me të tjerët? Më shumë kuptueshmëri të asaj që po lexoni në shkrimet e shenjta? Më shumë aftësi për të dashur dhe për të falur? Më shumë aftësi për t'u lutur me fuqi? Më shumë frymëzim dhe ide krijuese për punën tuaj dhe projekte të tjera? Më shumë kohë për atë që vërtet ka rëndësi?

Unë ju nxit të bëni një sakrifikim të kohës për Zotin duke e shtuar kohën që harxhoni duke bërë punë në tempull dhe për historinë familjare e më pas vëzhgoni se çfarë ndodh. Është dëshmia ime se, kur i tregojmë Zotit se e kemi marrë seriozisht ndihmën për paraardhësit tanë, qiejt do të hapen dhe ne do të marrim gjithçka që na nevojitet.

Presidenti Nelson: Ne mund të frymëzohemi gjithë ditën rreth përvojave të tempullit dhe të historisë familjare që i kanë pasur të tjerët. Por duhet të bëjmë diçka që ta përjetojmë vetë me të vërtetë gëzimin. Do të dëshiroja t'i drejtoja një sfidë secilit prej nesh me qëllim që ndjenja e mrekullueshme e kësaj pune të mund të vazhdojë dhe

madje të rritet. Ju ftoj që me lutje të merrni parasysh se çfarë lloj sakrifice – mundësisht një sakrifikim të kohës suaj – mund të bëni me qëllim që të bëni më shumë punë në tempull dhe punë për historinë familjare këtë vit.

Ne jemi të përfshirë në punën e Perëndisë së Gjithëfuqishëm. Ai jeton. Jezusi është Krishti. Kjo është Kisha e Tij. Ne jemi fëmijët e Tij të besëlidhur. Ai mund të ketë besim tek ne. ■

Nga një paraqitje në Konferencën RootsTech 2017 të Historisë Familjare në Solt-Lejksiti në Jutë, SHBA, më 11 shkurt 2017. Për të parë një regjistrim të paraqitjes në anglisht, portugalisht ose spanjisht, vizitoni [lds.org/go/1017Nelson](https://www.lds.org/go/1017Nelson).

SHËNIME

1. Shih Gordon B. Hinkley, "A Prophet's Counsel and Prayer for Youth", *Liahona*, prill 2001, f. 30–41.
2. Bible Dictionary, "Elijah".
3. Russell M. Nelson, "A New Harvest Time", *Liahona*, maj 1998, f. 34.
4. Shih "Lavdi Burrit", *Himne*, nr. 19.
5. Shih *Gospel Truth: Discourses and Writings of President George Q. Cannon*, përmb. Jerreld L. Newquist, 2 vëll. (1974), 2:88–89.



DIJINI KËTO PËRPARA SE TË SHKONI:

Pagezimet në Tempull

Nuk është nevoja të presim. Të gjithë anëtarët e denjë, përfshirë rininë dhe anëtarët e rinj, mund të shërbejnë në tempull tani.

Nga Hedhër J. Xhonson

Revistat e Kishës

“L e të jemi me të vërtetë një popull që e frekuenton tempullin dhe një popull që e do tempullin”, tha Presidenti Hauard W. Hanter (1907–1995). “Ne duhet të nxitojmë për në tempull aq shpesh . . . sa na e lejojnë rrethanat tona vetjake. Ne duhet të shkojmë jo vetëm për të

afërmit tanë të vdekur, por edhe për bekimin vetjak të adhurimit në tempull, për shenjtërinë dhe sigurinë që gjenden brenda atyre mureve të shenjtëruara e të përkushtuara” (“A Temple-Motivated People”, *Ensign*, shkurt 1995, f. 5).

Kjo këshillë gjen zbatim për të gjithë anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

– edhe nëse jeni një anëtar i pagëzuar së fundi. Për aq kohë sa jeni të denjë, nuk ka periudhë pritjeje përpara se të mund ta frekuentoni tempullin. Sapo pagëzoheni dhe konfirmoheni, ju mund të merrni një rekomandim tempulli me përdorim të kufizuar.

Ky rekomandim ju lejon të hyni në tempull për të kryer pagëzime dhe konfirmime si mëkëmbës për paraardhës të vdekur. Kur shërbeni dhe adhuroni në tempull, ju mund ta forconi dëshminë tuaj për ungjillin.

Në lidhje me përvojën e saj të parë në tempull, Natalia Lorena Figueroa nga Argjentina tha: “Në pagëzimoren e tempullit, pashë një vëlla që u pagëzua për gjyshin tim dhe dajat e mi. Më pas unë u pagëzova për gjyshen dhe tezet e mia. Gëzimi që ndjeva ishte i pabesueshëm. Lot më dolën nga sytë dhe ndjeva një djegie përbrenda kraharorit si kurrë më parë.” Bekime të ngjashme i presin ata që cilësohen dhe i përdorin rekomandimet e tempullit me përdorim të kufizuar. ■



PYETJE QË BËHEN RËNDOM

Si ta marr një rekomandim me përdorim të kufizuar?

- Ju duhet të jeni 12 vjeç e lart dhe të jeni një anëtar i denjë i Kishës. Burrat duhet të marrin Priftërinë Aarone, gjë e cila normalisht mund të bëhet brenda një jave nga pagëzimi i tyre.
- Për të marrë një rekomandim, peshkopi ose presidenti juaj i degës ju interviston. Intervista është e ngjashme me atë që ju bëtë përpara pagëzimit tuaj. Ju do të diskutoni rreth dëshmisë suaj për ungjillin dhe respektimit të urdhërimeve.
- Rekomandimi është i vlefshëm për një vit.

Cilat janë disa nga bekimet e të pasurit të një rekomandimi me përdorim të kufizuar?

- Ju mund t'u shërbeni paraardhësve tuaj të vdekur dhe të tjerëve të cilët kanë vdekur duke kryer pagëzime dhe konfirmime si mëkëmbës në emër të tyre.
- Juve mund t'ju kujtohet vetë pagëzimi dhe konfirmimi juaj dhe besëlidhjet që keni bërë.
- Edhe nëse nuk mund ta frekuentoni shpesh tempullin, ju mund ta mbani rekomandimin tuaj me vete si një kujtues të vazhdueshëm të tempullit dhe zotimit tuaj për të qenë i denjë për ta frekuentuar.
- Të jetuarit denjësisht për një rekomandim me përdorim të kufizuar ju ndihmon të përgatiteni për të marrë vetë ordinancat tuaja të tempullit, [ato] të indaumentit [dhurimit] dhe vulosjes.

Si duhet ta planifikoj një vizitë për në tempull?

- Kërkojini ndihmë, për planifikimin e një vizite në tempull, një udhëheqësi të lagjes apo degës, të tillë si udhëheqësit të misionit të lagjes ose presidentes së Shoqatës së Ndhmës.
- Oraret për çdo pagëzimore tempulli janë të afishuara në internet në temples.lds.org. Ju gjithashtu mund të merrni në telefon tempullin për informacion.
- Nëse po merrni pjesë për herë të parë, ju mund të merrni në telefon tempullin për të planifikuar një takim. Në këtë mënyrë ata do të jenë të përgatitur që t'ju mirëpresin dhe t'ju shpjegojnë atë që do të bëni në tempull.



- Vishni rrobat tuaja më të mira të së dielës për në tempull.
- Sillni me vete një palë ndërresa të bardha. Disa tempuj japin ndërresa të bardha, por disa jo. Tempulli do të japë një palë kominoshe dhe një peshqir të bardhë.

Çfarë duhet të pres kur e frekuentoj tempullin për të kryer pagëzime dhe konfirmime si mëkëmbës?

- Kur hyni në tempull, fillimisht ju do të vini te tryeza e rekomandimeve. Një punonjës i tempullit do ta kontrollojë rekomandimin tuaj.
- Burrat dhe gratë më pas shkojnë në dhoma zhveshjeje të ndara për t'u ndërruar. Janë siguruar hapësira private me kyç që të ndërroni veshjet tuaja e të vishni kominoshet e bardha që ju janë dhënë.
- Punonjësit e tempullit do t'ju drejtojnë atje ku duhet të shkoni për të kryer pagëzime dhe konfirmime si mëkëmbës.
- Pagëzimet dhe konfirmimet ku merrni pjesë do të jenë të ngjashme me vetë pagëzimin dhe konfirmimin tuaj, por ju do të veproni në emër të një personi të vdekur.
- Pasi të keni mbaruar së marri pjesë në ordinancë, ju do të ktheheni te dhoma e zhveshjes dhe do të ndërrohni e vishni rrobat tuaja.
- Nuk ka nevojë të jeni i shqetësuar rreth frekuentimit të tempullit. Punonjësit e tempullit janë në dispozicion kudo që të shkoni në tempull. Ata do t'ju ndihmojnë.

Zgjidhja e Konfliktit

në Martesën Tuaj



Nga S. Brent Sharman

Këshillues i dalë në pension, Shërbimet Familjare SHDM

Meti dhe Margarita (të gjithë emrat janë ndryshuar) e fikën televizorin pas sesionit përmbyllës të konferencës së përgjithshme. Mesazhet kishin qenë frymëzuese dhe atyre u kishte pëlqyer atmosfera pozitive që kishte depërtuar në shtëpinë e tyre atë fundjavë.

Askush nuk mund të kishte qenë më i zhgënjyer se Meti dhe Margarita kur, në më pak se 24 orë më vonë, ata po bënin një diskutim të ashpër nëse duhej ta kursenin shpërblimin e papritur që kishte marrë Meti në punë, apo ta harxhonin për veshje shkollore për fëmijët më të mëdhenj. Debati nuk u zgjidh dhe Meti e Margarita vazhduan sikush të bënin punë të tjera, duke u ndier të keqkuptuar.

Për të krijuar një martesë të përjetshme e të lumtur, çiftet duhet të mësojnë se si t'i zgjidhin konfliktet në mënyrë që secili individ të ndihet se e kuptojnë dhe të marrin vendime që përfshijnë lëshime të pranueshme.

*Bekime të
mrekullueshme
rrjedhin nga
zgjidhja e
konflikteve në
një atmosferë
dashurie.*



Paralajmërim dhe Udhërrëfim Shpirtëror

Shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve dhe të apostujve japin këshilla të shumta rreth grindjes. Te 3 Nefi ne lexojmë: “Ai që ka shpirtin e grindjes nuk është i imi, por është i djallit i cili është ati i grindjes” (3 Nefi 11:29). Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim se Satani “punon për të krijuar përçarje dhe grindje midis një babai dhe një nëne. Ai i nxit fëmijët të jenë të pabindur ndaj prindërve të tyre. . . . Satani e di se mënyra më e sigurt dhe më e efektshme për ta prishur veprën e Zotit është të zvogëlojë efektshmërinë e familjes dhe të shenjtërisë së shtëpisë.”¹

Dallimet në mendim, zakon apo formim janë të pashmangshme, por ne kemi mjaft burime që na ndihmojnë të dimë se si t’iu bëjmë ballë. Doktrina dhe udhëzimi i dhënë mësim në adhurimin e së dielës dhe në botimet e Kishës mund të ndihmojnë dhe mund të plotësohen me informacion cilësor profesional sipas nevojës. Çiftet mund të mësojnë metoda për t’u përballur me konfliktin. Frymëzimi mund të çojë në një ndryshim zemre, që e zbut secilin bashkëshort së brendshmi.

Presidenti Tomas S. Monson paralajmëroi: “Disa nga mundësitë tona më të mëdha për ta shprehur dashurinë tonë do të jenë brenda mureve të vetë shtëpive tona. Dashuria duhet të jetë pjesa më e rëndësishme e jetës familjare dhe, prapëseprapë, ndonjëherë ajo nuk është. Mund të ketë tepër padurim, tepër grindje, tepër zënka, tepër lot.”²

Kur shqetësimet vazhdojnë dhe bëhen shkatërrimtare për jetën familjare, mund të ketë shkaqe më të rënda të konfliktit, përfshirë pamaturin, egoizëm, dëshirë për të fituar pushtet mbi njëri-tjetrin dhe krenari. Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) dha mësim: “Prej shumë kohësh kam ndier se faktori më madhor për një martesë të lumtur qëndron te përkujdesja plot merak për qetësinë dhe mirëqenien e shokut apo të shoqes [së jetës]. Në shumicën e rasteve, egoizmi është faktori parësor që shkakton diskutime, ndarje, shkurorëzim dhe thyerje zemre.”³

Plaku Marvin J. Ashton (1915–1994), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, komentoi gjithashtu: “Kur një njeri e shqyrton ndjenjën e keqe dhe pakënaqësinë e shkaktuar nga grindja, është mirë të pyesë: ‘Përse po marr pjesë [në këtë]?’ . . .

. . . Është e rëndësishme të pranojmë se ne e zgjedhim sjelljen tonë. Rrënja e këtij problemi është çështja e lashtë e krenarisë.”⁴

Cilido qoftë shkaku, ne kemi nevojë të mësojmë aftësi të reja dhe t’i zbusim zemrat tona kur problemet vazhdojnë.

Shkaqe të Konfliktit

Ka shumë shkaqe për konflikt, që fillojnë nga paragjykimet vetjake sipërfaqësore deri te stilet e rrënjësura thellë të komunikimit. Përveç mposhtjes së egoizmit dhe pamaturisë, çiftet do të përballen me shkaqe të tjera të zakonshme të konfliktit, përfshirë faktorë të tillë si vijon:

Të sapomartuar që po mësojnë t’i përshtaten stileve të njëri-tjetrit	Dallime të natyrshme midis burrave dhe grave	Nervozizëm i nxitur nga lodhja	Mendime të ndryshme mbi mënyrën më të mirë se si t’i rritin fëmijët apo t’i administrojnë financat
Fëmijë që mësojnë të përdorin lirinë e zgjedhjes	Pëlqime dhe mospëlqime të ndryshme	Reagime të tepruara ndaj stresit	Mungesë gjykimi apo aftësie në zgjidhjen e konfliktit



Paralajmërimet rreth Zemërimit

Shumë konflikte martesore apo familjare krijohen për shkak të zemërimit të pakontrolluar. Nëse nuk jemi të kujdesshëm, ne mund të vijojmë, pas një rasti zemërimi, të mendojmë pa ndërprerë rreth asaj se si na u bë padrejtësi. Sa më shumë zhytemi në ato mendime, aq më tepër arsye do të nxjerrim për ta përligjur këndvështrimin tonë. Kjo bluajtje me mendje mund të na pengojë që të qetësohemi dhe, kur një valë e dytë zemërimi nis përpara se të zgjidhet i pari, reagime hormonale mund të çojnë në shpërthime të tjera.

Për shembull, në një sesion këshillimi, Merilini përshkroi mënyrën se sa e bezdisshme kishte qenë të shtrihej në shtrat pasi ajo dhe bashkëshorti i

saj i kishin bërë titur njëri-tjetrit. “E dija se kisha të drejtë”, tha ajo. “E dija se do ta ndizte dritën dhe do të kërkonte të falur, por ai kurrë nuk e bëri atë. Sa më shumë mendoja rreth asaj, aq më tepër zemërohesha. Kur e dëgjova se filloi të gërhiste, nuk mund të duroja më – u ngrita nga shtrati dhe i bërtita edhe më shumë, dhe pastaj zbrita poshtë. A e beson se ai prapë nuk kërkoi të falur?” Përvoja e Merilinit është një shembull i mirë i mënyrës se si të mos t’i trajtojmë ndjenjat e zemërimit.

Zakone, madje edhe ato afatshkurtra, mund të duken të vështira për t’u ndërprerë. Por bashkëshortët/et mund të mësojnë aftësi për t’u ardhur në ndihmë. Ja ku janë disa praktika të dobishme:



Analizojini mendimet tuaja shpejt.

Në shembullin tonë, Merilini mund t’i kishte thënë vetes: “Duket sikur kam të drejtë, por po e zmadhoj më shumë seç duhet. Marrëdhënia me bashkëshortin tim ka më shumë rëndësi për mua sesa ajo për të cilën po grindemi.”



Shprehini ndjenjat tuaja në mënyra të frytshme.

T’i shprehni me të bërtitura ndjenjat tuaja nuk do t’ju ndihmojë që t’i “hiqni nga vetja”. Sa më shumë të shprehni me inat, aq më të forta do të bëhen ndjenjat tuaja [të zemërimit].



Gjeni diçka zbavitëse.

Zgjidhni të mendoni rreth diçkaje tjetër apo të bëni një shëtitje.



Dëgjoni muzikë qetësuese
ose lexoni letërsi frymëzuese.

7 KËSHILLA PËR T’U QETËSUAR

Niseni nga e para.

Mbajeni veten që në fillim të një mosmarrëveshjeje. Studimet kanë treguar se tre deri pesë minutat e para të një bisede vënë themelin e asaj që ka gjasa të ndodhë. Thoni: “Kjo po shkon në drejtim të gabuar. Le ta nisim nga e para.”



Lëri emocionet tuaja të qetësohen

përpara se të përpiqeni ta zgjidhni një problem. Prisni derisa të kalojë çfarëdo reaksioni kimik që po ndodh në trupin tuaj.



Hidhni në letër mendimet tuaja.

Për disa njerëz, kjo ndihmon që ta shtojë vetëdijen.

Hapat drejt Zgjidhjes së Konfliktit

Strengthening Marriage [Forcimi i Martesës], një manual i Shërbimeve Familjare SHDM, rekomandon tre hapa për zgjidhjen e konfliktit: 1) shprehja e pikëpamjeve, 2) shqyrtimi i shqetësimeve dhe 3) përzgjedhja e zgjidhjeve të kënaqshme për të dy palët.⁵ Këta hapa bazohen në një model komunikimi dhe shprehjeje që është bashkëpunues dhe i trajton çështjet për të gjithë ata që janë përfshirë.

1. Shprehja e Pikëpamjeve	2. Shqyrtimi i Shqetësimeve	3. Përzgjedhja e Zgjidhjeve të Kënaqshme për të Dy Palët
<p>Çdo individ i tregon pikëpamjet në një mënyrë të sinqertë, por jo sulmuese. Ndonjëherë të menduarit me maturi e zgjidh problemin, meqë bëhet e qartë se mosmarrëveshja ishte thjesht një keqkuptim. Për shembull, një bashkëshorte që mendon se bashkëshorti i saj po këmbëngul në mënyrë egoiste që ajo të marrë pjesë me të në një ndeshje basketbolli të një shkolle të mesme në vend që të dalë për darkë në një takim dashurie me të, mund të arrijë të kuptojë se ai nuk ka aq shumë interes për basketbollin sesa t'i kushtojë vëmendje një lojtari që ka ndaluar së frekuentuari klasën e tij të Shkollës së të Dielës.</p>	<p>Çiftet i analizojnë shqetësimet në një nivel më të thellë. Synimi është që t'i kuptojnë dhe t'i pranojnë shqetësimet e njëri-tjetrit. Duke vazhduar shembullin e basketbollit, bashkëshortja, ndërkohë që e kupton shqetësimin e bashkëshortit të saj për studentin, mund të besojë se ai po krijon një model që i vendos përherë nevojat e të tjerëve përpara atyre që ka martesa. Në këtë rast, mund të bëhet një diskutim më i matur, ku secili i shpreh ndjenjat në një mënyrë delikate dhe kundërshtia i hap rrugë bashkëpunimit.</p>	<p>Çiftet japin ide dhe vendosin mbi zgjidhje që janë të kënaqshme për të dy palët. Përqendrimi është tek ajo që mund të bëjë secili individ për t'i trajtuar shqetësimet, në vend të asaj se çfarë mund të bëjë bashkëshorti/ja i/e tyre. Bisedime të tilla mund ta provojnë pjekurinë dhe durimin por, me kalimin e kohës, çojnë drejt një bindjeje se ka siguri në shprehjen e ndjenjave dhe drejt një mirëbesimi se dëshirat e secilit individ do të merren parasysh. Çifti ynë mund të bjerë dakord ta kalojnë një mbrëmje të premtjeje së bashku në një ndeshje basketbolli, një mbrëmje të premtjeje në të cilën bashkëshorti shkon në ndeshje vetëm, dhe dy mbrëmje të premtjeje duke bërë veprimtari në çift. Nuk ka rëndësi mënyra se si çifti zgjedh ta kalojë mbrëmjen e të premtjes sesa ka rëndësi që cilësia e procesit të vendimmarrjes të jetë e kënaqshme për të dyja palët.</p>



Rrjedhojat e Zgjidhjes së Konfliktit

Bekime të mrekullueshme burojnë nga zgjidhja e konflikteve në një atmosferë dashurie. Këto përfshijnë sigurinë, rritjen vetjake, e cila çon drejt paqes së brendshme, besimin e shtuar, karakterin e përmirësuar dhe drejtësinë vetjake.

Kur konfliktet zgjidhen, modele të reja mund ta zënë vendin e tyre. Më pas hapet dera për bashkëshortët që të shprehin mendime pozitive dhe të tregojnë mbështetje. Motra Xhin B. Bingham, Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, tha: “Fjalët kanë fuqi të habitshme, si për të lartësuar edhe për të shkatërruar. Ne të gjitha ndoshta mund të sjellim ndërmend fjalë negative që na shkurajuan, dhe fjalë të tjera të thëna me dashuri që na i bënë shpirtrat të fluturojnë. Zgjedhja që të themi vetëm atë që është pozitive rreth të tjerëve – dhe këtë ballë për ballë – i lartëson dhe i forcon njerëzit përreth nesh dhe i ndihmon të tjerët që të ndjekin mënyrën e Shpëtimtarit.”⁶

Çiftet që kanë bërë përparim afatgjatë në zgjidhjen e konfliktit, korriin shpërblime të dëshirueshme. Një bashkëshort nga një marrëdhënie e mëparshme e trazuar tha: “Është e vështirë për mua ta hedh vështrimin prapa e të shoh se si ishin gjërat [mes nesh] dhe të besoj se ishin vërtet [ashtu]. Si munda ta trajtoj bashkëshorten time në atë mënyrë? Jam mirënjohës që Shpirti ma tërhoqi vëmendjen dhe për durimin që ka treguar bashkëshortja ime me mua.”

Përfundimi

Kapërcimi i konfliktit kërkon përpjekje të ndërgjegjshme dhe çuarje deri në fund. Pikërisht gjëja tjetër që ju thoni ose bëni, mund t'i japë zanafillë modeleve më pozitive të komunikimit në martesën tuaj. Edhe ju mund t'i korri frytet e Shpirtit siç u përjetuan nga nefitët: “Nuk pati grindje në tokë, për shkak të dashurisë së Perëndisë që jetonte në zemrat e njerëzve.

Dhe nuk pati zili, as luftime, as trazira . . . ; dhe me siguri nuk mund të kishte një popull më të lumtur” (4 Nefi 1:15–16). ■

Autori jeton në Jutā, SHBA.

SHËNIME

1. M. Russell Ballard, “The Sacred Responsibilities of Parenthood” (takim shpirtëror në Universitetin “Brigam Jang”, 19 gusht 2003), f. 3; speeches.byu.edu.
2. Tomas S. Monson, “Dashuria – Thelbi i Ungjillit”, *Liahona*, maj 2014, f. 92.
3. Gordon B. Hinckley, “Loyalty”, *Liahona*, maj 2003, f. 59.
4. Marvin J. Ashton, “No Time for Contention”, *Ensign*, maj 1978, f. 9.
5. Shih *Strengthening Marriage: Resource Guide for Couples* (2006), f. 19–20.
6. Xhin B. Bingham, “Unë do ta Sjell Dritën e Ungjillit në Shtëpinë Time”, *Liahona*, nëntor 2016, f. 7.



Rregulla për Diskutimin e Problemeve

Më poshtë renditen disa ide që i shtojnë gjasat për zgjidhje me sukses të konfliktit:

- Kërkoni ndihmë shpirtërore.
- Vendosni për një orë dhe vend ku të bisedoni nëse ka një të kaluar serioze problemesh.
- Përpiquni të kuptoni në vend që të bëni fjalë.
- Lëreni bashkëshortin/en tuaj të flasë.
- Flisni qetë dhe jini të sjellshëm.
- Bëni një pushim nëse ju nevojitet.
- Përdorni gjuhë të përshtatshme.
- Përmbajuni temës. Diskutoni vetëm shqetësimin e tanishëm.
- Mos përdorni kurrë dhunë.
- Mos kërcënoni kurrë me shkurorëzim apo ndarje.
- Gjenero zgjidhje të matshme, të tilla si: “Unë do të filloj lutjen familjare dhe ti drejto mbrëmjen familjare”.
- Planifikoni që të bëni përjashtime.
 - Bini dakord për kujtues neutralë, të tillë si: “Le të shohim kalendarin se e kujt është radha për t'i larë enët”.
 - Rivlerësojini dhe rishikojini zgjidhjet sipas nevojës.



Gjetja e Ndhimës pas Vdekjes së Nensit

*Çfarë nevojitej të bëja me qëllim që të aktivizoja fuqinë
shëruese të Jezu Krishtit në jetën time?*

Nga Derën Uillkoks

Në shkurt të vitit 2016, bashkëshortja ime, Nensi, ndërroi jetë pas një beteje 11-vjeçare me kancerin e gjirit. Pikëllimin dërmues që e ndjeva gjatë muajve të parë pasi vdiq ajo, do të ishte e pamundur t'ia shpjegoja dikujt që nuk e ka përjetuar këtë lloj humbjeje. Hidhërim, ankth, mjerim, dhembje – asnjë prej këtyre fjalëve nuk do ta shpjegonte siç duhet. Ishte i padurueshëm.

Fuqia Shëruese e Shpëtimtarit

E kam kuptuar prej kohësh që Jezu Krishti “zbriti nën gjithçka” (DeB 88:6) kështu që Ai do të jetë në gjendje “të ndihmojë [të japë lehtësim për] popullin e tij sipas dobësive të tyre” (Alma 7:12). Kjo do të thotë që fuqia e Shlyerjes së Shpëtimtarit shtrihet përtej sigurisë për Ringjalljen dhe për shëlbimin nga mëkatet. Nëpërmjet kësaj fuqie, Ai gjithashtu mund të na shërojë në kohën tonë të vuajtjes dhe nevojës. Në pikëllimin tim, unë me ngut – pothuajse furishëm – u përpoqa të mësoja se çfarë më nevojitej të bëja që ta aktivizoja këtë aspekt të fuqisë së Shpëtimtarit në jetën time. Për javë të tëra i hetova shkriemet e shenja dhe bisedat nga Autoritetet e Përgjithshme të Kishës. Sinqerisht besoja që, me çmimin e dhembjes së madhe dhe të flijimit të Vetvetes, Shpëtimtari e njihte dhembjen që po përjetoja unë. Por si më ndihmoi mua ajo njohje e Tij? Ngaqë Ai e vuajti këtë për mua, çfarë më nevojitej të bëja për të marrë ndihmën që Ai, për këtë arsye, e di se si ta japë?

Pas shumë hetimi, studimi, lutjeje dhe adhurimi në tempull, fillova të kuptoja. Para së gjithash, fillova të shoh

më qartë se Zoti tashmë e kishte ndihmuar, ngushëlluar dhe përkrahur familjen tonë, veçanërisht në javët përpara vdekjes së Nensit. Pati përvoja të mrekullueshme shpirtërore që tani i dalloj të jenë bekime që vijnë nga fuqia shëruese dhe forcuese, e gjindshme për ne për shkak të Shlyerjes së Shpëtimtarit. Dhe thjesht njohja që Shpëtimtari tashmë po tregonte kujdes për ne në një mënyrë shumë individuale, ishte, në vetvete, pafundësisht ngushëlluese. Sikurse Shadraku, Meshaku dhe Abed-negoja i lashtësisë, Ai ka qenë me ne në “furrën e ndezur” (Daniel 3:17) të vuajtjes sonë.

Mirëbesimi te Zoti

Gjithashtu mësova se ka disa gjëra që kërkohen prej nesh me qëllim që të marrim ngushëllimin dhe shërimin nga Zoti. Më e rëndësishmja, ne duhet të mirëbesojmë tek Ai. Ajo mund të jetë diçka e vështirë për t'u bërë. Përse duhet të mirëbesoj te Perëndia kur Ai së pari mund ta kishte parandaluar vdekjen e Nensit? Në përgjigje të kësaj pyetjeje, vazhdimisht përsiat diçka që Zoti ia tha Profetit Jozef Smith:

“Ju nuk mund të shihni me sytë tuaj natyrorë, në këtë kohë, planin e Perëndisë tuaj lidhur me ato gjëra që do të vijnë më pas dhe me lavdinë që do të pasojë pas shumë mundimesh” (DeB 58:3).

Ne u bekuam me shumë shenja që mënyra dhe koha e vdekjes së Nensit ishin në përputhje me vullnetin e Zotit. Kam arritur të kuptoj se një Atë i gjithëdijshëm dhe i dashur na ka lejuar t'i vuajmë këto gjëra ngaqë, në planin e Tij



ILUSTRIME NGA TEMPULLI XHORXHIAS, ATLANTE

të përsosur për ekzaltimin e familjes sonë, kjo vuajtje në njëfarë mënyre është e domosdoshme. Duke e ditur këtë, unë e kuptoj se pjesa ime në planin e Tij është që jo vetëm ta duroj atë, por ta “durojl] mirë” (DeB 121:8). Për aq sa unë mund t’ia përkushtoj këtë mundim Atij, jo vetëm që do të ndihmohem, por edhe do të shenjtërohem. Tashmë e kam përjetuar këtë në shumë mënyra.

I kam këshilluar fëmijët tanë të bëjnë atë që e kam mësuar vetë në këtë proces:

- Lëreni dhembjen e përvojave të vështira që t’ju nxitë drejt dishepullimit më të madh.
- Hapeni zemrën tuaj në lutje.
- Nëse ndieni zemërim kundrejt Perëndisë që i lejoi tragjeditë të ndodhin, lutjuni Atij që ta zëvendësojë atë zemërim me besim e nënshtrim.
- Besëlidhni që do ta doni Atë dhe do të jeni besnikë deri në fund.
- Pini nga fjala e Perëndisë vazhdimisht – nga shkrimet e shenjta, nga bisedat dhe shkrimet e profetëve bashkëkohorë dhe të mësuesve të frymëzuar.
- Shkoni në tempull me një uri që t’ju mësohen gjërat e përjetësisë.
- Gjeni njerëz për të cilët një krizë vetjake po bëhet një krizë besimi dhe forcojini me dëshminë tuaj për këto doktrina.

Një Dëshmi Apostolike

Gati një muaj pas vdekjes së Nensit, erdhi një natë kur pikëllimi që ndjeva, ishte tërësisht dërrmues. Kisha genë në dhembje dhe hidhërim shumë të thellë tërë atë ditë. M’u kujtua Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, duke na mësuar se “shtegu i shpëtimit gjithmonë ka kaluar . . . përmes Gjetsemanit”¹. Edhe pse vuajtja ime nuk mund të krahasohet me vuajtjen e Shpëtimtarit, atë natë unë isha mes vetë “orëve [të mia] të errëta dhe të hidhura”².

Pasi e përjetova këtë për njëfarë kohe dhe pasi u luta për ndihmë, më erdhi në mendje diçka që e kisha lexuar dhe shënuar në kompjuterin tim disa vite më parë. E gjeta dokumentin dhe e kalova me të shpejtë deri tek ajo që po kërkoja. Ishte një intervistë me Plakun Riçard G. Skot, të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve (1928–2015), në të cilën e pyetën rreth humbjes së bashkëshortes së tij, Xheninës, prej kancerit në vitin 1995. Plaku Skot u përgjigj: “Para së gjithash, . . . nuk e humba atë. Ajo është në anën tjetër të velit. Ne jemi të vulosur në atë ordinancë të shenjtë të tempullit dhe do të jemi së bashku përgjithmonë.”³

Atë natë ato fjalë më erdhën me një fuqi që nuk e kisha ndier kurrë më parë. Ishte sikurse feneri i një fari të ndizej në një natë të errët. Nuk kam lexuar kurrë diçka që pati mbi mua një ndikim të tillë, të papritur e të thellë. Errësira dhe dhembja u larguan. Ishte sikurse Alma

kur ai nuk mund “t’i kujto[nte] më dhembjet e [tij]” (Alma 36:19). Kjo dëshmi apostolike më përshkoi deri në zemër. U mahnita që një koncept që e kisha kuptuar që nga fëmijëria, papritur mund të më dukej kaq mbresëlënëse. E gjeta veten duke vrarë mendjen se si ishte e mundur që Plaku Skot mund ta dinte diçka të tillë. Dhe në çast e kuptova se edhe unë e di atë. Nëse jam besnik, unë mund të kem të gjithë shpresën që e pati Plaku Skot. Ndërkohë që sigurisht ka pasur trishtim dhe vajtim që atëherë, unë nuk i kam ndier kurrë përsëri thellësitë e dhembjes dhe të hidhërimit që i përjetova atë natë.

Kjo është fuqia që Shpëtimtari na e shtrin për të na ndihmuar gjatë sprovave tona. E di se pikëllimi i familjes sonë nuk do të largohet kurrë tërësisht, por ai bëhet i përfshirë brenda atyre që janë quajtur bekimet “forcuese” dhe “përsosëse” të Shlyerjes së Shpëtimtarit.⁴ Ne i jemi afruar Shpëtimtarit, e kemi ndier sigurimin prej Tij dhe jemi mbështetur nga themeli i sigurt i besëlidhjeve tona. ■

Autori jeton në Xhorxhia, SHBA.

SHËNIME

1. Jeffrey R. Holland, “Lessons from Liberty Jail” (takim shpirtëror i Universitetit “Brigam Jang”, 7 shtator 2008), f. 6, speeches.byu.edu.
2. Diter F. Uhtdorf, “Rrethuar me Krahët e Tij të Dhembshur”, *Mesazhi i Presidencës së Parë*, mars 2015.
3. “A Sure Witness of Jesus Christ: Elder Richard G. Scott”, lds.org/prophets-and-apostles.
4. Shih Bruce C. Hafen dhe Marie K. Hafen, *The Contrite Spirit: How the Temple Helps Us Apply Christ’s Atonement* (2015), f. 34–52.



Pas një beteje 11-vjeçare me kancerin e gjirit, Nensi Xhin Njuton Uillkoxi ndërroi jetë në vitin 2016.



TË FORCUAR NGA JEZU KRISHTI

“Isaia dha mësim se Mesia do t’i mbante ‘sëmundjet’ tona dhe ‘dhembjet’ tona (Isaia 53:4). Isaia dha mësim edhe për forcimin tonë prej Tij: ‘Mos ki frikë, sepse unë jam me ty, mos e humb, sepse unë jam Perëndia yt. Unë të forcoj dhe njëkohësisht të ndihmoj’ (Isaia 41:10). . . .

Dhe kështu ne shohim se, për shkak të Shlyerjes së Tij, Shpëtimtari ka fuqinë për të ndihmuar – për të dhënë ndihmesë – për çdo dhembje dhe hidhërim të vdekshëm. Nganjëherë fuqia e Tij shëron një lëngatë, por shkrimet e shenjta dhe përvojat tona na mësojnë se ndonjëherë Ai ndihmon ose na jep ndihmesë duke na dhënë forcën ose këmbënguljen për t’i duruar lëngatat tona. . . .

. . . Shlyerja e Shpëtimtarit tonë bën më shumë sesa na siguron për pavdekësinë nëpërmjet ringjalljes së të gjithëve dhe na jep mundësinë që të pastrohemi nga mëkati nëpërmjet pendimit dhe pagëzimit. Shlyerja e Tij gjithashtu ofron mundësinë ta thërrasim Atë, i cili i ka përjetuar të gjitha lëngatat tona të vdekshme, për të na dhënë forcën që t’i durojmë barrët e vdekshmërisë. Ai i njeh dhembjet tona dhe Ai është i gjindshëm për ne. Ashtu si Samaritani i mirë, kur Ai na gjen të plagosur buzë rruge, Ai do të na i lidhë plagët dhe do të kujdeset për ne (shih Lluka 10:34). Fuqia shëruese dhe forcuese e Jezut Krishtit dhe Shlyerja e Tij është për të gjithë ne që do t’i kërkojmë. Unë dëshmoj për këtë sikurse dëshmoj për Shpëtimtarin tonë, i cili e bën gjithçka të mundur.”

Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Të Forcuar nga Shlyerja e Jezut Krishtit”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 62, 64.



“LE TË JEMI TË MBËSHKETUR TE VETJA DHE TË PAVARUR”

Ndërsa shenjtore të ditëve të mëvonshme anëmbanë botës i përqafojnë parimet dhe doktrinat e nismës së Kishës për mbështetjen te vetja, ata po korrin bekimet e një “shpres[e], paqelje] dhe përparim[i] më të madh”.

Përpara se të bëhej anëtar i Kishës, Piter Aglou e kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës së tij si i rritur duke rendur pas suksesit financiar. Nga ana e jashtme dukej sikur e kishte arritur atë. Në fund të fundit, ai kishte pasur në pronësi dhe kishte drejtuar disa biznese.

Kur një udhëheqës vendor i Kishës në Uest-Midlandsin në Angli, i kërkoi Piterit që t'i bashkohej një grupi të financave vetjake që jepej nëpërmjet nismës së Kishës për mbështetjen te vetja, ai nuk besonte se kursi mund t'i mësonte atij ndonjë gjë. Megjithatë, sapo Piteri filloi të merrte pjesë në grup, ai shpejt kuptoi se sa shumë kishte ende për të mësuar.


“Kursi nuk është thjesht për financat; kjo është vetëm gjysma e tij”, thotë ai. “Gjëja më e rëndësishme për mua ishte që të mësoja të kisha besim tek Ati Qiellor – te mënyra se si Ai siguron për të gjithë ne bekime materiale dhe hap derën e mbështetjes së vërtetë te vetja, nëse e ndjekim udhërrëfimin e Tij shpirtëror.”

Si anëtar i një grupi për financat vetjake, Piteri mësoi aftësi praktike të tilla si: mbajtja e shpenzimeve familjare, krijimi i një buxheti dhe të jetuarit sipas tij, zvogëlimi i borxhit dhe kursimi për të ardhmen. Duke i përdorur këto aftësi, së bashku me ushtrimin e besimit në Jezu Krisht dhe të punuarit fort, Piteri dhe bashkëshortja e tij shlyen një borxh të madh.

“Ndiem shumë herë më i lehtë dhe i lirë, pa frikën e shoqëruar me borxhin dhe çorganizimin financiar”, thotë ai. “Po i ndiej bekimet e bollshme të Atit Qiellor në një mënyrë që nuk e kam ndier kurrë më parë. Kam mësuar mënyrën se si t'i bëj kërkesë Atij dhe t'ia vë veshin përgjigjeve të Tij kur kam nevojë për ndihmë në çështjet e mia materiale.”

Nisma e Mbështetjes te Vetja

Mbështetja te vetja është më shumë sesa të kesh një punë të mirë, depo ushqimore ose para në bankë. Përkundrazi, ajo është “aftësia, zotimi dhe përpjekja



për të siguruar për nevojat shpirtërore dhe fizike të jetës për vet[e]n dhe familjen. Kur anëtarët [e Kishës] bëhen të mbështetur te vetja, ata janë gjithashtu më të aftë që të shërbejnë e të kujdesen për të tjerët”¹ ndërsa e vënë punën si një parim udhëheqës në jetën e tyre.

Presidenti Tomas S. Monson ka dhënë mësim: “*Mbështetja te vetja* është rezultat i punës sonë dhe i forcon të gjitha praktikat e tjera të mirëqenies. Ajo është një element thelbësor për mirëqenien tonë shpirtërore si edhe materiale. . . . ‘Le të punojmë për atë që na duhet. Le të jemi të mbështetur te vetja dhe të pavarur. Shpëtimi nuk mund të sigurohet mbi asnjë parim tjetër. Shpëtimi është një çështje vetjake dhe ne duhet të punojmë për shpëtimin tonë si në gjërat materiale ashtu edhe ato shpirtërore.’”²

Nën drejtimin e udhëheqësve vendorë të priftërisë, më shumë se 500 000 shenjtorë të ditëve të mëvonshme, në më shumë se 100 kombe, kanë marrë pjesë në nismën e mbështetjes te vetja që prej vitit 2014. Kisha tani po e paraqet nismën kudo nëpër Amerikën Veriore.

Nisma përfshin kurse dhe burime “për t’i ndihmuar anëtarët e Kishës që t’i mësojnë dhe t’i vënë në zbatim parimet e besimit, edukimit, të punuarit fort dhe mirëbesimit në Zot. Pranimi dhe të jetuarit e këtyre parimeve”, thotë Presidenca e Parë, “do t’i na e bëjë të mundur më mirë që t’i marrim bekimet materiale të premtuara nga Zoti”³.

Të Lumtur dhe Plot Shpresë

Maria Edilen Romaoja e kishte humbur shpresën. Ajo nuk mund të gjente punë, ajo ishte një nënë beqare dhe kishte disa fëmijë për të ushqyer.

Ndodhi atëherë që dy anëtare të lagjes së saj në Santa Katarina në Brazil, e ftuan në një takim shpirtëror mbi mbështetjen te vetja. Në fund të takimit shpirtëror, Maria iu bashkua grupit që ta ndihmonte atë të gjente punë.

“Për herë të parë në jetën time, besova në një të ardhme ku unë mund të kujdesesha për familjen time”, kujton ajo. “Unë besoja se grupi i mbështetjes te vetja do të më ndihmonte ta ndryshoja jetën time.”

JENI TË FTUAR

Shtegu drejt një mbështetjeje më të madhe te vetja fillon me një ftesë për në një takim shpirtëror të “Shtegu[t] [T]im drejt Mbështetjes te Vetja”. Në takimin shpirtëror, ju do të nxiteni të bëni një vlerësim të situatës suaj të tanishme, të krijoni një plan për të shkuar përpara dhe më pas ta shqyrtoni planin tuaj me Zotin. Në fund të takimit shpirtëror, ju do të ftoheni që të zgjidhni një grup të mbështetjes te vetja që mund t’ju ndihmojë:

- Të gjeni një punë ose ta përmirësoni gjendjen tuaj të punësimit.
- T’i administroni më mirë financat tuaja vetjake dhe familjare.
- Të zgjidhni një shteg të arsimimit dhe t’ia dilni mbanë në shkollë.
- Të nisni dhe zgjeroni një biznes të vogël tuajin.

Në grupin tuaj të mbështetjes te vetja, ju:

- Do të frekuentoni një mbledhje grupi të përjavshme dyorëshe për tre muaj.
- Do të bëni zotime vetjake dhe do të veproni sipas tyre për të arritur synimet e mbështetjes te vetja.
- Do të mësoni nga pjesëtarët e tjerë të grupit, do të këshilloheni me ta e do t’i mbështetni ata.
- Do të fitoni besim më të madh te Jezu Krishti dhe fuqia e Tij për t’ju ndihmuar që ta ndihmoni veten të bëheni të mbështetur te vetja.

Një grup i mbështetjes te vetja funksionon si një këshill. Pjesëmarrësit e ndihmojnë njëri-tjetrit dhe janë përgjegjës ndaj njëri-tjetrit. Ndërmjetësit e grupit ftojnë ndërveprim, nxitin pjesëmarrje, shfaqin materiale filmike trajnuese dhe i ndihmojnë grupet e mbështetjes te vetja që ta ndjekin procesin siç përvijohet në materialet që lidhen me të.

Anëtarët mund t’i gjejnë materialet filmike dhe burimet e përdorura në trajnimin e mbështetjes te vetja në srs.lds.org ose në programin për celularë Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit].



Ashtu ndodhi.

Gjatë 12 javëve pasuese, Maria iu përkushtua grupit të saj, studimeve të saj dhe zotimeve të saj. Ajo punoi me energji të përtërirë drejt synimeve të saj. Ajo praktikoi teknika për intervista pune. Brenda dy javësh ajo siguroi një intervistë premtuese pune. Ajo intervistë i dha asaj një punë.

“Jeta ime ka ndryshuar përgjithmonë”, thotë Maria, e cila nuk ka më vështirësi për ta ushqyer familjen e saj. “Tani jam e lumtur, e entuziazmuar, e duruar dhe plot shpresë. Unë besoj se Ati Qiellor jeton dhe më do. E di se, kur ushtroj besimin tim në Jezu Krisht, unë bekohehem.”

“Mjeti më Fantastik”

Mbështetja te vetja është një mjet për një qëllim më të lartë, tha Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve: “Synimi ynë përfundimtar është që të bëhemi si Shpëtimtari dhe ai synim përmirësohet nga shërbimi ynë vetëmohues ndaj të tjerëve. Aftësia jonë për të shërbyer rritet ose zvogëlohet sipas nivelit të mbështetjes sonë te vetja.”

Vetëm kur bëhemi të pavarur, shtoi Plaku Hejls, ne “mund t’i përngjasim vërtet Shpëtimtarit në shërbimin dhe bekimin e të tjerëve”⁴.

Serxho Galbuçi e mësoi këtë të vërtetë kur filloi vetë biznesin e tij, pak pasi presidenca e kunjit e thirri atë si specialist të mbështetjes te vetja në kunj. I pajisur me besim, aftësi dhe njohuri që i kishte fituar si anëtar i komitetit, Serxhoja dhe bashkëshortja e tij, Silvia, hapën një dyqan në Buenos-Ajres që përfshinte “punime dore dhe ushqime” nga Argjentina.

“Mendoj se bërja i mbështetur te vetja është një mënyrë e të zbatuarit të besimit”, thotë Serxhoja. Më parë, ai dhe Silvia nuk e kishin gëzuar suksesin për të cilin kishin shpresuar, prandaj besimi mbeti në qendër të përpjekjes së tyre. Por ndërsa prisnin frytet financiare, ata punuan fort dhe i bekuan klientët me produktet e tyre dhe përpjekjet e tyre misionare.

“Ne njihemi me shumë njerëz”, thotë Serxhoja. “Dhe kemi pasur mundësinë që të japim kopje të Librit të Mormonit.”

Fillimisht, komiteti i mbështetjes te vetja në kunj përcaktoi 10 anëtarë në kunjin e Serxhos që kishin nevojë për ndihmë me mbështetjen te vetja. Por më pas u përfshinë [edhe] peshkopët.

“Tani, ne dimë për 35 individë në nevojë”, tha Serxhoja, teksa u shtua përpjekja. “Peshkopët e tyre i ftuan veçan ata që të merrnin pjesë në grupe.”





ZBULESA DHE MBËSHTETJA TE VETJA

Presidentat e kuneve dhe të distrikteve e zbatojnë, drejtojnë dhe udhëheqin nismën e Kishës për mbështetjen te vetja. Ata e bëjnë këtë duke punuar nga afër me Shoqatën e Ndhmës dhe duke formuar një komitet të mbështetjes te vetja.

Komiteti përfshin një anëtar të këshillit të lartë të kuneve, një pjesëtarë të presidencës së Shoqatës së Ndhmës në kune, kryetarin e këshillit të peshkopëve për mirëqenien dhe specialistët e mbështetjes te vetja në kune. Komiteti i trajnon dhe i nxit këshillat e lagjeve që të lutën rreth anëtarëve dhe t’i ftojë ata që të marrin pjesë në nismë. Ata organizojnë grupe të mbështetjes te vetja dhe punojnë me përgjegjësin vendor të Shërbimeve të Mbështetjes te Vetja për t’i mbledhur dhe për t’i shpërndarë burimet e komunitetit.

Nisma e Kishës për mbështetjen te vetja i ndihmon individët të marrin zbulime vetjake nëpërmjet bindjes ndaj parimeve kyç të ungjillit. “Ndërmjetësuesit thirren që të krijojnë një mjedis [nëpërmjet diskutimit ndërveprues] ku Fryma e Shenjtë mund t’ua mësojë pjesëmarrësve ‘të gjitha gjërat që [ata] duhet të bëjnë’ (2 Nefi 31:5; shihni edhe 2 Nefi 32:3).”⁵

Gjeni më shumë informacion në srs.lds.org.

Besimi i tyre lulëzoi, ata bënë ndryshimet e nevojshme dhe vunë në punë aftësi të reja.

“Sa herë që bisedoj me udhëheqës të priftërisë, unë përpiqem t’u shpreh atyre se ky është mjeti më fantastik që kemi marrë ndonjëherë nga Presidenca e Parë”, shton Serxhoja. “Është më i mirë se çdo shumë paraje që mund t’i jepej dikujt për ta ndihmuar, dhe mësimet e tij janë më të qarta se shumë materiale që kam mësuar kur isha një student universiteti.”

Mbi të gjitha, ata që i përfundojnë kurset e tyre 12-javore të mbështetjes te vetja bëhen dishepuj më të mirë të Jezu Krishtit dhe mësojnë se si t’i përdorin aftësitë e tyre në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë.

“Ky grup [i mbështetjes te vetja] nuk përqendrohet thjesht te biznesi ynë; ai përqendrohet te marrëdhënia jonë me Perëndinë dhe të tjerët”, thotë Serxhoja. “Ne



TË MBËSHTETUR TE VETJA DHE TË PAVARUR

“Kisha dhe anëtarët e saj urdhërohen nga Zoti të mbështeten te vetja dhe të jenë të pavarur.” (Shih DeB 78:13–14.)

“Përgjegjësia për mirëqenien shoqërore, emocionale, shpirtërore, fizike ose ekonomike të çdo personi bie së pari mbi atë vetë, së dyti mbi familjen e tij dhe së treti mbi Kishën nëse ai është anëtar besnik i saj.”

Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball (2006), f. 116.



bëhemi dishepuj më të mirë të Jezu Krishtit gjatë tri muajve që kalojmë në këtë grup. Në fund të fundit, ndoshta një biznes do të na ndihmojë të bëhemi më të mbështetur te vetja, por qëllimi përfundimtar është të shërbejmë.”

Rritje dhe Veprim

“Ka qenë gjithmonë një mësim themelor për shenjtorët e ditëve të mëvonshme”, tha Presidenti Jozef F. Smith (1838–1918), “se nga një fe që nuk e ka fuqinë për t’i shpëtuar njerëzit materialisht dhe për t’i bërë ata të begatë e të lumtur këtu, nuk mund të pritet që t’i shpëtojë ata shpirtërisht, për t’i ekzaltuar në jetën që do të vijë.”⁶

Atëherë, ne nuk duhet të habitemi që, nga forcimi i asaj që është materiale, ne forcojmë gjithashtu atë që është shpirtërore. Këtë varësi të ndërsjellë, Plaku Dejvid dhe Motra Tereza Nish, të cilët shërbyen si misionarë për mbështetjen te vetja në ishujt Solomon, e panë vetë mes anëtarëve të Kishës atje.

“Rritja shpirtërore dhe pjesëmarrja në tempull iu detyrohen qartësisht parimeve, aftësive dhe zakoneve të dhëna mësim te *Themeli Im* dhe shpjegimit gjithëpërfshirës te *Shtegu Im drejt Mbështetjes te Vetja*”, thonë ata për broshurat mbi nismën. “[Ato] po i ndihmojnë njerëzit të përparojnë si shpirtërisht edhe materialisht, duke i çuar drejt mbështetjes te vetja materialisht dhe shpirtërisht.”

Sheril Red, një ndërmjetësuese e mbështetjes te vetja në Juta të SHBA-së, shpjegon mënyrën se si parimet shpirtërore të nismës e kanë ndihmuar që të përparojë materialisht: “Kuptova se këto parime dhe themele mund të gjejnë zbatim në të gjitha aspektet e jetës sonë. Këto seminare praktike më kanë ndihmuar të bëhem më e përqendruar te përgjegjësitë e mia si bashkëshorte dhe nënë. Tani kam mjetet për t’i kuptuar më mirë financat familjare. E shoh se si të punuarit së bashku me bashkëshortët tanë për t’i administruar financat është, në njëfarë mënyre, një biznes. Ne kemi nevojë për këto mjete, që familjet tona t’ia dalin mbanë.”

Anëmbanë Kishës, kjo largpamësi e shtuar po përkthehet në një besnikëri të shtuar dhe forcë shpirtërore. Si rrjedhojë, anëtarët i kanë shtuar zotimet e tyre për të marrë pjesë në kishë, për ta paguar të dhjetën dhe për të qëndruar të denjë për në tempull.

“Ajo më tërhoqi vëmendjen”, thotë anëtari i ri, Xhorxh Eçevarría, për nismën e mbështetjes te vetja. Xhorxhi, që nget një taksì në Peru, thotë se nisma e ndihmoi atë të fitonte një dëshmi për ungjillin, ndërkohë që e mbushi me një dëshirë për t’u përmirësuar. Tani ai shpreson të bëhet elektrikist, që të rregullojë taksì të vogla trirotëshe që i ka ngarë për vite.

“Nuk duhet të ulemi e të presim që gjërat të ndodhin”, thotë ai. “Ne duhet të jemi vetëveprues.”

“Jeta Juaj do të Bekohet”

Shenjtore të ditëve të mëvonshme anembanë botës po korrin bekimet e premtuara të Zotit ndërsa i mësojnë, i jetojnë dhe i zbatojnë me zell parimet e mbështetjes materiale dhe shpirtërore te vetja. Ndërkohë që çdokush mund të përfitojë prej saj, nisma ka bekuar veçanërisht ata që, ose u mungon mbështetja materiale dhe shpirtërore te vetja, ose kanë nevojë ta forcojnë atë. Fondi i Qarkullueshëm Arsimor e mbështet nismën e mbështetjes te vetja duke i ndihmuar ata që kanë një plan për trajnimin arsimor, që të kenë qasje ndaj burimeve të nevojshme.

Shkrimet e shenjta premtojnë ndihmën e Zotit ndërsa punojmë drejt mbështetjes te vetja. Ai ka thënë: “Është qëllimi im për të siguruar për shenjtoret e mi” (DeB 104:15).

Duke komentuar mbi atë qëllim, Presidenca e Parë ka shpallur: “Kjo zbulësë është një premtim nga Zoti se Ai do të sigurojë bekime materiale dhe do ta hapë derën e mbështetjes te vetja, e cila është aftësia që t’i sigurojmë nevojat e jetës për veten dhe pjesëtarët e familjes sonë”.

Ndërsa i studiojmë, i zbatojmë dhe ua mësojmë këto parime pjesëtarëve të familjes, Presidenca e Parë premtton: “Jeta juaj do të bekohet. Ju do të mësoni se si të veproni në shtegun tuaj drejt mbështetjes më të madhe te vetja.



THELBI I FESË TONË

“Njësoj si dy anët e një monedhe, fizikja dhe shpirtërorja janë të pandashme. . . .

Kjo punë e ndihmës sipas mënyrës së Zotit nuk është thjesht një artikull tjetër në listën e programeve të Kishës.

Ajo nuk mund të mos përfillet apo të lihet mënjanë. Ajo është qendrore për doktrinën tonë, është thelbi i fesë sonë.”

Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, “Ndhima sipas Mënyrës së Zotit”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 53, 55–56.

Ju do të bekoheni me shpresë, paqe dhe përparim më të madh.”⁷ ■

SHËNIME

1. *Manuali 2: Administrimi i Kishës* [2010], 6.1.1.
2. Thomas S. Monson, “Guiding Principles of Personal and Family Welfare”, *Ensign*, shtator 1986, f. 3; shih edhe Marion D. Romney, në Welfare Services Meeting Report, 2 tetor 1976, f. 13.
3. Presidenca e Parë, në *Themeli Im: Parimet, Aftësitë, Zakonet* (broshurë, 2015), f. 2.
4. Robert D. Hales, “A Gospel Vision of Welfare: Faith in Action”, në *Basic Principles of Welfare and Self-Reliance* (broshurë, 2009), f. 2.
5. *You’re Invited: A Leader’s Guide to the Self-Reliance Initiative* (broshurë, 2016), f. 9.
6. *Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 164.
7. Presidenca e Parë, në *Themeli Im*, f. 2.



Shërbimi nuk është gjithmonë i volitshëm por, si baba dhe peshkop, Ilir Dodaj është përpjekur që t'u tregojë fëmijëve të tij se ia vlen gjithmonë.

CODY BELL, FOTOGRAF

Ilir Dodaj

Durrës, Shqipëri

Një motër e moshuar në lagje kishte tumor në stomak dhe kish-te nevojë për ndihmë çdo ditë, sepse nuk mund të lëvizte nga shtrati. Më në fund, ajo më pyeti nëse mund të shkoja vetëm unë, jo ndonjë mbajtës tjetër i priftërisë apo ndonjë person tjetër, ngaqë ajo ishte shumë e sëmurë dhe do të vdiste. Ajo u ndie e lehtësuar që peshkopi po e ndihmonte atë.

Një ditë bëra një operacion në zemër dhe për pak ditë nuk munda ta vizitoja atë. Kur shkova për ta takuar, ajo tha: "Peshkop, si mund të vini të më ndihmoni kur sapo keni bërë një operacion?"

I thashë asaj: "Thirrja ime është që t'u shërbej të tjerëve".

Shih më shumë foto të Peshkopit Dodaj dhe familjes së tij në lds.org/go/101738.

Për të mësuar më shumë rreth punës së një peshkopi, vizitoni lds.org/go/101739.





ATI QIELLOR KUJDESET PËR BIZNESIN TIM

Si një nënë beqare me pesë fëmijë, Sndjeva përgjegjësinë e madhe për të siguruar për familjen time. Unë punoj si pastruese në një shtëpi, por puna nuk më siguron mjaftueshëm të ardhura për familjen time. U bashkova me një grup të mbështetjes te vetja që të mund të mësoja se si ta përmirësoja situatën time.

U frymëzova nga grupi “Nisja dhe Rritja e Biznesit Tim” dhe vendosa se mund të qepja dhe të shisja qeska hermetike për tenxhere gatimi të ngadaltë. Qeskat i qepja natën vonë

kur kthehesha në shtëpi pas punës së ditës.

Një natë po punoja deri vonë për një porosi të madhe që e kishte afatin deri në mëngjes, kur makina qepëse ndaloi së punuari. Ishte mesnatë, kësh-tu që nuk do të kishte asnjë mekanik të mundshëm për të më ndihmuar. Makinaria shoqërohej me një kuti të vogël veglash, por unë kurrë më parë nuk kisha ndrequr makinë qepëse. Nuk e kisha idenë se nga t’ia nisja.

Pastaj më erdhi në mendje mësimi në manualin *Themeli Im* që titullohej

“Ushtroni Besim te Jezu Krishti”. Në atë çast, unë e dija se duhej ta vendosja besimin tim te Zoti. Rashë në gjunjë dhe u luta: “Atë Qiellor, të lutem më ndihmo ta ndreq këtë makinë, me qëllim që ta mbaroj porosinë që klienti im ta marrë në mëngjes. Atë Qiellor, më ndihmo!”

Pastaj pata përshtypjen e qartë që ta merrja kaçavidën nga kutia e veglave dhe ta përdorja për të shtyrë mbi një pjesë të makinës qepëse. Kështu bëra, duke u mbështetur plotësisht në besimin tim. Mbahta frymën pezull kur po e ndizja sërish makinën. Funkciononte!

Unë qeshë në gjendje ta mbaroja në kohë porosinë. Zbulova se ç’do të thotë të kesh Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin si ortakë biznesi. Unë e di se do të vazhdoj të bekohem ndërsa kërkoj mundësi për të zbatuar atë që kam mësuar në grupin e mbështetjes te vetja. ■

Buizile Zuma, KuaZulu-Natal, Afrika e Jugut

Një natë po punoja deri vonë për një porosi të madhe që e kishte afatin deri në mëngjes, kur makina qepëse ndaloi së punuari.



NJË PËRGJIGJE E FRYMËZUAR GJATË NJË INTERVISTE PUNE

Pasi isha caktuar që të udhëhiqja një komitet kunji për mbështetjen te vetja, unë kuptova se e kisha lënë veten të punësohesha në nivel më të ulët nga ç' meritoja. Kur e kuptova këtë, pata dëshirë të arrija më shumë nga jeta ime profesionale.

Ndjeva një dëshirë të përtërirë për të gjetur një punë më të mirë dhe kërkova ndihmë për të shkruar një jetëshkrim [CV] profesional. Ia dërgova jetëshkrimin tim të ri disa bizneseve dhe shumë shpejt më thirrën për intervistë.

Në një prej bizneseve, intervistuesi nxori në pah një rresht nga jetëshkrimi im, që përmendte punën time si këshilltar në presidencën e kunjit dhe më pyeti: "A mund të më tregosh në pak sekonda se çfarë do të thotë ky shërbim fetar?"

Unë i thashë se isha në kryesinë e një organizate përgjegjëse për udhërrëfimin dhe mirëqenien e më shumë se 2 500 njerëzve. Intervistuesi u bë kureshtar dhe tha: "Ke një minutë kohë për të vendosur se si të më japësh një përgjigje prej pesë sekondash për këtë pyetje: Si i udhërrëfen ata 2 500 njerëz?"

E dija se ky do të ishte momenti vendimtar i intervistës. Iu luta dhe i kërkova ndihmë Atit Qiellor dhe shpejt m'u kujtuan mësimet që kisha mësuar nga grupi i mbështetjes te vetja. Ndjeva një valë sigurie te vetja.



Pas një minute, intervistuesi më pyeti: "Si i udhërrëfen ata 2 500 njerëz?"

"Ne i ndihmojmë ata të vendosin qëllime", u përgjigja unë.

Edija se ato pesë sekonda do të ishin momenti vendimtar i intervistës. Iu luta dhe i kërkova ndihmë Atit Qiellor.

Intervistuesi u ngrit në këmbë, më shtrëngoi dorën dhe më tha: "Je i punësuar".

Është e mahnitshme se si Perëndia më dha dorë dhe iu përgjigji lutjes sime. I jam mirënjohës Shpëtimtarit tim që i frymëzoi udhëheqësit tanë që të krijonin nismën për mbështetjen te vetja.

Unë kam qenë personalisht i bekuar nga ajo dhe i kam parë proceset e thjeshta e të frymëzuara të nismës për mbështetjen te vetja, që të bekojnë shumë njerëz të tjerë në kunjin tonë. Unë jam kaq i bindur për mundësinë që kanë parimet e mbështetjes te vetja për të lartësuar jetë, sa që kur u bëra udhëheqësi i 15 punonjësve në punën time të re, fillova t'u mësoja atyre parimet e mbështetjes te vetja.

Unë jam zhvilluar dhe jam më i aftë nga sa mendova se mund të isha. Tani unë marr një pagë që i mbulon shpenzimet e mia dhe të familjes sime. Kjo nismë na ndihmon që të përmirësohemi çdo ditë duke na ndihmuar që të gjejmë një mbështetje më të madhe te vetja. ■

Gibrair Padija Dos Santos,
San-Paulo, Brazil

RRITJA E BIZNESIT TIM TË KEKUT ME MIELL ORIZI

Unë dëshiroja ta dërgoja tim bir në mision, por shitja e një kilogrami *bibingka* (keku me miell orizi) në javë nuk ishte e mjaftueshme që të isha në gjendja ta mbështetja atë financiarisht për një mision.

Im bir e ndihmonte familjen financiarisht dhe ishte tepër i shqetësuar për largimin për shkak të gjendjes sonë financiare. Fitimi i parave ishte një mundim i vazhdueshëm për familjen tonë. Isha krenare për djalin tim 25-vjeçar – për dëshirën e tij të drejtë që t'i shërbente Zotit, por kuptova se do të na duhej ndonjë lloj mrekullie që ta bënim realitet

ëndrrën e tij që të shërbente në një mision.

Unë u bashkova me një grup të mbështetjes te vetja. Duke qenë aktive dhe duke e ushtruar besimin tim, unë e dija se familja ime do të bekohej. Gjatë një mbledhjeje, unë ndjeva nxitjen që të shkoja në një treg publik. Atje pashë shumë gra që shisnin meze vendase. Unë rashë në ujdj me një grua. I thashë se do t'ia lija asaj në mëngjes produktet e mia që t'i shiste dhe do të merrja përfitimet në fund të ditës. Marrëveshja që e dobishme për të dyja ne. Shumë shpejt gjeta më shumë shitës. Biznesi im u

rrit deri në 10 shitës gjatë kohës që isha në grupin e mbështetjes te vetja.

Mësova t'i ndaja paratë e mia vetjake nga paratë e biznesit dhe të nxirra një rrogë për veten. Mësova se nuk duhej të humbja kohë duke bërë produkte që nuk shiteshin, dhe në vend të kësaj të përqendrohesh tek ajo që ishte me përfitim. Unë mësova gjithashtu rreth reklamimit në mjetet shoqërore të informimit. Partneri im në veprim nga grupi i mbështetjes te vetja më ndihmoi të krijoja një llogari Facebook-u. Atje, ne mësuam për markën dhe paketimin. Përfundimisht biznesi im u rrit deri në pikën saqë bashkëshorti im mund ta



TË FITOSH RESPEKT PËR VETEN NËPËRMJET MBËSHTETJES TE VETJA

linte punën e tij të vështirë fizike dhe të punonte me mua.

Dikush më pyeti kohët e fundit se si po më ecnin shitjet. Me krenari i thashë atij se tani po shes 12 kilogram kek me miell orizi.

“12 kilogram në javë është mrekulli!” tha ai.

“Jo, vëlla”, thashë unë. “Unë shes 12 kilogram *në ditë*.”

Im bir më vonë më tha se ishte i lumtur që biznesi im mund të siguron-te tani për nevojat tona.

“Tani më duket se mund të shërbej në një mision me kohë të plotë”, tha ai.

Tani ai po shërben në misionin e San-Pablos, Filipine. I jam kaq mirënjohëse nismës për mbështetjen te vetja. Zoti e kishte me të vërtetë kur tha: “Është qëllimi im për të siguruar për shenjtorët e mi” (DeB 104:15). ■

Lordita Jagomiom, Misamis Oksidental, Filipine

Gjatë një mbledhjeje të grupit të mbështetjes te vetja, unë ndjeva nxitjen që të shkoja në një treg publik. Unë rashë në ujdi me një grua për të shitur kekët e mi me miell orizi.

Unë isha i martuar, kisha tre fëmijë dhe isha i papunë. Mungesa e mundësive për punësim më bëri të ndihesha i pashpresë. Unë u shqetësova për sigurinë e familjes sime dhe ndala së besuari në vetvete.

Gruaja ime, Karla, më nxiti të merrja pjesë në një grup të mbështetjes te vetja. Ishte e sikletshme për mua që të pranoja se nuk kisha punë, por ajo më nxiti të merrja pjesë në grup, që të mund të kujdesesha për familjen tonë.

Me ngurrim e provova njëherë. Ndërkohë që merrja pjesë në grup, unë kuptova se aftësitë e mia në anglisht mund të ishin një armë e vlefshme në tregun e punës. Kisha studiuar anglisht gjatë misionit tim, por dija vetëm se si të flisja rreth fesë. U regjistrova në kurset e anglishtes të ofruara nga Kisha për të përmirësuar fjalorin tim. Kur u ktheva në shtëpi nga kursi i anglishtes një ditë, Karla më kaloi telefonin.

“Kush është?”, e pyeta.

“Nuk e di”, u përgjigj ajo. “Ata po flasin anglisht.”

Ishte një përfaqësues i burimeve

njerëzore nga një prej kompanive më të mëdha në Kosta-Rika që kërkonte të më intervistonte. Mbeta i shtangur, por intervista shkoi jashtëzakonisht mirë. Më vonë mësova se intervistën e kishte organizuar Karla.

E fitova vendin e punës dhe solla ndërmend se si më ndihmoi grupi im i mbështetjes te vetja. Pastaj mendova se si mund ta zbatoja më mirë atë që kisha mësuar. Fillova të kërkoja për një punë edhe më të mirë dhe e gjeta. Pastaj punova për hapjen e biznesit tim të ndërtimit.

Nuk mund ta përfytyroj se ku do të ishim unë dhe familja ime pa fillesën që morëm nga nisma për mbështetjen te vetja. Unë mësova të jem i përvullur dhe t’i kërkoj ndihmë Zotit. Unë mësova gjithashtu t’i lejoja që ta bekonin jetën time ata, të cilët donin të më ndihmonin. Ne kemi kaq shumë bekime. Tani unë kam respekt për veten dhe mund ta bekoj familjen time me paratë që fitoj. Unë e di se Shpirti na bekon kur ne jemi të përvullur. ■

Hoze Alberto Navas (siç iu tregua Miriam Suinit), San-Hoze, Kosta-Rika



Pesë Mësime për Të Rinjtë në Moshë Madhore nga Apostujt e Rinj

Nga Methju C. Gadfri

Sektori i Historisë së Kishës

Ata ishin midis moshave 23 dhe 35 vjeç, prapëseprapë ndihmuan në ndryshimin e botës. Apostujt e parë të Kishës së

rivendosur ishin të rinj në moshë. Disa u ndien të papërshtatshëm. Disa bënë gabime. Por ata të gjithë sollën një ndryshim. Ja pesë mësimet që mund t'i mësojmë nga përvoja e tyre.

1. Nuk Ju Duhet të Ndiheni Mjaft të Mirë që të Jeni Mjaft të Mirë


Hibër C. Kimballi u ndie i papërshtatshëm kur mori thirrjen e tij në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve në shkurt të vitit 1835. Ai kishte qenë në Kishë për më pak se tre vjet dhe ishte vetëm 33 vjeç.


“Ishte shumë më tepër nga ç’e prisja”, tregoi Hibëri

Çfarë mund të mësojmë sot nga përvoja e Apostujve të parë të Rivendosjes?

më vonë.¹ Por ishte i gatshëm ta pranonte thirrjen dhe, në bekimin e tij të shugurimit, atij iu tha “se shumë miliona njerëzish” do të “ktheheshin në besim nëpërmjet ndihmesës së tij”².

Si Apostull ai shërbeu dy misionetepër të suksesshme në Angli. Ai ktheu në besim një mori individësh, pasardhësit e të cilëve mund të numërohen fare mirë në miliona veta sot. Për Hibërin, ecja përpara edhe kur e ndiente se kishte pak për të dhënë, e bekoj atë dhe shumë të tjerë.





2. Ne Përcaktohem nga Vendimet, Jo nga Rrethanat

Tomas B. Marshi u largua nga shtëpia në Nju-Hempshër në moshën 14-vjeçare. Ai punoi si krah pune në një fermë në Vermont, si kamerier në Albani të Nju-Jorkut, në një hotel në Nju-Jork-Siti dhe më pas si shërbëtor në Long-Ajllënd. Rrethanat e tij ishin të paqëndrueshme derisa u takua dhe u martua me Elizabeta Gadkinin.

Ai dhe Elizabeta më së fundi u udhëhoqën nga Shpirti drejt Nju-Jorkut perëndimor. Atje, ata dëgjuan rreth

Librit të Mormonit. Tomasi pa kopje të 16 faqeve të para teksa dolën nga shtypshkronja dhe botuesi e lejoi që ta lexonte fletën e redaktuar. Duke besuar që libri ishte nga Perëndia, Tomasi zgjodhi të bashkohej me Kishën. Ai u pagëzua më 3 shtator 1830.³

Tomasi e predikoi ungjillin në zona të ndryshme. Ai duroi mundime kur shenjtorët u dëbuan nga konteja Xhekson në Misuri, në nëntor të vitit 1833. Ishte një anëtar fillestar i këshillit të lartë në Misuri, kur ai u organizua

në korrik të vitit 1834. Pas thirrjes së tij si Apostull në moshën 34-vjeçare, ai shërbeu si President i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve. Edhe pse e kishte mbrojtur me zell Jozef Smithin kundrejt kundërshtarëve në të shkuarën, Tomasi vetë u bë më pas i zhgënjyer. Në vitin 1838 ai zgjodhi të largohej nga Kisha.⁴


Nga Tomas Marshi mund të mësojmë se rrethanat e paqëndrueshme nuk duhet të na mbajnë larg nga bekimet e ungjillit – ose nga bekimi i jetëve të tjerëve.

3. Jini të Kujdesshëm: Askush Nuk Është Tepër i Mirë sa të Mos Bjerë

Lajmën Xhonsoni ishte më i riu i atyre që u thirrën – 23 vjeç e katër muaj në atë kohë. Ai ishte shuguruar prift i lartë vetëm pak ditë pasi mbushi 20 vjeç në vitin 1831 dhe tashmë kishte shërbyer në disa misione për Kishën. Ndërkohë që ishte në njërin prej këtyre misioneve, ai bëri një predikim që mbahet mend se ishte “njëra nga dëshmitë më të fuqishme për sa i përket misionit të Jozef Smithit dhe punës së madhërishtme të ditëve të fundit”⁵.

Për fat të keq, shërbimi i Lajmënit si Apostull nuk zgjati shumë. Gjatë trazirës ekonomike në Kirtland të Ohajos, në vitin 1837, ai u kthye kundër Jozef Smithit. Lajmëni u shkishërua në vitin 1838.


Pavarësisht se sa mirë mund të predikonte, pavarësisht se çfarë detyre mbajti në Kishë, Lajmëni prapëseprapë u largua. Brigam Jangu tha që Lajmëni më vonë e pranoi se dëshironte që ende të mund të besonte në ungjillin: “Isha plot gëzim dhe kënaqësi. . . . Isha i lumtur ditën dhe natën. . . . Por tani është errësirë, dhembje, hidhërim, mjerim i skajshëm.”⁶



4. Bindja Nuk Garanton Lehtësi, por ia Vlen

Pasi Parli P. Prati u shugurua Apostull, Oliver Kaudëri, njëri prej atyre që u caktuan të ndihmonin në përzgjedhjen e Apostujve, i ngarkoi Parlit një detyrë të veçantë, duke thënë se ai do të “haste të njëjtat vështirësi në përmbushjen e kësaj shërbese, që i kishin pasur Apostujt e lashtë”. Ai tha që Parli do të ndeshej me “biruca të rënda dhe burgje të zymtë”, por rrethana të tilla nuk duhej ta frikësonin, ngaqë sprovat do ta bënin të aftë “të merrte lavdinë” që Zoti e kishte ruajtur për të.⁷

Jeta e Parlit e ndoqi atë model. Me raste ai u përball me një varfëri dërrmuese. Përjetoi tallje teksa predikonte ungjillin. U burgos në vitet 1838 e 1839 për akuza që erdhën si rrjedhojë e vështirësive me të cilat u përballën anëtarët e Kishës në Misuri. Prapëseprapë Parli i përjetoi edhe bekimet që kishte premtuar Oliveri. Jo shumë kohë pasi u lirua nga burgu, ai shkroi: “Jemi mirë dhe kemi përparuar shumë në Zotin, pas gjithë mundimit tonë”⁸.



5. Moshë Nuk Ka po aq Rëndësi sa Besimi

Orson Prati, vëllai i Parlit, ishte Apostulli i dytë më i ri në moshë. I shuguruar në moshën 23-vjeçare, ai ishte vetëm pak javë më i madh në moshë sesa Lajmën Xhonsoni. Shërbimi që Orsoni tashmë ia kishte dhënë Kishës, jep një shembull të shkëlqyer se si të rinjtë në moshë madhore mund të jenë një forcë për mirë.

Orsoni u pagëzua më 19 shtator 1830 – në ditëlindjen e tij të 19-të. Pak kohë më pas, Jozef Smithi mori një zbulësë për të dhe tha se Orsoni ishte biri i Perëndisë, se ai u bekua ngaqë besoi dhe se përgjegjësia e tij ishte të predikonte ungjillin (shih DeB 34:3–6). Në përputhje me këtë, Orsoni shërbeu misionë të shumta, përfshirë një me Lajmën Xhonsonin në vitin 1832, në të cilin ata pagëzuan gati 100 individë dhe shuguruan disa pleq.

Kur Orsoni u thirr si Apostull, ai

nuk ishte në Kirtland. Më 23 prill 1835, në qytetin e Kolombusit, ai mësoi se kërkohej prania e tij në një mbledhje në Kirtland më 26 prill.

Pa e ditur qëllimin e mbledhjes, ai menjëherë u nis për atje. Pa e ditur se ishte thirrur si Apostull, ai hyri ndërsa bashkësia po “lutej dhe po shprehte dëshirën për mbërritjen e tij”⁹. Duke e ndier përkrahjen e shenjtoreve, Orsoni e pranoi thirrjen e tij.

Si Apostull, ai përgatiti një broshurë që përmbante rrëfimin më të hershëm, të shtypur, të Vegimit të Parë të Jozef Smithit. Si pionier në vitin 1847, ai mbajti një anal të hollësishëm të udhëtimit drejt perëndimit. Ai shkroi edhe shumë broshura për misionarët dhe ishte mbrojtës i fortë i Librit të Mormonit.

Sot Është Ndryshe . . . ose a Është Vërtet?


Në shumë mënyra, të rinjtë në moshë madhore janë të ndryshëm

sot nga ata që ishin në vitin 1835. Dhe prapëseprapë këto mësimë mund t'i ndihmojnë të rinjtë në moshë madhore sot në përpjekjet e tyre që të jetojnë sipas potencialit të tyre. Ja një përmbledhje:

- Nëse ndiheni të papërshtatshëm, ecni përpara gjithsesi.
- Çdo njeri ka sfida. Ju mund t'i mposhtni sfidat tuaja.
- Do të jeni më të lumtur nëse qëndroni aktivë në Kishë.
- Qëndroni të zotuar. Jini të bindur e besnikë. Bekimet do të vijnë.
- Keni diçka të rëndësishme për ta dhënë. Zoti e ka vënë besimin te ju. ■

SHËNIME

1. “Extracts from H. C. Kimball’s Journal”, *Times and Seasons*, 15 prill 1845, f. 868.
2. “Minutes, Discourse, and Blessings, 14–15 February 1835”, në *The Joseph Smith Papers, Documents, Vëllimi 4: prill 1834–shtator 1835*, red. Matthew C. Godfrey dhe të tjerë (2016), f. 229.
3. Shih “History of Thomas Baldwin Marsh”, *The Deseret News*, 24 mars 1858, f. 18.
4. Shih “History of Thomas Baldwin Marsh”, *The Deseret News*, 24 mars 1858, f. 18; Kay Darowski, “The Faith and Fall of Thomas Marsh”, në *Revelations in Context: The Stories behind the Sections of the Doctrine and Covenants*, Matthew McBride dhe James Goldberg, red. (2016), f. 57–59.
5. Edward W. Tullidge, *Tullidge’s Histories* (1889), vëll. 2 (shtesë), f. 175.
6. Brigham Young, Discourse, 17 qershor 1877, në *Journal of Discourses*, 19:41.
7. Oliver Cowdery, në “Minutes and Blessings, 21 February, 1835”, në *Joseph Smith Papers, Documents, Vëllimi 4: prill 1834–shtator 1835*, f. 240–241.
8. “Letter from Parley P. Pratt, 22 November 1839”, josephsmithpapers.org/paper-summary/letter-from-parley-p-pratt-22-november-1839/1.
9. “Extracts from H. C. Kimball’s Journal”, *Times and Seasons*, 15 prill 1845, f. 869.



Thirrja e Apostujve Fillestarë të Rivendosjes

Më 8 shkurt 1835, Jozef Smithi u kërkoi vëllezërve Brigam dhe Jozef Jang që të këndonin për të. Profeti mori atëherë një zbulësë që ishte koha që të thirreshin Dymbëdhjetë Apostujt.¹

Jozef Smithi i kërkoi Brigamit të nxirrte një njoftim se një konferencë do të mbahej të shtunën e ardhshme. Ai i tha Brigamit se do të ishte një nga Të Dymbëdhjetët.²

Gjashtë ditë më vonë, shenjtorët u mblodhën. Jozef Smithi tha se një nga qëllimet kryesore të mbledhjes ishte që Tre Dëshmitarët e Librit të Mormonit – Oliver Kaudëri, Dejvid Uitmeri dhe Martin Harris – “të zgjidhnin dymbëdhjetë burra nga kisha si Apostujt”.³ Oliveri dhe Dejvidi e kishin marrë më parë atë detyrë në qershor 1829, por, megjithëse ata i patën “kërkuar Zotit me agjërime dhe me lutje” për të përcaktuar Të Dymbëdhjetët, koha e duhur ende nuk pati ardhur.⁴ Tani, tha Jozefi, koha pati ardhur.

Të Dymbëdhjetët (sipas radhës së paraqitur në mbledhje) ishin Lajmën Xhonsoni, mosha 23 vjeç; Brigam Jangu, 33 vjeç; Hibër C. Kimballi, 33 vjeç; Orsën Hajdi, 30 vjeç; Dejvid W. Pateni, 35 vjeç; Ljuk Xhonsoni, 27 vjeç;

Uilliam E. Mek-Lelini, 29 vjeç; Xhon F. Bojntëni, 23 vjeç; Orson Prati, 23 vjeç; Uilliam Smithi, 23 vjeç; Tomas B. Marshi, 34 vjeç; dhe Parli P. Prati, 27 vjeç. Të gjithë patën shërbyer më parë në misione. Tetë e patën shoqëruar Jozef Smithin në ekspeditën e Kampit të Sionit verën e kaluar.⁵

Pas caktimit të tyre, secili nga Apostujt u shugurua.⁶ Bekimet e shugurimit të tyre u plotësuan me premtime suksesi misionar. Hibër C. Kimballi më vonë kujtonte që bekimet “parashihnin shumë gjëra që duhej të ndodhnin, që ne duhet të kishim fuqinë për të shëruar të sëmurin, të dëbonim demonët, të ngjallnim të vdekurin, t’i jepnim shikim të verbrit, . . . të lëviznim male dhe të gjitha gjërat duhet të jenë të nënshtruara ndaj nesh nëpërmjet emrit të Jezu Krishtit”.⁷

Oliver Kaudëri theksoi gjithashtu vështirësitë me të cilat do të përballehin: “Jini të përgatitur në çdo kohë të sakrifikoni jetën tuaj, nëse Perëndia do t’ua kërkonte atë për përparimin dhe ngritjen e kauzës së tij”. Oliveri i nxiti Apostujt të kërkonin njohje vetjake të Jezu Krishtit në mënyrë që të mund të dëshmonin për ekzistencën e Tij me

siguri: “Kurrë mos pushoni së përpjekuri gjersa ta keni parë Perëndinë, sy më sy”⁸.

Duke filluar nga maji i vitit 1835, Apostujt ndërmorën disa misione kthimi në besim për Kishën dhe udhëheqja e tyre e përgjithshme gjithashtu bekoji shumë njerëz. ■

SHËNIME

1. Shih History, 1838–1856 (Manuscript History of the Church), vëllimi B-1 [1 shtator 1834–2 nëntor 1838], shtojcat, shënim A, faqe 1, josephsmithpapers.org/paper-summary/history-1838-1856-volume-b-1-1-september-1834-2-november-1838/304.
2. Shih Joseph Young, *History of the Organization of the Seventies* (1878), f. 1.
3. “Minutes, Discourses, and Blessings, 14–15 February 1835”, në *Joseph Smith Papers, Documents, Vëllimi 4: prill 1834–shtator 1835*, f. 224–228.
4. “Minutes and Blessings, 21 February 1835”, në *Joseph Smith Papers, Documents, Vëllimi 4: prill 1834–shtator 1835*, f. 242, 243.
5. Katër vetat që nuk ishin pjesë e kampit, ishin Dejvid W. Pateni, Tomas B. Marshi, Uilliam E. Mek-Lelini dhe Xhon F. Bojntoni.
6. Vetëm nëntë nga Të Dymbëdhjetët ishin të pranishëm në mbledhjen e 14 shkurtit 1835. Parli P. Prati u shugurua më 21 shkurt 1835, ndërsa Tomas B. Marshi dhe Orson Prati u shuguruan të dy më 26 prill 1835.
7. “Extracts from H. C. Kimball’s Journal”, *Times and Seasons*, 15 prill 1845, f. 868.
8. “Minutes and Blessings, 21 February 1835”, në *Joseph Smith Papers, Documents, Vëllimi 4: prill 1834–shtator 1835*, f. 244.

Për të mësuar më shumë rreth thirrjes së Dymbëdhjetë Apostujve fillestarë në këtë periudhë ungjillore, shkoni te [history.lds.org](https://www.history.lds.org).



**Nga Plaku
Dejvid A. Bednar,**
i Kuorunit të
Dymbëdhjetë Apostujve

Një KARAKTER si i Krishtit

*Jezusi, i cili vuajti më shumë nga të gjithë, ka dhembshurinë
më të madhe për të gjithë ne që vuajmë shumë më pak.*

Plaku Nil A. Maksuell (1926–2004) dha mësim një parim që më ka lënë mbresë thellësisht dhe që ka qenë përqendrimi i shumë prej studimit, reflektimit dhe përsiatjes sime. Ai tha: “Nuk mund të kishte pasur Shlyerje pa karakterin e Krishtit!”¹ Që kur e dëgjova këtë thënie të drejtpërdrejtë dhe përshkuese, jam përpjekur të mësoj më shumë rreth fjalës “karakter” dhe ta kuptoj më mirë atë fjalë. Gjithashtu kam përsiatur rreth marrëdhënies midis karakterit të Krishtit dhe Shlyerjes së Tij – dhe rrjedhojave të asaj marrëdhënieje për secilin prej nesh si dishepuj.

Karakterit i Zotit Jezu Krisht

Ndoshta treguesi më i madh i karakterit është aftësia për të dalluar dhe për t’iu përgjigjur siç duhet njerëzve të tjerë, të cilët po përjetojnë po të njëjtën sfidë apo fatkeqësi që po rëndon mbi ne, në mënyrën më të menjëhershme dhe më detyruese. Karakteri zbulohet, për shembull, në fuqinë për të dalluar vuajtjen e njerëzve të tjerë kur ne vetë po vuajmë; në aftësinë për të dalluar urinë e të tjerëve kur ne jemi të uritur; dhe në fuqinë për të ndihmuar dhe dhënë dhembshuri për agoninë shpirtërore të të tjerëve kur ne jemi në mes të vetë ankthit tonë shpirtëror. Kështu, karakteri shfaqet duke kërkuar dhe duke u drejtuar jashtë vetes, kur përgjigja e natyrshme dhe instinktive është që të jemi të përqendruar te vetja dhe të kthehemi drejt vetes sonë. Nëse një zotësi e tillë është me të vërtetë kriteri përfundimtar i karakterit moral, atëherë Shpëtimtari i botës është shembulli i përsosur i një karakteri të tillë, të qëndrueshëm dhe bamirës.





Shembuj të Karakterit të Krishtit

Në dhomën e sipërme, në natën e Darkës së Fundit, pikërisht natën gjatë së cilës Ai do të përjetonte vuajtjen më të madhe që ndodhi ndonjëherë në të gjitha botët e krijuara prej Tij, Krishti foli rreth Ngushëlluesit dhe paqes:

“Ju kam thënë këto gjëra, ndërkaq jam me ju;

por Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t’ju mësojë çdo gjë dhe do t’ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë.

Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë” (Gjoni 14:25–27).

Duke e dalluar që Ai Vetë do të përjetonte së shpejti në mënyrë të fuqishme dhe vetjake mungesën si të ngushëllimit ashtu edhe të paqes dhe në një çast kur zemra e Tij ndoshta ishte e shqetësuar dhe e frikësuar, Mësuesi iu drejtua të tjerëve dhe u

ofroi atyre pikërisht bekimet që mund dhe do ta kishin forcuar Atë.

Në Lutjen e madhërisme Ndërmjetësuese, të ofruar pikërisht përpara se Jezusi të shkonte me dishepujt e Tij përtej përroit të Kedronit drejt Kopshtit të Gjetsemanit, Mësuesi u lut për dishepujt e Tij dhe për të gjithë “ata që do të besojnë në mua me anë të fjalës së tyre,

që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua. . . .

. . . Që të jenë të përsosur në unitet dhe që bota të njohë që ti më ke dërguar dhe që i ke dashur, ashtu si më ke dashur mua. . . .

Dhe unë i kam bërë të njohin emrin tënd dhe do të bëj ta njohin akoma, që dashuria, me të cilën ti më ke dashur mua, të jetë në ta dhe unë në ta” (Gjoni 17:20, 21, 23, 26).

E gjej veten duke bërë në mënyrë të përsëritur pyetjet vijuese, ndërkohë që përsiat këtë dhe ngjarje të tjera që ndodhën kaq pranë tradhtisë

që provoi Ai, dhe vuajtjes së Tij në kopsht: Si mund të lutej Ai për mirëqenien dhe unitetin e të tjerëve pikërisht përpara vetë ankthit të Tij? Çfarë e aftësoi Atë që të kërkonte ngushëllim e paqe për ata nevoja e të cilëve ishte shumë më e paktë se e Tija? Teksa natyra e rënë e botës që krijoi Ai, rëndonte mbi Të, si mund të përqendrohej Ai kaq tërësisht dhe kaq veçanërisht te kushtet dhe shqetësimet e të tjerëve? Si ishte në gjendje Mësuesi të drejtohej jashtë vetes kur një qenie më e ulët do të ishte kthyer drejt vetes? Një thënie nga Plaku Maksuell siguron përgjigjen për secilën prej këtyre pyetjeve të fuqishme:

“Karakterit i Jezusit siguroi përkrahjen e duhur për shlyerjen e Tij të mrekullueshme. Pa karakterin e madhërisëm të Jezusit, nuk do të kishte pasur asnjë shlyerje të madhërisme! Karakteri i Tij është i tillë që Ai [vuajtji] tundime të çdo lloji’ (Alma 7:11), prapëseprapë Ai ‘nuk ua vuri veshin’ tundimeve (DeB 20:22).”²

Jezusi, i cili vuajti më shumë nga të gjithë, ka dhembshurinë më të madhe për të gjithë ne që vuajmë shumë më pak. Me të vërtetë, thellësia e vuajtjes dhe e dhembshurisë është e lidhur ngushtë me thellësinë e dashurisë që ndihet nga shërbestari.

Kërkimi Aktiv i Dashurisë Hyjnore

Në vdekshmëri, ne mund të kërkojmë që të bekohemi me elemente thelbësore të një karakteri si të Krishtit dhe t’i zhvillojmë ato elemente. Me të vërtetë, është e mundshme për ne

si njerëz të vdekshëm, që të përpiqemi me drejtësi për të marrë dhuratat shpirtërore të cilat lidhen me aftësinë për t'iu drejtuar jashtë vetes dhe për t'iu përgjigjur siç duhet njerëzve të tjerë që po përjetojnë po të njëjtën sfidë apo fatkeqësi që po rëndon mbi ne, në mënyrën më të menjëhershme dhe më detyruese. Ne nuk mund ta fitojmë një aftësi të tillë nëpërmjet vullnetit tërësor apo vendosmërisë vetjake. Përkundrazi, na nevojiten dhe jemi të varur tek “merit[at] dhe mëshir[a] dhe hiri [i] Mesias së Shenjtë” (2 Nefi 2:8). Por “rresht pas rreshti, parim pas parimi” (2 Nefi 28:30) dhe “me kalimin e kohës” (Moisiu 7:21), ne aftësohemi që të drejtohemi jashtë vetes kur prirja e natyrshme është që të kthehemi drejt vetes sonë.

Më lejoni të sugjeroj që ju dhe unë duhet të lutemi, të jemi të etur, të përpiqemi dhe të punojmë që të kultivojmë një karakter si i Krishtit, në qoftë se shpresojmë që të marrim dhuratën shpirtërore të dashurisë hyjnore – dashurinë e pastër të Krishtit. Dashuria hyjnore nuk është një tipar apo karakteristikë që e fitojmë vetëm nëpërmjet këmbënguljes dhe vendosmërisë sonë qëllimplotë. Me të vërtetë, ne duhet t'i nderojmë besëlidhjet tona dhe të jetojmë denjësisht, dhe të bëjmë gjithçka mundemi që të kualifikohemi për dhuratën; por më së fundi, dhurata e dashurisë hyjnore na zotëron ne – ne nuk e zotërojmë atë (shih Moroni 7:47). Zoti e përcakton nëse i marrim të gjitha dhuratat shpirtërore dhe kur i marrim ato, por ne duhet të bëjmë gjithçka që kemi fuqi për t'i dëshiruar, për të qenë



të etur, për t'i ftuar dhe për t'u kualifikuar për dhurata të tilla. Teksa veprojmë gjithnjë e më shumë në një mënyrë të pajtueshme me karakterin e Krishtit, atëherë ndoshta po i tregojmë qiellit në mënyrën më të fuqishme dëshirën tonë për dhuratën e hyjnishtme shpirtërore të dashurisë hyjnore. Dhe qartësisht ne po bekohemi me këtë dhuratë të mrekullueshme teksa drejtohemi jashtë vetes gjithnjë e më shumë, kur burri apo gruaja e natyrshme brenda nesh do të kthehej në mënyrë tipike drejt vetes.

Jezusi është Krishti, Biri i Vetëmlindur i Atit të Amshuar. Unë e di se Ai jeton. Dhe dëshmoj se karakteri i Tij bëri të mundur për ne mundësitë si për pavdekësinë ashtu edhe për jetën e përjetshme. U drejtofshim jashtë vetes kur prirja e natyrshme për ne është që të kthehemi drejt vetes. ■


Nga një fjalim në Simpoziumin e Fesë të Universitetit “Brigam Jang” – Ajdaho, mbajtur më 25 janar 2003.

SHËNIME

1. Neal A. Maxwell, “The Holy Ghost: Glorifying Christ”, *Ensign*, korrik 2002, f. 58.
2. Neal A. Maxwell, “O How Great the Plan of Our God!” (fjalim drejtuar mësuesve të fesë të Sistemit Arsimor të Kishës, 3 shkurt 1995), f. 6, si.lds.org.

Si Mundet një Mesazh nga
Konferenca ta

NDRYSHOJË JETËN TUAJ



*Ju vërtet mund të bëheni më shumë si Jezu Krishti.
Këto mjete do t'ju ndihmojnë ta kuptoni se si.*

Nga Hadli Grigs

Ndiheni shpirtërisht paksa të rënë? A mendoni se mund të përdorni një udhëzim të vogël shpirtëror? Në rregull, jeni me fat, sepse konferenca e përgjithshme mund të jetë saktësisht kyçi! Plaku Robert D. Hejls, i Kuroumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ka thënë: “Anëtarë të rinj në moshë të Kishës, ju premtoj se, nëse do të dëgjoni [konferencën e përgjithshme], ju do ta ndieni Shpirtin të rritet brenda jush. Zoti do t’ju tregojë se çfarë dëshiron Ai që ju të bëni me jetën tuaj.”¹

Dhe kjo nuk mbaron me fundjavën e konferencës – ju mund të vazhdoni ta ndieni Shpirtin duke studiuar bisedat më pas gjithashtu!

Konferenca na ndihmon në shumë mënyra. Ndoshta më e rëndësishmja, na lejon të afrohem më shumë te Shpëtimtari duke na mësuar si të bëhemi më shumë si Ai. Një mënyrë e shkëlqyer për të marrë maksimumin nga konferenca është t’u kushtosh vëmendje të veçantë mësimëve rreth cilësive si të Krishtit – qoftë gjatë transmetimit ose kur studioni bisedat më pas. Ndërsa dëgjoni apo lexoni duke pasur në mendje disa cilësi si të Krishtit, fjalët dhe Shpirti mund t’ju ndihmojë të mësoni si të jeni më shumë si Krishti.

Ju mund ta plotësoni këtë pyetësor të shpejtë për të parë një apo dy cilësi të cilat mund të donit të përqendrohni ndërsa studioni mesazhet e konferencës. (Për një pyetësor më të thelluar, shihni te revista *New Era* e tetorit 2016 ose kapitullin 6 të manualit *Predikoni Ungjillin Tim*.)

Për secilën nga nëntë cilësitë vijuese si të Krishtit, zgjidhni thënieën që ju përshkruan më mirë.

1. BESIMI:

- Unë jam i pasigurt nëse Jezu Krishti është Shpëtimtari im.
- Unë besoj te Jezu Krishti dhe e pranoj Atë si Shpëtimtarin tim.
- Unë shpresoj që Jezu Krishti është Shpëtimtari im.

DASHURI PËR PESË MIQ TË RINJ

Në shkollë është një grup i vogël fëmijësh që shumica e nxënësve i mendojnë si “askushi” ngaqë janë të ndryshëm. Unë nuk u flisja më parë. Nuk isha e ligë, por thjesht nuk isha as e këndshme.

Kur dëgjova Presidentin Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, të jepte bisedën e tij “Të Mëshirshmit Gjejnë Mëshirë” (konferenca e përgjithshme e prillit 2012), diçka ndryshoi. Ai tha se ka një gjë që ne duhet të bëjmë kur vjen puna të të gjykuarit: “Ta ndalojmë atë!” Biseda e tij më ndihmoi ta kuptoj se, në vend që t’i gjykoja këta fëmijë në shkollë, unë duhej t’i zëvendësoja mendimet dhe ndjenjat e mia të këqija me një “zemër plot ndjenja dashurie për Perëndinë dhe fëmijët e Tij”.

Atë të hënë kur shkova në shkollë, në vend që të takoja miqtë e mi të zakonshëm, unë shkova atje ku ndodhej grupi të cilin njerëzit e mendonin si “askushi”. Ne filluam të bisedonim dhe unë kuptova se këta njerëz nuk ishin aspak të ndryshëm nga cilido tjetër. Ndërsa kaloja kohë me ta, unë krijova një marrëdhënie të fortë me ta. Unë kam zënë pesë miq të rinj.

Unë kuptova se miqtë e mi të rinj nuk ishin aspak “askushi” – për Perëndinë ata kanë qenë gjithmonë dikushi. Unë jam shumë e lumtur që kam mësuar më shumë rreth dashurisë së Perëndisë për fëmijët e Tij.

Holli H., 19 vjeçe, Kaliforni, SHBA



2. SHPRESA:

- Unë ndihem plot paqe dhe optimizëm për të ardhmen.
- E ardhmja më tmerron!
- Unë zakonisht e shpërfill të ardhmen - nëse nuk mendoj rreth saj, nuk kam pse të shqetësohem për të.

3. DASHURIA HYJNORE DHE DASHURIA:

- Unë përpiqem t'i dua njerëzit e tjerë, por ka disa njerëz që gjithmonë duket se më ngacmojnë nervat.
- Jam aq i/e zënë duke u përpjekur të merrem me vetë jetën time saqë e kam të vështirë të mendoj për cilindo tjetër.
- Dëshiroj mirëqenie dhe lumturi të përhershme për njerëzit e tjerë.

4. VIRTYTI:

- "Të jesh i/e kulluar në mendim dhe veprim." Kjo nuk duket dhe aq zbavitëse!
- Unë jam i/e pastër dhe i/e kulluar në zemër.
- Unë e kam të vështirë të qëndroj i/e pastër dhe i/e kulluar.

5. DITURIA:

- Unë kam aq shumë gjëra [për të bërë] saqë nuk mund të gjej vërtet kohë të kërkoj përgjigje për pyetjet e mia.
- Oh. Të studiuarit? Ndonjëherë duket aq e mërzitshme të përpiqesh të mësosh gjëra.
- Unë kërkoj me zell të kuptoj të vërtetën dhe të gjej përgjigje për pyetjet e mia.

6. DURIMI:

- Unë jam në gjendje të pres për gjëra pa u mërzitur apo nevrikosur.
- Mendoj se mund të pres për gjëra, por mund të mërzitem disi për këtë.
- Të presësh për gjëra është më e keqja. Unë e dua gjithçka tani.

7. PËRULËSIA:

- Unë dua të sigurohem që ta bëj çdo gjë vetë.
- Unë mbështetem te ndihma e Zotit për ndihmë.
- Kur punoj për diçka, shpesh harroj se mund t'i kërkoj ndihmë Atit Qiellor.

8. ZELLI:

- Unë shpenzoj shumë nga koha ime duke parë televizionin, duke dalë me miqtë e mi dhe duke shmangur përgjegjësitë!
- Shpesh has vështirësi të përquendhem në gjërat e rëndësishme në jetën time, por përpiqem.
- Unë e shpenzoj kohën dhe energjinë time në gjërat më të rëndësishme.

9. BINDJA:

- Unë e ndjek me gatishmëri këshillën e udhëheqësve dhe të prindërve të mi.
- Zakonisht jam zot i vetes - shpesh e kam të vështirë të dëgjoj dikë tjetër.
- Unë ndjek këshillën e udhëheqësve dhe të prindërve të mi, por ndonjëherë ankoem për të.

Tani vështroni përgjigjet tuaja. Me cilat cilësi do të donit të vazhdoni të punoni? Për të mësuar se si t'i zhvilloni ato, ju mund të zgjidhni një ose dy dhe t'u kushtoni vëmendje ndërsa dëgjoni konferencën.

Dhe nëse u përgjigjët se jeni shumë mirë me secilën, mbajeni ashtu! Ju ende mund të zgjidhni një ose dy që patën shumë rëndësi për ju gjatë pyetësorit, dhe të përqendrohni tek ato gjatë studimit të konferencës. Kudo që të jeni në udhëtimin tuaj për t'u bërë si Krishti, ju gjithmonë mund t'u drejtoheni mësimet të udhëheqësve tanë për t'ju ndihmuar në udhën tuaj.

Nëse nuk mund të vendosni tani për ndonjë cilësi, mos u merakosni! Ju mund ta dëgjoni gjithmonë konferencën dhe pastaj të shihni se çfarë ju bie në sy.

Sapo ta keni zgjedhur cilësinë ku doni të përqendrohni, ju mund të doni ta shkruani në mënyrë që të jeni gati të merrni zbuluesë rreth saj ndërsa dëgjoni konferencën ose teksta studioni bisedat më pas. Ndërsa dëgjoni dhe studioni, le t'ju udhërrëfejë Shpirti te disa mënyra të veçanta që të mund të punoni për atë cilësi. Proveni këtë shembull që vijon! ■

Autorja jeton në Jutá, SHBA.


SHËNIM

1. Robert D. Hejls, "Konferenca e Përgjithshme: Forcimi i Besimit dhe i Dëshmisë", *Liahona*, nëntor 2013, f. 6.

Gjatë konferencës së përgjithshme të tetorit 2015, një bisedë e veçantë më ra në sy. Plaku Dejll G. Renland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha një bisedë me titull: "Nëpërmjet Syve të Perëndisë". Ai foli rreth rëndësisë së të parit të njerëzve të tjerë nëpërmjet syve të prindërve të dashur. Kur e dëgjova atë, unë mund të ndieja se kisha nevojë të bëja më shumë se një përpjekje për t'i dashur njerëzit rreth meje.

Një mëngjes pas konferencës, unë i kushtova vëmendje kohës së duhur për ta bërë dikë të ndihet i lumtur. Shkova te klasa ime e orkestrës dhe pashë një djalë të cilit zakonisht nuk i kushtoja shumë vëmendje. Mund të dalloja se ai ishte i mërzhitur për diçka, ndaj shkova dhe e pyeta si po i shkonte dita. Ai nuk ishte shumë komunikues, ndaj e pyeta nëse i pëlqente klasa e orkestrës. Ai më tha se nuk e njihje vërtet muzikën dhe ishte i shqetësuar për koncertin. Unë i ofrova që ta luanim të gjithë muzikën me të dhe e interpretuam këngën së bashku. Shkoi shkëlqyeshëm! Pas asaj ne filluam të flisnim për instrumentet tona. Ne jemi bërë shumë më të afërt dhe jam vërtet e gëzuar që kalova kohë për të biseduar me të.

Krista M., 12 vjeçe, Teksas, SHBA





Qëndroni të **PALËKUNDUR**

Nga Lindsej Hiller

Unë u rrita me miq që ishin anëtarë të Kishës, dhe gëzohesha që do të pagëzohesha dhe do të bëhesha anëtare edhe vetë. Kur u zhvendosa në anën tjetër të vendit për kolegjin, fillova të merrja mësim nga misionarët. Fatkeqësisht, trysnia nga bashkëmohatarët e mi të rinj e bëri të vështirë të ndiqja standardet e ungjillit. Shokët e mi të vitit të parë kalonin shumë kohë në argëtime duke pirë alkool. Unë nuk kisha provuar kurrë më parë alkool, por miqtë e mi të rinj ushtronin vazhdimisht trysni që të pija.

Unë e dija se ungjilli ishte i vërtetë, por ishte vështirë t'i rezistojë tundimit nga bashkëmohatarët e mi.

Unë fillova t'i lutem Atit Qiellor për forcë që të merrja vendimin e drejtë. Unë nuk i pata ulur ende standardet, por kisha frikë se nuk do ta kisha forcën ta kundërshtoja alkoolin herën tjetër që do të ofrohej. Kisha mall për miqtë e mi që kishin të njëjtat vlera.

Një natë të shtune shkova në një mbrëmje me njerëzit e fjetores sime. Menjëherë të gjithë miqtë e mi po pinin dhe po më nxitnin të provoja shijimin tim të parë të alkoolit.

Isha e tunduar. Mora gotën e birrës që më dhanë. E afrova drejt gojës sime, në siklet por e kënaqur që kisha vëmendjen e miqve të mi. Atëherë Niku, një djalë që shquhej në pije, erdhi te rrethi ynë.

“Ti nuk e pive, apo jo?” pyeti ai.

“Ende jo”, u përgjigja.

“Nëse do ta pish”, tha Niku, “ti do të pendohesh për të çdo ditë të jetës tënde.”

U trondita. E dija se kishte të drejtë. Unë nuk doja të pija. Unë doja t'i bashkohesha Kishës. Unë e ktheva mbrapsht gotën dhe u largova nga argëtimi, mirënjohëse që nuk pata marrë një vendim të keq.

Mëngjesin tjetër unë shkova në kishë,

gjeta misionarët dhe vendosa një datë për

Miqtë sjellin një ndryshim të
madh në atë se sa e lehtë – ose
e vështirë – është t'i jetosh
standardet tona.

pagëzimin tim. Qysh nga ajo ditë unë qëndrova larg festave me alkool. Unë zura miq të rinj në kishë që kishin vlerat dhe standardet e mia.

Unë mbeta mike përsëri me njerëzit në fjetoren time, por i bëra të qarta standardet e mia. Kur ata mësuuan sa të rëndësishme ishin vlerat e mia për mua, ata i respektonin ato dhe e ndalën trysninë ndaj meje. Ata e vërenin dhe e respektonin këtë kur unë lija dhomën ndërsa ata shihnin filma të papërshtatshëm apo dëgjonin muzikë të papërshtatshme.

Dëshmia ime u forcua nga kjo përvojë dhe unë do të përpiqem që të mos i ul kurrë standardet e mia për shkak të trysnisë së bashkëmoshatarëve. Unë gjithashtu e di se mënyra më e mirë për të përballuar vendimet e vështira është të njohësh standardet e tua dhe të mbahesh fort tek ato qysh nga fillimi.

Unë e di se Ati Qiellor iu përgjigj lutjeve të mia për fuqi që t'i rezistoj tundimit. Unë jam mirënjohëse që Fryma e Shenjtë më nxiti të marr vendimin e drejtë. Unë e di se standardet e Kishës janë për të na mbrojtur dhe unë jam mirënjohëse që zgjedhja për t'i ndjekur ato, më ndihmoi të zgjedh t'i bashkohem Kishës. ■

Autorja jeton në Jutá, SHBA.



THUAJI JO TUNDIMIT

“Individët që veprojnë gabim, duan që ju të bashkoheni me ta, sepse ata ndihen më rahat në atë që po bëjnë kur e bëjnë edhe të tjerët. Ata mund të duan edhe të përfitojnë prej jush. Është e natyrshme të duash të jesh i pranuar nga bashkëmoshatarët, të jesh pjesë e një grupi. . . . Një nga gjërat më të vështira për ta dalluar, është se sa të fortë jeni vërtet tashmë dhe se si të tjerët në heshtje ju respektojnë. . . . Ju nuk duhet t'i rrezikoni standardet tuaja që të pranoheni nga miq të mirë. Sa më të bindur të jeni, aq më shumë do të qëndroni për parime të vërteta, aq më shumë Zoti mund t'ju ndihmojë ta mposhtni tundimin.”

Plaku Richard G. Scott (1928-2015), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Making the Right Choices”, *Ensign*, nëntor 1994, f. 37.

Thyeje Modelin “ADOLESHENT TIPIK”

Harro çfarë thotë bota. Si ju sheh Ati Qiellor ju?

Nga Sharlot Larkabal

Revista të Kishës

Bota ka mjaft për të thënë mbi adoleshentët e sotëm. Ju ndosh-ta i njihni disa nga stereotipet ose keni dëgjuar dikë të ankohet mbi “fëmijët e këtyre ditëve”. Ka gjithashtu mjaft studime dhe statistika rreth jush – zakoneve tuaja në mjetet shoqërore të informimit, çfarë blini, madje sa e shkurtër mund të jetë shtrirja e vëmendjes suaj.

Por Presidenti Rasëll M. Nelson, President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, thotë se ai “nuk ndihet rehat” kur dëgjon studiuesit t’i përshkruajnë studimet e tyre mbi të rinjtë. “Dhe sinqerisht”, tha ai, “jam më pak i interesuar për ato që *ekspertët* kanë për të thënë rreth jush sesa për ato që Zoti më ka thënë rreth jush.”¹

Zoti nuk ka nevojë për studime apo stereotipe për t’ju njohur ju. Ai nuk ju sheh si statistikë apo si dikush që vlerësohet sipas mënyrës se si përpiqet t’ju përshkruajë “bota”.

“Ai ju do jo vetëm për atë që jeni pikërisht sot, por edhe për njeriun plot lavdi e dritë që keni potencialin dhe dëshirën të bëheni”, tha Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë.²

Perëndia nuk është se thjesht ju sheh; Ai ju do ju.

A doni ta thyni modelin e botës? Filloni duke e parë veten sipas mënyrës se si Ati Qiellor dhe shërbëtorët



e Tij të zgjedhur ju shohin. A doni t’i rrëzoni stereotipet? Tani është koha të ngriheni dhe të veproni! Kur ishte 12-vjeçar, Krishti u kujtoi prindërve të Tij tokësorë se Atij i duhej të “merr[ej] me punët e Atit [të Tij]” (Lluka 2:49).

Ai nuk ishte tepër i ri dhe as ju nuk jeni ashtu. Kështu pyetja tjetër është kjo: Si mund të merreni me punët e Atit tuaj Qiellor?

“Puna” e Tij është e tëra që të bëjë të ndodhë “pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39), ndaj mund të merreni me punën e Atit tuaj, duke bërë më të mirën për të arritur

potencialin tuaj dhe duke u bërë dikush që i ndihmon të tjerët ta arrijnë gjithashtu potencialin e tyre.

Tani është koha të merrni përgjegjësi për vetë të ardhmen tuaj. Çfarë mund të bëni *pikërisht tani* që të siguron se po bëheni ai që Ati Qiellor e di se mund të bëheni, jo vetëm në përjetësitë, por gjithashtu në *këtë* jetë?

A doni të martoheni në tempull? Vendosni tani të jeni i pastër në mendim, fjalë dhe veprim. A e shihni veten duke studiuar në një universitet? Zhvilloni aftësi të mira studimi tani. A doni të shërbeni në një mision?

Ju mund të jetoni sipas përfytyrimit të Tij mbi potencialin tuaj.



UNË PO BËHEM MË I MIRI I VETES DUKE ...

Mësuar të mbaj buxhet?
Përmirësuar studimin tim të
ungjillit? Zhvilluar një dashuri për
shërbim? Tregoni se si po merrni për-
sipër të ardhmen tuaj duke dërguar
një mesazh te liahona@ldschurch.org
ose në faqet në Facebook ose Insta-
gram të LDS Youth.

Shtoni manualin *Predikoni Ungjillin Tim* te studimi juaj i ungjillit (posa-
çërisht kapitullin 3). A dëshironi të
siguroni për një familje? Mësoni si të
bëni dhe të mbani një buxhet tani.

Ju gjithashtu mund të merreni
me gjërat që ju bëjnë të lumtur *tani*.
A e doni matematikën? Të luajturit
në piano? Të shkruarit e ngjarjeve?
Qëndroni tek ato! Shihni nëse ka më-
nyra se si mund t'i përmirësoni: lëndë
në shkollë, metoda mësimi në inter-
net, konkurrime, seminare praktike
dhe kështu me radhë.

Thyejeni modelin dhe rrëzoni
stereotipet! Merreni përsipër të ardh-
men tuaj. Çfarë po bëni për të nxjerrë
te vetja më të mirën tuaj? Na njoftoni
duke na dërguar mesazh elektronik
te liahona@ldschurch.org ose
duke lënë mesazh në faqet
në Facebook ose Instagram
të LDS Youth. ■

SHËNIME

1. Rasëll M. Nelson,
"Qëndroni si Mijëvjeçaristë
të Vërtetë", *Liahona*, tetor
2016, f. 46.
2. Diter F. Uhtdorf, "Të
Jetuarit e Ungjillit Plot
Gëzim", *Liahona*,
nëntor 2014, f. 123.



NGRIHUNI NË BESIM

Ushqetje zjarrin e besimit tënd për t'u ngritur mbi shkretëtirën e dylshimit.



**Nga Presidenti
Henri B. Ajring,**
Këshilltar i Parë në
Presidencën e Parë

SI TA DINI VETË

Miqhtë tanë të dashur të rinj, dëshira jonë për secilin prej jush është që ju të mund ta dini për vete, të pavarur nga çdokush tjetër, se Perëndia i qiellit është i vërtetë, se Ai ju njeh dhe se Biri i Tij ka shlyer për mëkatet e botës.

Shpresa jonë është që ju do të fitoni për vete një dëshmi të patundur se ungjilli i Jezu Krishtit është rivendosur në tokë për herë të fundit. Misioni i Jozef Smithit që unik, prapëseprapë lutja e tij e përlurur është një model i dobishëm për mua dhe për ju. Jozefi u nis drejt korijes të **lutej me besim** se një Perëndi i dashur do t'i përgjigjej lutjes së tij dhe do ta lehtësonte pështjellimin e tij. Ai e fitoi atë siguri duke **lexuar fjalën e Perëndisë** dhe **duke marrë dëshmi** se ajo që e vërtetë. Jozefi gjithashtu u lut me qëllimin jo vetëm për të dëgjuar, por për t'u bindur me çdo çmim. Ai që zotuar të **vepronte në përputhje me çfarëdo që Perëndia do t'i komunikonte** atij.

Në atë frymë, do të doja t'i bëja një sfidë rinisë së Kishës. Sfidë është kjo: eja-ni ta dini vetë se këto gjëra janë të vërteta. Ju mund ta bëni këtë duke ndjekur shembullin e Jozef Smithit: **studiojini shkrimet e shenjta**, lërnini fjalët të futen thellë në zemrën tuaj, **reflektoni për to** vazhdimisht dhe pastaj **kërkojini Perëndisë**, me gatishmërinë për ta pranuar udhërrëfimën e Tij – me të vërtetë, u bëftë vullneti i Tij.

Ndërkohë që kjo sfidë mund të duket si një ftesë e thjeshtë, unë ju premtoj se mund të kërkojë përpjekje të rëndësishme. Unë nuk mund të premtoj se përgjigjet tuaja do të vijnë brenda një dite apo jave, por unë mund të premtoj se Perëndia do t'ju flasë në vetë mënyrën e Tij dhe në vetë kohën e Tij, nëse kërkon me besim. Ndërsa e **pranoni** dhe **veproni sipas kësaj ftese**, do të zbuloni që jo vetëm përgjigjet do të vijnë, por ju gjithashtu do të krijoni një model për fitimin e njohurisë shpirtërore që do t'ju bekojë për gjithë pjesën tjetër të jetës suaj. ■

Nga një ngjarje Ballë për Ballë e marsit 2017 me Presidentin Henri B. Ajring dhe Plakun Xhefiri R. Holland.



SI E KENI ZBATUAR KËTË?

Koment mbi ngjarjen Ballë për Ballë: “Gjëja kryesore që më bëri përshtypje mua personalisht, ishte përqendrimi i qartë te rëndësia e studimit të shkrimeve tona të shenjta dhe përgjigjet që mund të marrim prej tyre. Mua gjithashtu më pëlqeu me të vërtetë diskutimi mbi temën e lutjes dhe mbi mënyrën se si duhet t'i qasemi Perëndisë kur lutemi. Unë kuptova që lutjet mund dhe duhet të jenë personale, por që ne duhet të jemi të vetëdijshëm për mënyrën se si i qasemi Perëndisë dhe t'i qasemi Atij në lutje me respekt, si Ati ynë Qiellor, jo si një shok.

Xhoshua C., Havaï, SHBA

“Përpos lutjes dhe studimit të shkrimeve të shenjta, cila është mënyra më e mirë për ta forcuar dëshminë time?”

Dëshmia juaj me shumë gjasë nuk do të vijë e tëra njëherësh. Ajo do të rritet përvojë shpirtërore pas përvoje shpirtërore – ashtu siç thonë shkrimet e shenjta: “Resht pas rreshti, parim pas parimi” (2 Nefi 28:30). Ju atëherë duhet ta ushqeni dhe forconi dëshminë tuaj, ashtu si një farë që rritet (shih Alma 32:28–43). Dhe sikurse një bimë nuk mund të mbijetojë vetëm me ujë, po ashtu nuk ka vetëm një mënyrë “më të mirë” për ta forcuar dëshminë tuaj. Ju duhet një gërshetim mënyrash.

Lutja dhe studimi i shkrimit të shenjtë janë pa dyshim mënyra të mira për ta ushqyer dëshminë tuaj. Ndërsa e studioni ungjillin dhe luteni me qëllim të sinqertë për ta ditur se diçka është e vërtetë, Fryma e Shenjtë do t’ju ndihmojë ta ndieni të vërtetën e ungjillit (shih Moroni 10:4–5).

Ju gjithashtu mund ta forconi dëshminë tuaj duke i mbajtur urdhërimet. Kur e vini në jetë një parim të ungjillit – të tillë si agjërimin, mbajtjen e ditës së Shabatit të shenjtë ose marrjen e sakramentit – ju filloni të fitoni një dëshmi për mënyrën *si* dhe arsyen *përse* ai është i vërtetë, në vend të thjesht një dëshmie që është i vërtetë. Jezusi tha se, kur zgjidhni të “bë[ni] vullnetin e tij”, ju “do ta nj[ihni] . . . doktrinë[n]” (Gjoni 7:17).

Një mënyrë tjetër për ta ushqyer dëshminë tuaj është duke e dhënë atë. Presidenti Bojd K. Paker (1924–2015), President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha: “Një dëshmi *fitohet* kur *jepet!*” (“The Candle of the Lord”, *Ensign*, janar 1983, f. 54; *Tambuli*, korrik 1983, f. 34). Ju mund ta jepni dëshminë tuaj në kishë dhe seminar, në shtëpi dhe mes miqsh. Kur e bëni atë, Fryma e Shenjtë mund t’ju dëshmojë *juve* se ajo që po thoni, është e vërtetë.

Ndërsa e forconi dëshminë tuaj në shumë mënyra të ndryshme, ajo do të rritet e thellohet dhe ju do të ndieni paqe dhe gëzim.



Punoni me Misionarët

Puna misionare ka qenë mënyra më e mirë për mua për ta forcuar dëshminë time. Sa herë

punoj me misionarët, unë ndiej dashurinë e Krishtit.

Xhoi D, 19 vjeçe, Leite, Filipine

Përpiquni të Jeni Dishepull

Ju mund ta forconi dëshminë tuaj duke u përpjekur për të qenë përherë një dishepull i vërtetë i Jezu Krishtit. Bindja ndaj urdhërimeve të Perëndisë na bën të guximshëm në dëshmitë tona dhe kjo në vijim i bën dëshmitë tona edhe më të forta dhe [na bën] gati për mbretërinë e Perëndisë (shih DeB 76:79). Ju gjithashtu mund ta forconi dëshminë tuaj duke e dhënë atë. *Plaku Mjull Simon, 23 vjeç, Misioni i Republikës Demokratike të Kongos, Lubumbashi*

Dëgjojeni Frymën e Shenjtë

Vajtja në kishë, leximi i shkrimeve të shenjta, dëgjimi i bisedave të konferencës dhe kështu me radhë do t’ju ndihmojnë ta forconi dëshminë tuaj vetëm nëse e dëgjojeni Frymën e Shenjtë. Ai do t’ju dëshmojë për të vërtetën. Dëgjojeni përherë Frymën e Shenjtë, pasi Ai gjendet pranë dhe do t’ju ndihmojë ta forconi dëshminë tuaj. *Alisa B., 16 vjeçe, Virxhinia, SHBA*



Shkoni në Mision

Vajtja në mision do të forcojë dëshmitë për ju dhe për të tjerët të cilëve u jepni mësim.

Në mision ju do të mësoni të mbështeteni plotësisht te Zoti dhe jo te




forca juaj vetjake. Një mision do t'ju forcojë dhe, ndërsa i shërbeni Zotit dhe bëni punën e Tij, ai do të forcojë dëshminë tuaj.

Plaku Beili Peali Uilliams, 19 vjeç, Misioni i Singaporit

Shpreheni Atë që e Dini se Është e Vërtetë

Kam mësuar se një nga mënyrat më të mrekullueshme për ta forcuar dëshminë time, është t'ua shpreh atë të tjerëve. Sa herë që e shpreh atë që besoj dhe e di se është e vërtetë – sado e thjeshtë dhe e parëndësishme që mund të jetë – unë ndiej një ngrohtësi të madhe brenda kraharorit tim dhe me të vjen një konfirmim [edhe] më i madh në zemrën time se ato gjëra që kam thënë, janë të vërteta! Me fjalë të tjera, e ndiej dëshminë time të forcohet.

Daglas S., 20 vjeç, San-Paolo, Brazil



Bëhuni më Shumë si Krishti

Ne mund t'i forcojmë dëshmitë tona duke u bërë më shumë si

Krishti. Unë e kam forcuar dëshminë time kur e kam shfaqur dashurinë e pastër të Krishtit dhe u kam shërbyer të tjerëve siç bëri Shpëtimtari.

Kiang Zhin P., 17 vjeçe, Seul, Koreja e Jugut

Jepeni Dëshminë Tuaj

Një mënyrë e mirë për ta forcuar dëshminë tuaj, është ta jepni atë. Ndonjëherë, kur e jepni dëshminë tuaj, ju e zbuloni [se e ken] atë. Ju gjithashtu mund të agjëroni për të ditur vetë nëse ajo që po ju mësohet, është e vërtetë. Unë i kam bërë të dyja këto gjëra dhe ato e kanë

forcuar së tepërmi dëshminë time.

Porter S., 12 vjeç, Ajdaho, SHBA



Shërbejuni të Tjerëve

Përveç lutjes dhe studimit të shkrimeve të shenjta, unë mendoj se mënyra më e mirë për

ta forcuar dëshminë tuaj është nëpërmjet shërbimit. Kur u shërbejmë të tjerëve, ne i tregojmë Perëndisë se ne kujdesemi për fëmijët e Tij. Gjithashtu, ne mund ta marrim Shpirtin kur jemi duke bërë punën e Perëndisë. Unë e di se, shumë herë, kam marrë ngushëllim gjatë periudhave të vështira dhe përgjigje për pyetjet ndërsa po bëja shërbim.

Karolina J., 18 vjeçe, Juta, SHBA



USHQYERJA E DËSHMISË SUAJ

“Si një bimë në rritje, [një dëshmi] duhet

të ushqehet ose ajo do të vyshket... Bindja ndaj urdhërimeve është pjesë e ushqimit që duhet të siguroni për dëshminë tuaj.”

Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, “Një Dëshmi e Gjallë”, Liahona, maj 2011, f. 125.

PYETJA PASUESE

Si mund ta ftoj Shpirtin në shtëpinë time kur njerëzit janë duke u grindur apo debatuar?

Dërgojeni përgjigjen tuaj dhe, nëse dëshironi, një fotografi me rezolucion të lartë deri më 15 nëntor 2017 në liahona.lds.org (klikoni te “Submit an Article” [“Dorëzo një Artikull”]) ose nëpërmjet postës elektronike në adresën liahona@ldschurch.org.


Ju lutemi, përfshini informacionin vijues: 1) emrin e plotë, 2) datën e lindjes, 3) lagjen ose degën, 4) kunjin ose distriktin, 5) lejen tuaj me shkrim dhe, nëse jeni nën moshën 18 vjeç, lejen me shkrim të prindit tuaj (mesazhi elektronik pranohet) për botimin e përgjigjes dhe të fotografisë suaj.

Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë.

*Ne jetojmë në anë
të ndryshme të
botës, por u ndiem
njësoj kur tempuj
u ndërtuan
afër nesh!*

Nga Parisi

Nga intervistat prej Emi Levitit, Juta, SHBA.



*Shkalla spirale në
Tempullin e Parisit
në Francë*

Unë quhem Rejçëll. Unë jetoj pranë Tempullit të Parisit në Francë.


Tempulli është vërtet i rëndësishëm për familjen tonë. Përpara se të ndërtohej Tempulli i Parisit, ne bëmë udhëtime familjare për në Tempullin e Frankfurtit në Gjermani disa herë në vit. Na duheshin 10 orë vajtje-ardhje me makinë!

Na pëlqente shumë të shikonim tempullin e ri teksa ndërtohej. Çdo javë pas kishë, prindërit tanë kalonin pranë [tempullit] për të na lejuar të shikonim se si po shkonte ndërtimi. Së pari, ata shembën një ndërtesë të vjetër dhe gërmuan një gropë të madhe. Më pas ata filluan t'i ngrinin katet e tempullit gjithnjë e më lart. Shpejt shtëpia e Zotit ishte aty!

Vëllai e motrat e mia dhe unë jemi shumë të emocionuar që do të shkojmë në tempull një ditë. Motra ime më e madhe, Esteri, do të bëjë pagëzime e para. Ne të gjithë po presim me ankth radhën tonë për të shkuar gjithashtu. E duam tempullin dhe jemi të lumtur të kemi një të tillë në vetë qytetin tonë!



në Saporos



*Llambadari në dhomën
çelestiale në Tempullin e
Saporos në Japoni*



Emri im është Koshi. Unë jetoj pranë Tempullit të Saporos në Japoni. Më pëlqente shumë të ulesha pranë dritares në shtëpinë time dhe të shikoja tempullin teksa ndërtohej.

Gjatë shtëpisë së hapur, e ftova mikun tim të mirë të vinte me ne. Atij gjithçka iu duk e bukur.

Më pëlqen të mendoj për përkushtimin e tempullit si të ishte ditëlindja e tij. Ajo ditë ishte njëkohësisht ditëlindja ime. Dhe e Presidentit Monson gjithashtu! Prindërit e mi dhe unë ishim në tempull kur ai u përkushtua.

Jam kaq mirënjohës që jetoj pranë tempullit. Kur kam ditë të vështira në shkollë, unë mund të kaloj përmes oborrit të tempullit rrugës për në shtëpi. Unë ndiej dashurinë e Atit Qiellor për mua kur unë jam aty. Pres me padurim kur të mund të shkoj brenda për të bërë pagëzime dhe më vonë të marthem aty. ■



**Nga Plaku
Robert D. Hejls,**
i Kuorumit të
Dymbëdhjetë
Apostujve

Si mund të më ndihmojë Fryma e Shenjtë?

Fryma e Shenjtë është anëtari i tretë i Kreut-Perëndi.
Ai dëshmon për Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin.

Ai u flet butësisht mendjeve
dhe zemrave tona. Secili
prej nesh mund ta dëgjojë
Atë ndryshe.

Ai na jep dhurata
shpirtërore. Ai na
jep njohuri dhe na
ndihmon të kujtojmë
gjëra të rëndësishme.

Ai na mëson.
Ai na jep shpresë.
Ai na ndihmon të
bëjmë mirë.

Fryma e Shenjtë na
ndihmon gjithashtu
të bëjmë zgjedhje
të rëndësishme.

Ai na ndihmon të jemi
të pastër nga mëkati.
Ai na ngushëllon.

FAQJA JONË




Vegimi i Lehit, nga Maria V. 10 vjeçe, Brazil



Tempulli i Limës, Peru, nga Valeria T. 9 vjeçe, Peru



Tempulli i Guajakilit, Ekuador, nga Lendis Z. 10 vjeç, Ekuador



Tempulli i Solt-Lejcut, nga Melisa L. 5 vjeçe dhe Ameila L. 2 vjeçe, Estoni



Udhëtimi i Xhejnit



Nga Xhesika Larsen

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

Nju-Jork, SHBA, 1843

Xhejn Maningu pa barkën tek lundronte jashtë nga limani drejt liqenit Eri. U ndje sikur ëndrrat e saj po lundronin larg bashkë me atë barkë.

Vetëm një vit më parë, ajo u bashkua me Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe vendosi të shpërngulej për të qenë me shenjtorët e tjerë në Navu. Nëna e saj dhe shtatë pjesëtarët e tjerë të familjes kishin udhëtuar me të nga kanali Eri për në Bufalo, Nju-Jork. Por në Bufalo, nuk i lanë të hipnin në barkë për shkak të ngjyrës së lëkurës së tyre.

“Çfarë do bëjmë tani?” pyeti qetësisht vëllai i saj, Isaku.

Pyetja jehoi në ajrin e acartë. Navuja ishte ende 1 287 km larg. Ata mund të dorëzoheshin dhe të merrnin rrugën për në shtëpi ose të provonin të udhëtonin më vonë.

Por Xhejni nuk mund të priste! Ajo e dinte se libri i Mormonit ishte i vërtetë. Perëndia foli sërish nëpërmjet profetëve. Ajo duhet të shkonte në Navu bashkë me familjen e saj.

Xhejni mblodhi supet dhe pa drejt perëndimit. “Do ecim.”

Dhe ata ecën. Derisa iu grisën këpucët. Derisa këmbët e tyre u çanë dhe u gjakosën dhe iu desh të luteshin që të shëroheshin. Disa herë ata fjetën jashtë dhe ngrica ishte aq e rëndë saqë dukej si dëborë që binte. Disa njerëz i kërcënuan t’i futnin në burg, duke menduar se ata ishin skllëvër të arratisur. Ata nuk e dinin se familja Mening ishte një familje me ngjyrë e lirë. Dhe përsëri ata ecën, duke kënduar himne për të kaluar kohën.

Po i afroheshin Navusë kur arritën te një lumë.

“Nuk ka urë”, tha Isaku.

Xhejn Meningu jetoi me Emën dhe Jozef Smithin për disa muaj. Ajo u martua me Isak Xhejmsin dhe ata ishin ndër të ardhurit e parë që u vendosën në Luginën e Jutës. Ajo mbeti një anëtare besnike e Kishës edhe pse pati sfida të shumta. Kur ajo vdiq në vitin 1908, Presidenti Jozef F. Smith (1838–1918) foli në varrimin e saj.

Xhejni tundi kokën. “Duhet thjesht të kalojmë përmes tij atëherë.” Teksa futi këmbët në lumë, uji i arriti deri tek kyçet. Me ngadalë, ajo bëri përpara. Uji u ngrit si vorbull deri tek gjunjët e saj dhe më pas u ngrit mbi bel. Në kohën kur arriti në mes të rrjedhës, uji i erdhi deri në qafë. Fatmirësisht, nuk ishte më i thellë se aq dhe familja Mening kaloi e sigurt.

Më në fund ata mbërritën në Navu. Xhejni mundi t’i shihte muret e bukura prej guri gëlqeror të Tempullit të Navusë mbi një kodër me pamje nga lugina. Edhe pse nuk kishte përfunduar ende, e la pa frymë. Dikush i drejtoi te shtëpia ku jetonte

Profeti Jozef.

Një grua e gjatë me flokë të errët qëndronte në prag të derës. “Ejani brenda, ejani brenda!” thirri ajo.

“Unë jam Ema Smith.”

Minutat në vazhdim ishin të turbullta. Xhejni takoi Profetin dhe ai vuri karrige në të gjithë dhomën për të gjithë familjen Mening. Xhejni u zhyt në karrige me mirënjohje dhe dëgjoi teksa Jozefi i paraqiti ata përpara të gjithë të pranishmëve, përfshirë mikun e tij Doktor Bërnhisëllin. Më pas Jozefi u kthye nga Xhejni: “Ti ke qenë në krye të këtij grupi të vogël, apo jo?” pyeti ai.

“Po, zotëri!” u përgjigj Xhejni.

Jozefi buzëqeshi. “Perëndia të bekoftë! Tani do të doja të dëgjoja për udhëtimet tuaja.”

Xhejni tregoi për këmbët e tyre të plagosura dhe për fjetjet në dëborë, dhe për kapërcimin e lumit. Të gjithë dëgjonin në heshtje. “Por nuk ishte e tmerrshme”, e mbaroi ajo fjalën. “Ne shkonim në rrugën tonë duke u gëzuar, duke kënduar himne dhe duke e falënderuar

Perëndinë për mirësinë dhe mëshirën e Tij ndaj nesh duke na bekuar, mbrojtur dhe duke na i shëruar këmbët.”

Pati heshtje për një çast. “Çfarë mendon për këtë, doktor?” tha më në fund Jozefi duke goditur gjurin e burrit. “A nuk është besim ky?”

“Po të kisha qenë unë, druaj se do të isha tërhequr dhe do të isha kthyer në shtëpinë time!” pranoi Doktor Bërnhisëlli.

Jozefi tundi kokën dhe iu drejtua sërish Xhejnit dhe familjes së saj: “Zoti ju bekoftë! Jeni mes miqsh.” ■

Autorja jeton në Teksas të SHBA-së.



Sara dhe Rezonanca Magnetike

Nga Xhulien Doman

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

“Kur Krishti ishte në tokë, Ai premtoi se do të dërgonte Frymën e Shenjtë, mikun tonë të vërtetë e të përfjetshëm, për të na ngushëlluar” (Children’s Songbook, f. 105).

“Duket se Sarës do t’i duhet të bëjë një RM të shpinës së saj”, tha doktor Frenku. Ai i buzëqeshi Sarës. “Do të lë një orar për nesër. Do të kthehem pas pak minutash.”

Sarës kishte ca kohë që i dhembte shpina. Kur u zgjua atë mëngjes, i dhembte kaq shumë sa që e kishte të vështirë të qëndronte drejt dhe mezi ecte. Sara dhe nëna e saj



kishin ardhur të takonin doktor Frenkun për të zbuluar se çfarë nuk shkonte.

“Një RM tjetër?” pyeti Sara duke ngritur sytë drejt mamit. Ajo e kishte bërë një RM një herë më parë. Ajo e mbante mend se sa e frikësuar ishte ndier brenda tubit të madh që nxirrte imazhe të brendësisë së trupit të saj.

“Më vjen keq Sara”, tha mami. Por imazhet do ta ndihmojnë doktor Frenkun që të kuptojë se çfarë nuk shkon me shpinën tënde. Unë e di se mund t’ia dalësh. Dhe unë do të jem këtu me ty.” Mami ia shtrëngoi dorën Sarës.

“Por ti nuk mund të vish brenda me mua”, tha Sara. Koka e saj u ul dhe një lot i rrëshqiti mbi faqe. Mami mund të ishte me të në dhomë, por pasi Sara të futej brenda në tunelin e makinerisë, ajo do të ishte vetëm.

Mami i hodhi krahun Sarës. “Kjo është e vërtetë, por e di ti se kush *mund* të jetë aty për të të ngushëlluar?”

Sara kujtoi një emër që kishte dëgjuar për Frymën e Shenjtë: *Ngushëlluesi*. Ndoshta Fryma e Shenjtë mund ta ndihmonte atë të mos ndihej kaq e frikësuar.

“Fryma e Shenjtë?” pyeti Sara.

Mami tundi kokën. “E saktë. Ti mund të lutesh që Fryma e Shenjtë të të ndihmojë. Babi dhe unë do të lute-mi për ty gjithashtu.”

Kjo i dha Sarës një ide të shkëlqyer. “A mund t’i kërkoj babit një bekim?”

Mami buzëqeshi. “Patjetër që po. E di që atij do t’i pëlqente shumë ta bënte atë.”

Atë natë babi vuri duart e tij mbi kokën e Sarës dhe i dha asaj një bekim priftërie. Kur ai e bekoi Sarën, që të ngushëllohej nga Fryma e Shenjtë, një ndjesi e butë dhe e ngrohtë e mbushi trupin e saj. Ndjesia qëndroi me të gjithë natën.

Ditën tjetër Sara rrinte shtrirë mbi shtratin që do të rrëshqiste brenda në tubin e madh të makinerisë së RM [rezonancës magnetike]. Ajo i përsëriti në mendje fjalët që babi kishte përdorur gjatë bekimit të saj: *Fryma e Shenjtë do të jetë aty për të të ngushëlluar*. Sara ia shtrëngoi fort dorën mamit. Më pas infermierja e rrëshqiti atë brenda tubit.

Makineria e RM-së bëri zhurma të çuditshme ndërsa bënte foto të shpinës së saj. Sarës i duhej të qëndronte shtrirë pa lëvizur fare që imazhet të mos të ishin të



Analisa F. 6 vjeçe,
Juta, SHBA

Kur isha pesë vjeçe më duhej të bëja një operacion për të hequr bajamet dhe gjëndrat e fytit. Isha shumë në ankth dhe e frikësuar. Babi më dha një bekim. Pas bekimit nuk isha më në ankth dhe ne të dy ishim të lumtur sepse e ndiem Frymën e Shenjtë.

turbullta. E zuri paniku për një minutë, por më pas e ndjeu sërish atë ndjesi të ngrohtë. Ngjasonte me një nga përqaftimet e mamit. Ose me një batanije të butë. E dinte se gjithçka do të shkonte mirë. Përpara se ta kuptonte, RM kishte mbaruar!

Në zyrën e vet, doktor Frenku u tregoi Sarës dhe mamit imazhet e shpinës së Sarës. “Bëre një punë të shkëlqyer duke ndenjur shtrirë pa lëvizur”, i tha doktor Frenku Sarës teksa u gjunjzua përkrah saj. “Këto imazhe të shpinës tënde tregojnë se ty do të të nevojitet një operacion për të ndihmuar të ecësh më mirë.”

Sara u përtyp.

“Do të donim ta bënim operacionin së shpejti”, tha doktor Frenku duke parë nga mami i Sarës. Pastaj u kthye sërish nga Sara. “Do të mund të duhen disa javë më pas që të ndihesh sërish si dikur, por duke të parë sot unë e di se do t’ia dalësh mrekullisht.”

Sara u mundua të mendonte për gjithë gjërat që do të bënte pasi doktor Frenku t’ia kishte rregulluar shpinën. *Do të jem në gjendje të notoj dhe të hidhem mbi një pìrg të madh gjethesh*. E kishte marrë malli për të gjitha ato gjëra. Por operacioni ishte akoma më i frikshëm se RM! Më pas Sarës iu kujtuan lutjet e saj dhe bekimi saj i veçantë. Ati Qiellor i kishte dërguar asaj Ngushëlluesin. Ai do ta ndihmonte atë sërish.


Ajo pa nga doktor Frenku. “Pastaj a mund të hidhem në një pìrg të madh gjethesh?” pyeti ajo.

Ai buzëqeshi fort. “Më pas ti mund të hidhesh në një pìrg të madh gjethesh.” ■

Autorja jeton në Kolorado, SHBA.

Një Profet i Ri


Pritini këto figura për t'ju ndihmuar që të rrëfeni tregimet e historisë së Kishës.



Jozefi dhe Hajrëmi



Brigam Jangu



Në vitin 1844: Jozef dhe Hajrëm Smithi shkuan në burgun e Karthixhit në pritje për gjyqin. Burra të këqij hynë me forcë në burg dhe e vranë Profetin e vëllanë e tij. Shenjtorët nuk ishin të sigurt se kush duhet të ishte profeti i radhës. Më vonë, në një mbledhje ku foli Brigam Jangu, ndodhi një mrekulli. Shumë njerëz thanë se ai dukej dhe tingëllonte njëloj si Jozef Smithi! Ata e dinin që ai do të ishte profeti i radhës. Tani ne e dimë se, kur një profet vdes, Presidenti i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve bëhet profeti i radhës. ■

Ju mund të gjeni më shumë figura për historinë e Kishës në liahona.lds.org.



DUKE NDIHMUAR, Laps pas Lapsi

Nga Kaleb H., 10 vjeç, Gjermani

Gjithçka nisi kur kunji im hartoi një projekt për të ndihmuar refugjatët. Mua më pëlqeu me të vërtetë projekti, kështu që i kërkova mamit tim t'i tregonte rreth kësaj mësueses sime të shkollës dhe mësuesja ime dëshironte të bënte diçka me klasën e katërt. Për të vendosur shembullin për projektin, motra ime, Medi, dhe unë shkuam derë më derë duke kërkuar dhurime.

Erdhi dita për t'ia paraqitur projektin pjesës tjetër të klasës së katërt. Isha pak nervoz. Në fakt, isha tërësisht i tmerruar, por dhashë më të mirën time. U tregova të gjitha klasave të katërta se çfarë na nevojiteshin për kutitë me mjete shkollore për refugjatët. U tregova se si kishim shkuar derë më derë dhe unë u dhashë atyre sfidën për të bërë më shumë se unë në mbledhjen e parave. Së bashku ne përgatitëm 100 kuti! Në to vendosëm fletore, lapsa dhe mjete të tjera shkollore. Ne gjithashtu shtuam edhe një shënim që thoshte: "Mirëserdhët në Gjermani".

Unë dhe mami im i çuam kutitë në kampin e refugjatëve. Nuk mund të them që kampi ishte i këndshëm, por atje kishte një shesh lojërash dhe një zonë për mësim akademik. Kishte një tren pranë kampit që ishte shumë i zhurmshëm dhe fëmijët më thanë se tingëllonte si avionët reaktivë që fluturonin mbi Siri dhe në vende të tjera të ngjashme. Ndoshta tingëllonin si bomba për fëmijët, të cilët i kishin dëgjuar në vendin e tyre të lindjes.

Unë takova disa fëmijë të moshës sime në kamp, përfshirë Danielin, një shahist i shkëlqyer. Nuk munda të luaja shah me të për fat të keq, se unë e pëlqej shumë shahun, por ata më fuan të luaja futboll tavoline dhe ping-pong. Djemtë më thanë se ata kishin mall për shtëpinë e tyre dhe se donin me të vërtetë që të largoheshin nga kampi dhe të shkonin sërish në shkollë.

Pasi luajtëm futboll tavoline dhe ping-pong, ne u dhamë kutitë. Ndjem mirë që munda të bëja një gjest dashamirës për fëmijët që jetonin në kampe. ■



Jezusi e Vizitoi Jozef Smithin

Nga Kim Ueb Raid

Shumë vite pasi Jezusi u ringjall, një djalosh i quajtur Jozef Smith kishte një pyetje. Ai nuk e dinte se në cilën kishë duhet të shkonte.




Jozefi e lexoi Biblën. Ajo thoshte se Ati Qiellor do t'iu përgjigjet pyetjeve tona nëse i lutemi Atij. Jozefi shkoi në pyll dhe iu lut Atit Qiellor.



Ati Qiellor dhe Jezu Krishti zbritën nga qielli. Jezusi i tha Jozefit se nuk duhet të shkonte në asnjë nga kishat, sepse ato nuk po jepnin mësim të gjitha gjërat që ishin pjesë e Kishës së Tij.


Kur Jozefi u rrit, ai ndihmoi ta sillte Kishën e Krishtit sërish në tokë. Ajo quhet Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ajo i ndihmon njerëzit të mësojnë rreth Jezusit dhe Atit Qiellor.





Leximi i shkrimeve të shenjta më mëson më shumë rreth Atit Qiellor.
Kur unë lutem, Ai mund t'iu përgjigjet edhe lutjeve të mia. ■

Shabati Është Ditë e Shenjtë



ILLUSTRIMI NGA APPYLL STOTT



Nga Presidenti
Tomas S. Monson

NDIHM DIKË SOT

Ne jemi duart e Zotit. Ai varet te ne.

Unë kam besim se është *qëllimi* i çdo anëtari të Kishës që të shërbejë dhe të ndihmojë ata njerëz në nevojë. Në pagëzim ne besëlidhim që të “mba[jmë] barrat e njëri-tjetrit, që ato të mund të jenë të lehta” [Mosia 18:8]. Sa herë jeni prekur në zemër kur keni dëshmuar nevojën e një tjetri? Sa shpesh keni pasur *ndër mend* të ishit ai që jep ndihmë? Dhe përsëri sa shpesh ka ndërhyrë jetesa e përditshme dhe ju ua keni lënë të tjerëve të ndihmojnë, duke menduar se “oh, me siguri dikush do të kujdeset për atë nevojë”.

Ne rrëmbehemi kaq shumë në angazhimet e jetës sonë. Megjithatë, nëse do të ktheheshim pas dhe do ta vështronim mirë atë që po bëjmë,



mund të zbulonim se . . . tepër shpesh ne e kalojmë shumicën e kohës sonë duke u kujdesur për gjëra që thujse nuk kanë fare rëndësi në skemën e madhe të gjërave, duke lënë pas dore ato kauza më të rëndësishme. . . .

Ne jemi të rrethuar nga ata që kanë nevojë për vëmendjen tonë, nxitjen tonë, mbështetjen tonë, ngushëllimin tonë dhe mirësinë tonë – qofshin ata pjesëtarë të familjes, miq, të njohur apo të huaj. Ne jemi duart e Zotit këtu në tokë, me autorizimin për të shërbyer dhe për të ngritur moralisht fëmijët e Tij. Ai varet nga secili prej nesh. . . .

Fjalët e një himni të njohur le të përshkojnë vetë shpirtin tonë . . . :

A kam bër' sot në bot' un' ndonjë të mir'?

Kam ndihmuar dikë në nevojë?

A e bëra t'pik'lluarin të ndjehet mir'?

N'se jo, un' vërtet dështoj.

A është m'e lehtë sot barra e dikujt,

Se të ndaj' dëshir' un' kisha?

A ndihmova të lodhur edhe të sëmur'?

Kur ndihm' iu duhej pran' a isha?
[“A Kam Bër' Ndonjë të Mir'?”

Himne, nr. 139].

. . . I bëfshim vetes pyetjen: . . .

“Çfarë Kam Bërë për Dikë Sot?”

Këshilla ime për anëtarët në mbarë botën është që të gjejnë dikë, i cili po kalon një kohë të vështirë apo që është i sëmurë ose i vetmuar, dhe të bëjnë diçka për të sot. ■

Nga “Çfarë Kam Bërë për Dikë Sot?” Liahona, nëntor 2009, f. 84–87.



BEKIME,
NGA LUIZ PARKER

*"Dhe është qëllimi im për të siguruar për shenjtoret e mi, sepse gjithë gjërat janë të miat. . . .
Sepse toka është plot dhe ka mjaft edhe për të kursyer; po, unë i përgatita të gjitha gjërat"*
(DeB 104:15, 17).

Për të mësuar më shumë mbi mbështetjen te vetja, shihni faqet 32 dhe 40 në këtë botim.

Gjithashtu në Këtë Botim

PËR TË RINJTË NË MOSHË MADHORE

Pesë Mësime për Të Rinjtë në Moshë Madhore nga Apostujt e Rinj

"Ne përcaktohem nga vendimet, jo nga rrethanat": një prej pesë mësimeve nga jeta e pesë [Apostujve] të parë nga Dymbëdhjetë Apostujt e Rivendosjes – që ndodhi të ishin të rinj në moshë madhore. Lexoni se çfarë mësimesh të tjera mund të mësojmë prej tyre.



f.44

PËR RININË



f.54

Si Mundet një Mesazh nga Konferenca ta **NDRYSHOJË JETËN TUAJ**

Konferenca e Përgjithshme është më shumë sesa një ngjarje – ajo është një mundësi për ta ndryshuar jetën.

PËR FËMIJËT

DUKE NDIHMUAR, Laps pas Lapsi

Kalebi jeton në Gjermani. Ai dëshironte t'i ndihmonte fëmijët në një kamp refugjatësh pranë tij. Kështu që ai bëri një plan.



f.75



4

0214450101

4

ALBANIAN

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME